

HEJZA

Ornela Radovicka, studiuese

**ARBËRESHËT MBIJETUAN FALË PUNËS
SË TYRE**

Nën thjerrë

DINJITETI I KRIJUESIT SHQIPTAR NË TREG

Artisti shqiptar nuk ka respekt për vetveten, nuk di ta çmojnë profesionin e vet dhe, fatkeqësisht, në të shumtën e rasteve dëshmon se është qenie adaptable që i përshtatet kushteve që i dikton pushteti, ndaj dhe nuk proteston, jo se nuk di por, nuk do dhe nuk guxon



Nga Avni HALIMI

Artistët e Teatrit të Tetovës, i cili po funksionon tash e gati dy dekada, këto ditë u ankuan se me Programin vjetor për kulturë të Ministrisë përkatëse edhe sivjet po ndjehen të diskriminuar. Tre milionë e dyqind mijë denarë, apo rreth 50 mijë euro të planifikuara për tri premiera si dhe nja 800 mijë denarë për Festivalin ndërkombëtar të Teatrit të Tetovës – Edicioni X! Kaq para për një vit teatrot maqedonase shpenzojnë për letra tualeti dhe për preparate higjienike!

Sa kushton dinjiteti i artistit

Pra, për dy dekada rresht avazi i njëjtë për sa i përket këtij Teatri si dhe institucioneve të tjera kulturore shqiptare në Maqedoni! Nuk është ky i vetmi problem i këtij Teatri! Artistët e këtij institucioni nacional ankohen edhe për faktin që, që nga themelimi e deri më sot, ambienti ku ushtrojnë dhe ku performojnë gjatë dimrit është akull e gjatë verës të vlojnë trutë! Pa dyshim, kjo dukuri duhet të interpretohet si një eksperiment që sjell te dy definicione: a) artistët shqiptarë duhet të kuptojnë se edhe me kaq “shteti maqedonas” po tregohet shumë i mëshirshëm me ta dhe se, tashmë këta artistë duhet të mësohen me këto kushte, dhe b) artistët shqiptar nuk kanë respekt për vetveten, nuk dinë ta çmojnë profesionin e tyre dhe, po dëshmojnë se janë qenie adaptable që i përshtaten kushteve që i dikton pushteti, ndaj dhe nuk protestojnë, jo se nuk dinë por, nuk duan dhe nuk guxojnë.

Artistët shqiptar në Maqedoninë e Veriut e kanë keqkuptuar lojalitetin politik, e kanë keqkuptuar mirësinë në raport me “tani nuk është koha”, pra, artistët shqiptarë mendojnë se duhet të piqen në durimin e tyre deri sa t’u vije koha e forcimit qind për qind të partive politike të cilat, një ditë, për hirë të këtyre artistëve, do ta dridhin edhe shtetin! Artistët duhet të jenë e vetmja “zonë sesmiologjike” e identitetit kulturor kombëtar që duhet të dridh partitë politike të pushtetit apo të opozitës. Nuk duhet të ketë kushte të volitshme as për shtetin, as për pushtetin dhe as për partitë nëse nuk ka për artistët. Artistët janë pasqyra e identitetit kulturor. Nëse artisti nuk di ta çmojë vetveten, nëse nuk angazhohet për dinjitet personal e profesional, nëse artisti nuk kërkon me ngulm respekt të përkorë nga subjektet e tjera të shoqërisë, atëherë me keqardhje vijnë te konstatimi se artisti është pa identitet kulturor, është një “robot artistik” që mund të performojë pavarësisht nga kushtet në të cilat kurdiset të veprojë! Deri më sot, në Maqedoninë e Veriut janë të vargëzuar qindra raste që flasin për diskriminim kulturor si dhe për sjellje nonshalante të subjekteve tona politike në raport me kulturën shqiptare, ndërsa nuk kemi qoftë edhe një iniciativë të dështuar për protesta deri në sensibilizim të subjekteve të cilët përpigjen që shqiptarët t’i mësojnë të veprojnë në pajtueshmëri me kushtet që i ofrohen! Shqiptari edhe me një copë kocke duhet të kënaqet e të performojë “artistikisht”! Në shoqëritë ku diskriminimi kulturor llogaritet si “politikë humane” artistit i bie hise që t’i emancipojë, pastaj t’i

kulturojë dhe fort t’i ndërgjegjësojë subjektet politike kombëtare, të cilat duhet të kuptojnë njëherë e mirë se, pa kulturë pushteti është vetëm një iluzion i kobshëm. Tetova seli e subjekteve politike kombëtare, Tetova e dy universiteteve, Tetova e Fakultetit të Arteve, Tetova vatër e artistëve kombëtar të cilët detyrohen (apo kështu u pëlqen!) të lumturohen nga fakti që e kaluan edhe një dimër duke e ushtruar profesionin nën përjetimin e të ftohtit të acartë. Viktimizimi nuk e shton respektin, angazhimi për dinjitet të bën të respektueshëm! Nuk është kurrfarë e arriture artistike që t’ia hedhësh edhe një dimri, sukses është që t’ia bëshë dimër pushtetit që ta projekton të ardhmen artistike prej akulli!

Tezga e certifikatave të “kritikëve letrar”

Mungesa e kritikës së mirëfilltë letrare tashmë është ngritur në nivelin e alarmit të kuq kombëtar! Kurse, nga ana tjetër, hala nuk po ndjehet asnjë shqetësim nga institucionet gjegjëse shtetërore për këtë deficit alarmant! Shumë shpejt do të kuptojmë se kjo përgjumje institucionale do të na kushtojë tepër shtrenjtë dhe do të ndjehemi të mbërthyer nga një “virus” nga i cili për kohë të gjatë (mbase shumë dekada) nuk do ta marrim veten! Në ndërkohë, po na vlojnë “botimet” të pacertifikuara nga kritika e mirëfilltë, po na vlojnë botimet e përshtypjeve që po na shiten si “kritikë letrare”, po na mbijnë pseudo-kritikët si kërpudhat pas shiut. Sot, epiteti “kritik letrar” po merret ngjashëm siç merren (blihen) në qoshkë tiketat e lotarive. “Kritikë” të tillë mund

të llogariten mijëra nxënës të shkollave të mesme, të cilët, për notë kaluese në lëndën e gjuhës shqipe obligohen që të përshkruajnë subjektin e ndonjë vepre letrare! Pikërisht këtë po bëjnë “kritikët letrarë” të sotshëm, të cilët po ia dalin të botojnë nëpër fb-ët e vet, nëpër portale, në ndonjë gazetë që hala vazhdon të shtypet, por po na dalin edhe me libra që përmbajnë “kritika letrare”! Ata që shprehin impresionet e tyre personale, pa ofruar kurrfarë analize të thelluar dhe të argumentuar, përkrahësit e pasionuar të letërsisë, por që nuk janë profesionistë në kritikën letrare, impresionistët që ofrojnë përshtypje dhe mendime të thjeshta, që letërsinë e shohin përmes një lente personale, pa e zbërthyer atë në një mënyrë më të strukturuar dhe kritike, ata që publikojnë përshtypjet e veta në forma blogu, nëpër faqe të mediave sociale, pa pasur një njohuri të thellë të kritikës letrare ose pa përdorur metoda të qarta analitike, ata që bëjnë një përshkrim të veprës duke shprehur emocionet personale pa ndonjë vlerësim të mirëfilltë letrar, ata që të shkruajnë eventualisht ndonjë “recension” të thjeshta pa një strukturë analitike të thelluar dhe pa përdorur metoda teorike për të mbështetur gjykimet e tyre, ata që po dinë mirë të navigojnë në google dhe të kompilojnë “tekste autoriale” – të gjithë këta kanë një emërtim të përbashkët: pseudo-kritikë të destinuar për t’u harruar shpejt!

Një kritikë letrare e mirëfilltë është një analizë e thellë, e argumentuar, dhe e mbështetur në teoritë dhe teknikat letrare. Ajo përpigjet të shpjegojë mesazhin, ndikimin dhe vlerën e veprës në një

mënyrë të qartë dhe të strukturuar, duke shkuar përtej një përshkrimi të thjeshtë ose një përshtypje subjektive. Pa dyshim, kritika e mirëfilltë është një proces intelektual që kërkon një kuptim të thellë dhe një vlerësim të hollësishëm të elementeve të veprës. Ajo duhet të ofrojë një sintezë të analizës dhe të sjellë një perspektivë të qartë mbi rëndësinë dhe vlerën e veprës. Një kritik letrar i mirëfilltë në të shumtën e rasteve ka një formim akademik të thellë në fushën e letërsisë, kritikës letrare, apo fushave të tjera të lidhura, si filozofia, historia e artit, apo studimet kulturore; ka një eksperiencë profesionale në hulumtim dhe analizë letrare. Një kritik i mirëfilltë ka njohuri të gjërë mbi teoritë letrare dhe metodologjitë e ndryshme, si strukturalizmi, post-strukturalizmi, modernizmi, etj. dhe përdorë këto kuadër teorik për të interpretuar dhe vlerësuar veprat. Shkurt, për të marrë statusin e kritikut letrare individi duhet të njihet nga komuniteti profesional. Kjo njohje duhet të vijë nga botimet e kritikave të tij/të saj në revista të njohura, pjesëmarrja në konferenca kombëtare e ndërkombëtare, apo lidhjet profesionale me autorë dhe studiues të tjerë. Ky proces do të thotë që kritiku ka fituar besimin e kolegëve të tij dhe është pranuar si një autoritet në fushën e kritikës letrare. Edhe pseudo-kritikët publikojnë, botojnë, madje organizojnë promovime të botimeve ku me plotë tangërllik na ekspozohen si “kritikë letrar”, i japin vetes kurajo të debatojnë, të lexojnë ndonjë komunikatë në “konferencat” e tyre promovuese të cilat i organizojnë për “komunitetin” e vet dhe për ata që shpresojnë ndonjë qasje nga këta “ekspertë letrarë” për veprat e tyre të ardhshme. Ky soj kritikësh, fatkeqësisht, po dominojnë

për momentin dhe emrat e tyre i has gjithandej nëpër “botime” si recensentë, si redaktorë, si shkronjës të parathënieve etj. Fatmirësisht, rrugëtimi i tyre ka vetëm një kahe – drejt harresës. Kritikët e mirëfilltë letrarë janë të përkushtuar përt të ndihmuar shoqërinë për të kuptuar më mirë veprat letrare dhe për të vlerësuar artin e shkrimit. Për të qenë një kritik letrar i mirëfilltë dhe për t’u trajtuar si i tillë, nuk mjafton vetëm të japësh mendime ose të shprehësh impresione pas leximit të një vepre. Vlerësimi dhe certifikimi i kritikëve letrarë është një proces që mund të përfshijë disa aspekte, si ato akademike, profesionale, dhe kulturore. Nëpër këtë proces nuk mund të kalojnë kurrë pseudo-kritikët!

Profesor influenceri

Në një debat të improvizuar, zhvilluar në një pseudo-studio, disa “intelektualë” diskutojnë se kush ka më shumë ndikim në popull: influenceri apo intelektual? Ajo që doli në pah ishte se ndikimi i influencerit është më i madh, pasi ai arrin një audiencë shumë më të gjerë, duke e pasur mundësinë të reklamojë produkte dhe të ndikojë në blerjet e njerëzve, pa dallim shtrese. Nga ana tjetër, intelektual i adresohet në një rreth më të kufizuar, ai shtjellon teza, diskuton probleme dhe ofron rrugëdalje për zhvillim intelektual dhe kombëtar. Në këtë kuadër, influenceri perceptohet si populist, ndërsa intelektual si elitist.

Por a ka intelektualë që e kanë “qeif” rolin e influencerit? Për fat të keq, këta intelektualë janë bërë të pranishëm në numër gjithnjë e më të madh, me bollëk të bezdisshëm, sidomos ata që merren me shkrimtarinë dhe janë gjithashtu

profesorë universitarë. Intelektuali i këtij kalibri nuk ngurron të publikojë një poezi në Facebook-un e vet, dhe brenda disa orësh do të mbushet me “like”-t nga ndjekësit e tij. Ndër ta, studentët janë grupi më i madh i “konsumatorëve” të këtij lloj produkti intelektual. Ata që janë më aktivë në përhapjen e “pëlqimeve” për “prodhimet” e tij, janë gjithashtu ata që, pa dyshim, do të mbahen më mend dhe do të kalojnë provimet më lehtë. Ky fenomen ka krijuar një marrëdhënie të dyshimtë mes profesorit dhe studentëve, ku “kujdesi” i studentëve për të bërë “like” e “shpërndarë” publikimet e profesorit-influencer është një mënyrë për të siguruar kalimin e provimeve dhe kalimin në shkallë akademike. Kjo, natyrisht, nuk ka asnjë lidhje me një zhvillim të vërtetë intelektual apo me vlerat akademike, por më shumë me një lloj “transaksioni” të thjeshtë dhe të ndyrë.

Po ashtu, kandidatët për master dhe doktoratura janë gjithashtu pjesë e kësaj loje. Ata bëhen “kritikë letrarë” përmes shkrimeve dhe kritikave për librat e profesorëve influencer, që është më shumë një mënyrë për të arritur gradat akademike, sesa një vlerësim i sinqertë dhe profesional. Ky lloj “kriticizmi” që ka më shumë lidhje me “lidhjet” personale sesa me aftësitë e vërteta letrare, ka çuar në një fenomen të paprecedentë, ku puna intelektuale nuk matet më me vlera akademike dhe përmbajtjen e saj, por me sa “like” mund të marrë. Nëse një poezi apo një intervistë e një profesori-influencer botohet në një portal apo faqe elektronike letrare, është e mundur që të marrë vetëm disa “like” mund të marrë. Nëse një poezi apo një intervistë e një profesori-influencer botohet në një portal apo faqe elektronike letrare, është e mundur që të marrë vetëm disa “like” dhe disa qindra komente kritike, sharje, përbuzje e ofendime. Editorëve do t’ju duhet që të gdhinë dy-tri net duke fshirë e hequr komente negative

Letër nga diaspora

QENDRAT KULTURORE SI NJË NEVOJË IMANENTE

Sot kemi nevojë për disa qendra kulturore shqiptare, me një fushëveprim më të gjerë që do të ishte e përditshme, sepse sfidat e asimilimit dhe humbjes së gjuhës tashmë janë reale.

Neviana SHEHI/ ITALI

Shumica e të rinjve tanë, të lindur jashtë Atdheut të prindërve të tyre, tashmë me sukses janë integruar në shtetet ku veprojnë e jetojnë. Natyrisht, ata nuk e mohojnë prejardhjen e prindërve të tyre dhe janë krenarë me kulturën, gjuhën dhe historinë shqiptare, e cila histori na ka mësuar se shqiptarët edhe në të kaluarën, kudo që kanë qenë në një shumicë të konsiderueshme, janë organizuar dhe kanë vepruar si komunitet, duke dhënë një kontribut të veçantë në ruajtjen e identiteti kombëtar.

Por, sot, me ndryshimin e rrethanave, sidomos të dinamikës bashkëkohore të të jetuarit, organizimi i shqiptarëve jashtë atdheut të tyre, realizohet në forma tjera, kryesisht përmes qendrave kulturore apo shoqatave kulturore, të cilat funksionojnë dhe janë të shpërndara gjithandej në shtetet e Europës Perëndimore dhe përtej Atlantikut.

Këto qendra apo shoqata organizojnë aktivitete kulturore dhe artistike, si koncerte, ekspozita, promovime, mbështesin shkollat shqipe për të rinjtë, të cilat zhvillojnë aktivitete një herë në javë (të shtunave). Kuptohet, nuk mungojnë as organizimet për festat kombëtare dhe promovimi i traditës shqiptare. Këto qendra mund të konsiderohen edhe si ura lidhëse midis diasporës shqiptare dhe Atdheut, duke ndihmuar, pavarësisht nga rrethanat, në ruajtjen e identitetit shqiptar dhe duke forcuar lidhjet mes brezave të ndryshëm.

Organizimi në baza vullnetare, duam apo nuk duam ta pranojmë, bie në



nivelin e organizimit amator. E kundërta e kësaj është organizimi profesional, pra duhet të ndjehet dora e Atdheut. Sot kemi nevojë për disa qendra kulturore shqiptare, me një fushëveprim më të gjerë që do të ishte e përditshme, sepse sfidat e asimilimit dhe humbjes së gjuhës tashmë janë reale. Qendrat kulturore shqiptare janë thelbësore për ruajtjen e identitetit kombëtar të shqiptarëve që jetojnë jashtë trojeve etnike. Ato do të duhet të jenë të furnizuara me gjithçka që është shqiptare, që ka vlerë dhe e dalë nga shpirti shqiptar.

në respekt të “intelektualit” influencer! Ky është një shembull i qartë i ngërçit të krijuar nga ky lloj influencimi: njerëzit që kanë kuptim për vlerat e vërteta letrare, profesorin influencer e konsiderojnë si të pasinqertë dhe të pavlerë, ndërsa ndjekësit që janë më të interesuar për “prizën” e popullaritetit dhe statusit janë ata që e mbështesin këtë lloj “konsumimi” intelektual. Përkundër kësaj, të njëjtit intelektualë-influencerë janë gjithashtu ata që fokusohen më shumë në fitimin e “like”-eve sesa në ofrimin e kontributeve të vërteta intelektuale, që mund të shërbejnë si platforma për zhvillimin dhe avancimin e kombit. Ajo që është më e rëndësishmja është që ky lloj “intelektuali” e ka të vështirë të krijojë një platformë të qëndrueshme dhe me ndikim kombëtar, sepse ai është i përqendruar në një lojë të shpejtë për përfitim personal dhe në mbajtjen e një statusi të shpejtë, pa asnjë angazhim të thellë dhe të qëndrueshëm për avancimin e dijes dhe kulturës kombëtare.

Pa dyshim, influenceri mund të jetë i popullit, por ai gjithashtu mund të jetë një figurë që kërkon të manipulojë dhe të mashtrojë një audiencë të gjerë përmes marketingut të thjeshtë dhe të shpejtë. Ndërkohë, intelektual i, cili duhet të kontribuoni në rritjen e shoqërisë dhe zhvillimin e saj të qëndrueshëm, është i lidhur me vlera më të thella dhe me një përgjegjësi më të madhe për kulturën dhe historinë kombëtare. Të dyja këto figura mund të kenë ndikim të gjerë, por ndikimi i influencerit është shumë shpesh i njëanshëm dhe i shkurtër, ndërsa ai i intelektualit mund të jetë i qëndrueshëm dhe i ndjeshëm për ndryshime afatgjata.

Qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

qendra kulturore shqiptare nuk janë

Eliksiri i Epopesë

ETIKA E QENIES

Njëri nga ata që ishte kalitur në traditën epike, në traditën që prodhon, krijon imperativin kategorik moral, që në mënyrë të padiskutueshme detyron veprimin kundër atyre që e rrezikojnë qenien, identitetin, veçorinë, substancën, Zotin, që donte ta vriste ky apo ai pinjoll i invaduesve lindorë, ishte Adem Jashari.



Nga Arbën XHAFERI

Popujt e lashtë ballkanikë sidomos ilirët, të lodhur nga luftërat me Perandorinë Romake, ishin të pafuqishëm që t’u bëjnë ballë invaduesëve që vinin nga katër anët e botës, sidomos nga lindja, hunët, avarët, gotët, sllavët dhe së fundi turqit. Kronistët thonë se në atë kohë ilirët ishin aq të qytetëruar saqë kishin harruar edhe përdorimin e armëve. Invaduesit vinin valë-valë, plaçkitnin, vritnin, vandalizonin trashëgiminë kulturore të vendësve. E vetmja mbrojtje për ta ishte evakuimi në male. Konfiguracioni i tokës u mundësonte atyre evakuim të shpejtë dhe të sigurt. Disa analistë thonë se populli që sot identifikohet me emrin shqiptar, në dallim nga popujt e tjerë të antikitetit, shpëtuan nga zhdukja falë evakuimit të shpejtë. Që nga kjo kohë ata deshën a nuk deshën u bënë vëzhgues të proceseve të shumta që zhvilloheshin në vendet që i braktisën ata. Ata shihnin se si shthurej bota e tyre, se si përvetësoheshin të mirat e tyre materiale dhe shpirtërore, se si gurët e kështjellave, të shtëpive të tyre të shkatërruara vendoseshin në themelet e ngrehinave të reja, ata shihnin të pafuqishëm se si ndërtoheshin realitete, sisteme të reja. Ata vëzhgonin dhe ishin të pafuqishëm dhe të mllefosur. Këtë mllef ata shndërruan në urrejtje ndaj vrasësve, në përbuzje ndaj plaçkitësve, në neveri ndaj vandalistëve.

Të qenët vëzhgues krijoi kushte për ndërrim të roleve: nga gjahu, preja u bënë gjahtarë. Që nga kjo kohë shqiptarëve u është ngjitur etiketa e cubit, kaçakut, atij që pret, që vëzhgon dhe sulmon pa prituri. Kështu i cilësojnë shqiptarët ata që i pushtuan trojet e tyre, sllavët a turqit, që në gërmadhat e qyteteve të tyre, kështjellave tyre vendosën fillimisht

fshatrat e tyre e pastaj ndërtuan qytetet duke pandehur se këto vende gjithmonë u kanë takuar atyre. Nga ky këndshikim, perceptim i gabuar i qenies shqiptare është ndërtuar një interpretim kuazishkencor i proceseve historike, traditës kulturore fetare etj. që është bërë burimi lajthitjeve që përhapen me injorancë të pakuptimtë. Një lajthitje të këtyllë arrogante, të paturpshme e shprehu ish-kryetari i Ohrit kur shpjegonte kryeministrit bavarez se popullata e Ohrit përbëhet nga banorë autoktonë, sllavët dhe turqit dhe ardhacakët, shqiptarët!!!

Mostrajtimi adekuat i sfidës shqiptare

Pozita e vëzhguesit kishte rëndësi strategjike jo vetëm nga aspekti ushtarak, por edhe psikologjik ngaqë ngërthente në vete elementin e distancës ndaj sistemeve të reja që ngriheshin në habitusin e tyre. Aftësia e distancimit nga e reja, nga e huaja nxiste nervozizëm dhe mllef tek ardhacakët. Njëherësh këtu duhet kërkuar urrejtjen irracionale të tyre ndaj shqiptarëve. Sllavët ishin të mllefosur pse shqiptarët e “prapambetur” nuk i pranonin vlerat e tyre. Këtë habi madje shfaqnin edhe ata intelektualë sllavë që në kontekstin ksenofobik të krijuar në Jugosllavi, trajtoheshin si albanofilë, si bie fjala kroati Branko Horvat. Ai në një rast shprehu befasi për se shqiptarët nuk paskan pranuar alfabetin latin të fqinjëve të tyre sllavë, por kanë pranuar disa zgjidhje të huazuara nga anglezët, apo të shpikura nga ata vetë! Edhe ata që ishin më të prirë që objektivisht ta trajtojnë sfidën shqiptare nuk kishin mirëkuptim për këtë distancë mitike, për këtë refuzim të vlerave sllave. Këtë mllef në forma të ndryshme kanë shfaqur edhe turqit. Ata na quatin “kaba arnaut” (shqiptar të

vrazhdë, të papërpunueshëm), ndërkaq serbët na stolisin me epitete të ndryshme “nepopravilivi” (të pandreqshëm), “nepokorlivi”(të papërkulshëm). Marrë në tërësi shqiptarët në këtë periudhë të gjatë të robërisë asnjëherë nuk u shndërruan në rajë (popullatë e përkulur) ashtu si trajtoheshin sllavët gjatë periudhës otomane. Këtë tipar të vëzhgimit, të distancimit shqiptarët tregonin jo vetëm ndaj të huajve, por edhe ndaj vetë shqiptarëve që arratiseshin në sistemet e huaja. Ndaj tyre merrnin masa të padurueshme të veçimit, të leçitjes në trajta të ndryshme. Okupuesit të bindur se ky tipar i shqiptarëve është i pandryshueshëm, të bezdisur nga vëzhgimi i vazhdueshëm, nga distancimi i tyre, nga joluajaliteti, nga “syri i keq” i rezervuar, shpesh herë merrnin masa ndëshkuese mbi baza të prezumcionit, të fajësisë së nënkuptuar, të padiskutueshme. Kjo trajtesë mori përmasa përbindëshi në periudhën e instalimit të shtetit të sllavëve të jugut që u quajt Jugosllavi. Të gjitha elaboratet që janë punuar në këto periudha kanë pasur për argument qendror, prezumcionit e fajit gjenetik, konstatimin se ata janë element i papërpunueshëm, i pabindur dhe si të tillë do të jenë gjithmonë rrezik potencial për rendin e ri që ata ndërtonin në habitusin e tyre. I fundi nga ata pinjollë të invaduesve të lashtë që deshi të shpëtojë veten dhe popullin e tij nga ky vëzhgim distancues, nga ky element i huaj që nuk komponohej në sistemin e ri, ishte Millosheviqi. Ai të gjitha ekspeditat e mëparshme kundër shqiptarëve i quajti të buta, joefikase që nuk arrinin të vrisnin bindjen e tyre që ta ruajnë veçorinë, ose si thuajnë vetë serbët “ta vrisnin Zotin në ta” (“da ubiju boga...”). Kjo frazë serbe nënkupton se veçoria e këtyllë kokëforte

që nuk ndryshon është diçka substanciale, e dhuruar nga Zoti, prandaj veçorinë e krahasonin me të. Millosheviqi njëmend mori një fushatë të egër që në vete përmbante tri opsione: disiplinimin, shpërnguljen ose shfarosjen e tyre. Disiplinimi filloi me presion ideologjik që kishte për qëllim diferencimin, ndarjen e shapit prej sheqerit. Në këtë kohë u prodhua nocioni neveritës i shqiptarit të ndershëm, të integruar në sistemin e ri, madje më të ri, në atë të Millosheviqit dhe shqiptarë të tillë shfaqeshin ndonëse në numër shumë të vogël. Ata shqydheshin nga dilema: ta pranojnë ofertën joshëse të regjimit dhe të jenë objekt i vëzhgimit tallës, leçitës i pjesëtarëve të padorëzuar të kombit, apo të refuzojnë dhe të jenë objekt i disiplinimit si i tërë populli që tashmë nga regjimi trajtohej si turmë. Kjo dilemë krijonte variacione të ndryshme duke filluar nga ata që pa dilema refuzonin transformimet e tilla e deri te ata që pa dilema pranonin rolet e reja. Në mes të këtyre dy skajeve gjendeshin oportunistët që bashkëpunonin ose rezistonin, por jo deri në fund. Kjo kategori racionalizonte idenë e bojkotit difuz, të pahetueshëm të projekteve të sistemit dhe e kritikonte idenë e konfrontimit direkt. Motoja e kësaj faze politike ishte durimi, pritja që „zullumi të këputet prej së trashi”. Regjimi i Millosheviqit megjithatë nuk arriti që bëjë diferencimin mes të shqiptarëve të përpunueshëm, të mirë, luajal dhe atyre të këqij dhe të pabindur, prandaj kaloi në fazën e dytë, atë të shpërnguljes. Këtë, sipas recetave të vjetra synonte të arrijë duke krijuar rrethana të pamundshme për jetë normale dhe të sigurt. U përjashtuan nga puna të gjithë ata që nuk nënshkruanin dokumentin për luajalitet ndaj rendit

HEJZA

Thyerja e surrogatit komik për shqiptarët

Për të qenë theomah duhet të jesh i gatshëm ta paguash çmimin. Çmimi është jeta e sfiduesit, pësimi i tij. Adem Jashari, nuk ishte theomah i thjeshtë, ngaqë ai nuk e sakrifikoi vetëm veten, por tërë familjen e tij. E tërë familja e tij ishte e përbërë nga theomahë. Ai ishte i vetëdijshëm se kulla e tij s’do t’i bënte ballë kazermës serbe, ai dinte se armët e tija nuk mund t’i kundërviheshin arsenalit serb. Ai dinte se do të vdiste dhe megjithatë, si theomah i vërtetë, si Prometheus s’pushonte së sfiduari. Dhe ndodhi gjëma, sakrifikimi i një familje të tërë, sakrifikim për dinjitet, për krenari kombëtare. Ai e kapërceu Rubikonin e frikës, e shpërtheu himeren serbe. Ai dhe familja e tij e paguan taksën më të shtrenjtë për domethënien e nocionit shqiptar. Koncepti i tij për shqiptarinë nuk përputhej me surrogatin komik që kishin arritur ta farkonin serbët. Flijimi i tij i dha një ngjyrë, një vlerë të re politikës shqiptare. I tërë populli shqiptar pas kësaj refuzoi të bëjë çfarëdo pakti me Millosheviqin dhe pranoi të jetë pjesë e një kalvari kolektiv. Po të arrinte regjimi i Millosheviqit të bënte për vete vetëm 5% të popullatës shqiptare (100.000 banorë), të sajonte një regjim kukull si gjithkund në botë, nuk do të kishte NATO në këto hapësira, as procese demokratizuese në këtë pjesë të Ballkanit. Flaka në kullat e Jasharajve, vdekja e një familje të tërë në esencë dogji shtyllat e një rendi të ri, të egër jodemokratik sllav në këto hapësira dhe hapi shtegun për një proces që do të sjellë vlera të njëmenda njerëzore, politike, ekonomike në këto hapësira. Tash e tutje të gjithë ata që do të vinë pas tij do të micërojnë nga sakrifica e tij dhe të theomahëve të tjerë shqiptarë. Për të qenë sfidues i një formati të këtilllë mitik si Adem Jashari, duhet të kesh, siç do të thoshte Erich Fromm, etikën e qenies. Adem Jashari e kishte qenien etike.

të ri, u morën masa të ndryshme të stimulimit të shpërnguljes dhe vargani i autobusëve, aeroplanëve i bartnin shqiptarët në vendet e sigurta. Kur edhe ky opcion nuk dha sukses të pritur meqë të shpërngulurit u bënë burim financiar për mbijetesën e të mbeturve në atdhe, regjimi kaloi në variante jokonvencionale të shfarosjes fizike, të paimagjinueshëm për kontekstin qytetërues evropian. Meqë ky opcion duhej realizuar shpejt, në mënyrë efikase dhe të pamëshirshme për këtë punë u angazhuan kriminelët gjakpirës që përvojat e tyre në hapësirat tjera jugosllave duhej në mënyrë sa më të ngjeshur ta zbatonin në Kosovë.

Adem Jashari- personalitet i krijuar nga imperativi kategorik moral

Ky ishte këndshikimi dhe projekti serb për vendosje të rendit të ri, por si zakonisht edhe shqiptarët „e papërpunueshëm“, „ të papërkulshëm“, distancues i kishin edhe kësaj radhe vëzhguesit e tyre, atë kategori të njerëzve që analizonin veprimet serbe nga këndi i interesit shqiptar. Njëri nga ata që ishte kalitur në traditën epike, në traditën që prodhon, krijon imperativin kategorik moral, që në mënyrë të padiskutueshme detyron veprimin kundër atyre që e rrezikojnë qenien, identitetin, veçorinë, substancën, Zotin, që donte ta vriste ky apo ai pinjoll i invadiesve lindorë, ishte Adem Jashari. Ai në fillim, me ndruajtje që shprehte mirësjellje ndaj prijësve të kombit e vëzhgonte situatën, priste se çka do të sjellë retorika e re, qetësuese, gudulisëse. Rezervat, distancën e mbante për vete dhe për rrethin e tij të ngushtë. Nuk eksponohej, nuk imponohej. Tashti dikush e kujton atë se si dikur dhe diku e ka parë në mesin e gazetarëve të shumtë duke ndjekur ndonjërën nga konferencat e panumërta të shtypit. Dikush nga zyrtarët e dikurshëm të Shqipërisë apo të Kosovës sot krenohen

që e paskan nderuar atë me pranim pesë minutash për bisedime për shqetësimet e tija të thella për proceset që zhvilloheshin në Kosovë dhe hapësirat tjera. Është fakt se në atë kohë ai, energjia e tij, morali i tij, gatishmëria e tij, vlerësimi i tij i situatës nuk u hetua. Ne ishim të verbër për të parë këtë vlerë. Ne, të tmerruar nga frika që sistematikisht mbillej dhe shtohej nga sistemi represiv i Millosheviqit, silleshin si ai i mbyturi të cilit uji i ka ardhur deri te goja dhe nuk merrte guximin të lëvizë fare për ta pranuar dorën e shpëtimit. Në atë kohë ne nuk e njohëm atë, misionin e tij ngaqë frikësoheshin nga kalvari që shpinte drejtë shpëtimit. Ne nuk e njohëm atë, mu si Ahasferi Jezuin kur refuzoi t’i ofrojë prehje, kështu që Zoti, për këtë gjymti shpirtërore e dënoi atë që të bredhë, sorollatet nëpër botë duke kërkuar dhe mos e gjetur kurrë kuptimin e jetës. Pas arritjes së Marrëveshjes së Dejtonit, shqiptarët më në fund kuptuan se Kosova mbeti jashtë optikës,interesimit, agjendës së faktorëve vendosës. Por jo vetëm kaq. Kosova ishte e mbërthyer, e pacifikuar nga forcat militare dhe paramilitare serbe. Ata kishin arritur qëllimin. Plaçkitnin, torturonin, dhunonin, vritnin, bënin ç’t’u tekej, si kurrë më parë. Kishin depërtuar edhe në botën e ëndrrave tona. Befasia nga mungesa e rezistencën ua shtonte tërbimin dhe imagjinatën kriminale. Ata ishin të mbushur me mburrje, ne të zbrazur nga vetëbesimi, si hije të gjalla. Edhe shpresat ishin të fikura. Zymtësinë e padurueshme e theksonte edhe më shumë muzika e instrumenteve frymore serbe, një përzierje e ritmeve ushtarake dhe të ciganëve bredhacak. Madje në qendër të Prishtinës ndihej aroma e specialiteteve fshatareske serbe, “ leskovaçka muçkalica” që shërbente si mëlmesë për ta bërë më të shijshme gjellën që e kishin gatuar me shekuj. Ata me kabadahillëk të papenguar e festonin, e demonstronin “superioritetin” e tyre.

Ndërkaq ne vetëm i regjistronin të bëmat e tyre. Në atë kohë, kur ata pandehnin se më në fund arritën ta vritnin Zotin në ne, në popull flitej se disa drenicakë kanë sosur ta kthejnë pushkën. Disa të tjerë nga frika ose përgjegjësia që të mos përhapet ky opcion, apo nga frika që propaganda serbë të mos shfrytëzojë këtë si pretekst për represion më të egër, këtë dukuri të re e cilësuan si sajësë të UDB-së. Në këtë periudhë rastisi që një gazetar kosovar, Aqif Mulliqi, kërkoi nga unë një intervistë dhe një prononcim për këtë dukuri. Pyetjen e parë që ia bëra ishte: a janë ata të vërtetë, a i ke parë ti vetë, a ke folur me ta, e janë seriozë etj. Ai shkurt ma ktheu: burra janë. Kjo përgjigje e tij nuk m’u duk aspak folklorike, por kishte në vete një domethënie të thellë, një shpresë se Zoti në ne ende s’ishte vrarë. Nga kjo kohë më lidh një miqësi, një simpati për kumtuesin e lajmit, nga kjo kohë m’u krijua një bindje e pathyeshme për vlerën e re që solli theomahu më i ri shqiptar, Adem Jashari. Në Greqinë Antike theomahos quheshin heronjtë që sfidonin zotërat apo prishnin rendin e paracaktuar. Theomahu mitik ishte Prometheus, ndërkaq ai historik ishte Sokrati. Theomahët gjithmonë kanë qenë të ndëshkuar për guximin, arrogancën, me të cilën kanë sfiduar pushtetin, autoritetin e zotërve apo rendin që ata patën vendosur. Prometheus u gozhdua për shkak se Zeusi donte t’i shfaroste njerëzit për shkak të xhelozisë ndaj tiparëve të tyre. Siç dihet Prometheus e vodhi zjarrin nga perënditë dhe ua fali njerëzve për t’i shpëtuar ata nga zhdukja. Adem Jashari na e ktheu vetëbesimin, domethënien fjalëve tona, këngëve tona, krenarinë që pandehnin se e kishin. Me aktin e tij flijues, me sfidimin e tij ai vuri në sprovë të vërtet kabadahillukun serb, vetëmburrjen e tyre dhe burrërinë tonë. Dhe punët nuk dolën ashtu si ishin mësuar serbët.

Reflekse

OPOZITARIZMI KONSERVATOR

Metternich absolutizon status quo-në para revolucionit. Falë pozicionit që kishte në krye të një prej fuqive më të mëdha europiane, ai arriti të vonojë në mënyrën më të zgjuar e të menduar hollë, zhvillimin politik të një pjese të madhe të Evropës kontinentale

Ervina TOPTANI

Shembujt që Shqipërisë i kanë munguar te liderët drejtues të shtetit. Për pasojë ndodh kaosi i madh politik në të gjitha kohërat e mëvonshme, sepse ne nuk kemi kulturë e as memorie politike të shtet-bërjes. Në ridimensionimin e historisë së mendimit, shpesh theksohet karakteri antinacionalist i konservatorizmit. Që konservatorizmi në të vërtetë bashkë-identifikohet me të njëjtën origjinë iluministe si liberalizmi, del e qartë te Burke (1728 –1797), por akoma më shumë te politikani konservator më efektiv që prodhoi Europa e gjysmës së parë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, Clemens Lothar, konti Metternich (1773-1859). Ashtu si Burke, Metternich mban kahun e supozimit teorik të ekuilibrit, por me diferencën se ky parim i matricës shkencore-racionaliste përshkallëzohet dhe ndjehet më fort në profilin e tij politik. Në fakt, Metternich absolutizon status quo-në para revolucionit. Falë pozicionit që kishte në krye të një prej fuqive më të mëdha europiane, ai arriti të vonojë në mënyrën më të zgjuar e të menduar hollë, zhvillimin politik të një pjese të madhe të Evropës kontinentale. Metternich ishte njeri me parime të qarta iluministe (për të sqaruar se çfarë është iluminizmi për ata që nuk e kanë të qartë, ju rekomandoj të klikoni në google në enciklopedinë tashmë dhe online “La Treccani”. Po ta sqaroja, shkrimi do të dilte shumë i gjatë). Babai i tij, një diplomat dhe mason i kryepeshkopatës së Trevirit, herë pas here ia besonte fëmijët e tij një mësuesi protestant, por Metternich u thellua ndjeshëm në trashëgiminë intelektuale të iluminizmit



në Universitetin e Strasburgut, ku studioi duke filluar nga viti 1788. Pas shpërthimit të revolucionit, ai shkoi në Mainz ku vazhdoi studimet me historianin e mirënjohur Niklas Vogt, mbështetës i rëndësishëm “letrar” i konceptit të ekuilibrit. Në veprat e tij “System des Gleichgewichts” (1785) dhe në veprën tjetër të tij madhore, “Über die Europäische Republik” (1787-92) në pesë volumet e kësaj vepre, Vogt shkruante se të gjithë njerëzit jetonin sipas dy forcave të kundërta orientimi, tërheqjes dhe zmbropsjes, dashurisë dhe urrejtjes, dëshirës dhe neverisë, por ishte njëkohësisht i bindur që ekzistonte dhe një tendencë konstante ekuilibri që në fund do të sillte fitoren e padiskutueshme të iluminizmit, që do të thotë pika e rëndesës së ekuilibrit të lumturisë e stabilitetit, në krahasim me forcën e veprimet e

detyruara tek pjesa më e madhe e masave civile. Bërthama e ekuilibrit vogtian u bë parimi bazë dhe guri i themelit të idesë së Metternich në vesten e tij primare si diplomat austriak, më pas ministër i jashtëm dhe kancelar i perandorisë (kryeministër). Shpirti i njeriut mbushet kur është i detyruar të punojë me ekstremet - mendonte ai. Ndaj është e nevojshme të zëvendësohet një shekull i pafe` dhe doktrinash të rreme filozofike me një epokë reagimi moral dhe fetar. Gjatë ushtrimit të detyrës së tij, në vitin 1789, duhej të ndiqte një ritëm më të ngadaltë e të ndryshonte taktikën e qeverisjes së tij, përndryshe nuk do të ishte e mundur të arrihej ekuilibri midis parimeve të shkatërrimit dhe asaj të ruajtjes që në botë veprojnë vazhdimisht

kundër njëra-tjetrës. Përsa i takon pjesës politike, ai e konceptonte atë të ndarë ndërmjet një ekuilibri të dyfishtë: atë të jashtëm, të shteteve europiane ndërmjet tyre dhe atë të brendshëm, të shteteve të marra veç e veç. Elementi dinamik duhet të zhdukej nga politika e brendshme e duhej ristabilizuar rregulli i brendshëm social dhe ekonomik. Kështu e konceptonte Metternich ekuilibrin social. Nuk ekziston rregull dhe jetesë normale në një shtet apo në një Perandori shumëkombëshe nëse njerëzit nuk kanë minimalisht stabilitet ekonomik. Pas stabilitetit ekonomik vjen dhe stabiliteti social e intelektual. Forma më ideale e shtetit, sipas tij, ishte monarkia. Po i referohemi kohërave kur konceptimi politik i qeverisjes së vendit mendohej si pozicionimi i ndërmjetëm midis tiranisë së masave dhe despotizmit të një njeriu të vetëm, udhëheqësit.

Metternich mendonte se ishte detyrë primare e shtetit, qeverisë e udhëheqësit të vendit që të mendonte pandërprerë për mirëqenien e shtetasve të tyre dhe garancisë së lirive individuale aq sa këto të dyja të përputheshin e të mos kishte ndërprerje të zinxhirit nga pjesa shumë e rëndësishme e drejtësisë dhe ruajtjes së ligjeve shumë të forta në lidhje me drejtësinë dhe respektimin e pronës private. Metternich ishte i mendimit se një shtet që ka dhënë prova konkrete dhe ka pasur sukses në zhvillimin e prosperitetin e tij, duhet të ndërhyjë në mënyra të ndryshme (shpesh kjo gjë sipas mundësive e formave të kërkuara nga vetë shtetet në vështirësi) për të ndihmuar e asistuar shtetet që nuk ishin në ekuilibër prej mosmarrëveshjeve e problemeve.

Midis nesh

ARTI SI ÇËSHTJE HYJNORE

I rikthehemi figurave të shquara sërish e sërish, me shpresën e vetme të rikthimit nën dritën e diellit, të vetmes, të vërtetës, me qëllimin universal, të civilizimit dhe të konvertimit të shoqërisë sonë në shoqëri perëndimore dhe frytdhënëse



Alesia XHOGU

Ismail Kadare do të thotë: “Të shkruaje në diktaturë ka qenë e vështirë, thuajse e pamundur. E pamundur të shkruaje siç dëshiroje të shkruaje. Ja përse unë i jam mirënjohës letërsisë: Letërsia më dha mundësinë të kapërceja të pamundurën. Ferri komunist, si çdo ferr tjetër, është mbytës në kuptimin më të keq të fjalës. Por, letërsia arrin ta transformojë atë në një forcë jete, në një forcë mbi të cilën mbështetesh për të mbijetuar, për të mundur me kokën lart çdo gjë.” Ndiej keqardhje për të shumtën herë mundësi të dhënë literaturës shqipe, pasi zhgënjim pas zhgënjimi e mundësi pas mundësie, si një rreth ciklik i pashtershëm, konkluzioni vërtitet rreth së njëjtës gjë. Ndonëse mundohem ta mirëkuptoj e në të njëjtën kohë e përcmoj, regresi i kombit tonë, me keqardhje më duhet ta them, e largon lexuesin nga literatura shqipe. I falemi të parëve tanë sërish e sërish. I rikthehemi figurave të shquara sërish e sërish, me shpresën e vetme të rikthimit nën dritën e diellit, të vetmes, të vërtetës, me qëllimin universal, të civilizimit dhe të konvertimit të shoqërisë sonë në shoqëri perëndimore dhe frytdhënëse. Ndonëse e kuptoj misionin sublim, bie shpesh herë në vorbullën e errët të nihilizmit që të shkakton arsyeja e fillim-përmundur, shtimi i veprave letrare

në pothuajse unanime në tematikën e vetme: regresioni. “Shqipëria u krijua nga Zoti, shpëtoi nga rastësia dhe u vra nga politikanët”, tha i madhi Faik Konica. Mos ndoshta kemi nevojë për një katarsis kolektiv? Apo mos ndoshta kemi harruar të argëtojmë shoqërinë nëpërmjet literaturës fantastike-shkencore? Është i çuditshëm fakti se si një individ mund të adhurojë një shkrimtar të atdheut të tij, e më pas teksa ky shkrimtar përshkruan atdheun, pa dashur, e jo për faj të tij, magjia e tij prishet. Vuajtje-ankesat janë tanimë refren i literaturës sonë. Mesa duket kemi priurë mazokiste! Është e vështirë të lësh atdheun tënd, por akoma më e vështirë ta pranosh atë, ndoshta për faktin e vetëm, disi konspirativ (por edhe faktik), i cili na ka shpëlarë trurin me pallavra të llojit tallava, duke mohuar historinë e të parëve tanë. Ata nuk janë kujtuar kurrë! Sa prej nesh e dinë prejardhjen e alfabetit shqiptar në raport me festuesit e kësaj dite kombëtare? Sa prej nesh e dinë historinë e kulluar, të padeformuar e të pacenuar në raport me sharlatanët që vërtiten në çdo cep të këtij kombi, duke shpërndarë helmin e mediokritetit? Ndonëse plumbi del me plumb, dhe po, edhe ky shkrim ka trajtat e një vuajtje-ankese, fatkeqësisht, me shpresën e vetme për të shërbyer si një reflektim për çdo qytetar, për çdo shqipfolës, për çdo


shkrimtar të ri, të cilët kanë potencialin të shkatërrojnë e rindërtojnë një literaturë të re, shpresëdhënëse dhe perëndimore, sepse nëse Petro Nini Luarasi, At Gjergj Fishta, Naim Frashëri, Nënë Tereza e shumë personalitete të tjerë kontribuan për këtë komb dikur, nuk qenka e mundur sot? E ardhmja është e tashmja, mjafton vetëm të lexohen premiset (!) dhe si e tashme e ardhme është detyrë primordiale e qenies njerëzore krijimi i oazës individuale, së pari, e më pas kjo oazë injektohet në mënyrë natyrale në shoqërinë tonë, duke e bërë mendësinë të shokohet, të ndryshojë formë, harmonizohet dhe unifikohet, duke e bërë humanizmin të triumfojë përballë mediokritetit. Dija është çelësi! E ardhmja qëndron përpara syve tanë, e shëmtuar dhe cinike, por jo absolute për sa kohë shpresa ndriçon sado pak. Nuk është formulë e pa dëgjuar më parë, por është formulë e risjellë sërish e sërish për të reflektuar, së pari për individin, së dyti për shoqërinë e së tashmes dhe të së ardhmes. Ky vend është i bekuar në pasuri natyrore e në figura, të cilat kanë dhënë jetën për këtë vend. Ja vlen sado pak të jemi kontribues të atdheut tonë! Është kjo shtysë e cila duhet të na udhëheqë për të ruajtur cilësinë e jetesës në këtë vend, nëpërmjet procesit empirik të gjithsecilit prej nesh, por dhe nëpërmjet procesit shpirtëror i cili mban emrin art. Nuk është

e nevojshme të risillet definicioni i artit në këtë shkrim, por është e nevojshme të sulmohet çdo grimcë mediokriteti, të cilat duan të njollosin artin. E kur them sulm, i referohem të vërtetës, asaj së cilës shumë i frikësohen dhe e konsiderojnë sulm. Në morinë e shumtë të lavdërimeve fallce e të pashoqe, këta pseudo-intelektualë po injektojnë akoma dhe më shumë mediokritetin në shoqëri. Përparim Kabo në librin e tij Antropologjia e frymës na paraqet tablonë e përcudnimit të historisë nga pushtetarët, por në të njëjtën kohë, na paraqet edhe anën tjetër të medaljes: përqeshjen që historia i bën këtyre njerëzve sapo ata bien nga pushteti. Historia mbetet aty, kujtesa po ashtu. Është gjithçka çështje kohe. Ndonjëherë miklimi artificial i shndërron këta njerëz në mbinjerëz, në kuptimin më të keq të fjalës. Reflektimi për këtë kategori është i pamundur. E gjithë kjo vorbullë miklimi-mungesë reflektimi vjen si pasojë e egos së tepruar, e kjo ego e tepruar vjen si pasojë e mungesës së dijes. Si një dorë e padukshme arti i kulluar të nxjerr nga ajo vorbullë nihilizmi për ta parë këtë vorbull, tani nga lart, me një epërsi. Epërsinë që të jep humanizmi. Arti është hyjnor dhe si i tillë le të kryejë misionin e tij. Le të jetë shëmbëlltyra e Krijuesit, forcës supreme!

Profile

MILAN SHUFLAJ, ALBANOLOGU I SHQUAR

Ai është një figurë thuajse mitike për shqiptarët. Padyshim për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në studimet historike dhe albanologjike, si dhe për mbështetjen e tij për çështjen shqiptare. Dhe sepse ai është konsideruar si një nga historianët dhe albanologët më të rëndësishëm të fillimit të shekullit XX...



Leonard VEIZI

...Nuk ishte rastësi që Milan Shufllaj, ekzekutohet vetëm një ditë pasi ai ishte kryer nga një vizitë që kishte bërë në Shqipëri. I ftuar dashamirësisht nga qarqet intelektuale shqiptare ai mbërriti në Tiranë në 12 janar të vitit 1931.

Në Shqipëri

Nga dokumentacioni i bërë publik tashmë thuhet se gjatë qëndrimit në Shqipëri, më 16 janar 1931 Shufllaj mbajti një fjalim në Parlamentin shqiptar. Hollësisht ai shtjelloi punën rreth botimit të vëllimeve në vazhdim të “Acta Albaniae”, si dhe të “Historisë së Shqipërisë”. Për këtë gjë, Parlamenti shqiptar nga buxheti i shtetit, urdhëroi ministrin e arsimit, Hilë Mosin, që në emër të shpenzimeve të paguante në “Banque Commerciale de Bâle á Zurich”, në llogari të Dr. Milan Shufllaj-t, shumën prej 75.000 frangash ari. Ditët e qëndrimit në Shqipëri Shufllaj i shfrytëzoi për të mbledhur edhe disa të dhëna për disa monumente mesjetare që kishin ngel të patrajtuara në studimet e mëparshme. Ai kërkoi të merrte përsipër gjurmimin e burimeve të periudhës 1406-1536, të cilat më vonë do t’i botonte në vëllimet e tjera të “Acta Albaniae” Në 17 shkurt 1932 Milan Shufllaj gjendej përsëri në shtëpinë e tij në Zagreb. Një ditë më pas anëtarët e organizatës “Jugosllavia e Re”, i zunë pritë në pragun e derës dhe e goditën me mjete të forta në kokë. Ishte 51-vjeç. Ndërsa thuhet se pas këtij akti brutal atentatorët hynë në banesën e tij dhe morën dorëshkrimin e librit të tretë “Codex Albanicus”.

Për shqiptarët

Shufllaj kishte një lidhje të veçantë me Shqipërinë dhe çështjen shqiptare. Ai ishte një nga studiuesit kryesorë të historisë

shqiptare mesjetare dhe autori i disa veprave themelore në albanologji. Një nga kontributet e tij më të rëndësishme ishte pjesëmarrja në botimin e “Acta et Diplomata Res Albaniae,” një koleksion i jashtëzakonshëm dokumentesh historike që përmban burime nga shekulli XIII deri në shekullin XV. Ky vëllim, i përgatitur në bashkëpunim me studiuesin Ludvig Thalleksi dhe Konstantin Jiriček, përbën një nga bazat më të rëndësishme për studimet mbi historinë e Shqipërisë mesjetare. Ai përmban diploma, traktate dhe dokumente të tjera të rëndësishme që hedhin dritë mbi marrëdhëniet politike, shoqërore dhe ekonomike të Shqipërisë me fuqitë e kohës. Ky punim monumental ndihmoi në ndriçimin e historisë shqiptare dhe ofroi një perspektivë të re mbi rëndësinë e Shqipërisë në zhvillimet rajonale dhe evropiane. Shufllaj gjithashtu mbështeti përpjekjet për pavarësinë e Shqipërisë dhe kishte lidhje me intelektualët shqiptarë të kohës. Kontributi i Shufllaj-t në historinë dhe kulturën shqiptare është vlerësuar lart nga studiuesit dhe historianët shqiptarë. Ai konsiderohet si një nga figurat kryesore të albanologjisë dhe një mbrojtës i çështjes shqiptare në një kohë kur Shqipëria përballej me sfida të mëdha për të ruajtur identitetin dhe pavarësinë e saj. Disa nga librat e tij kryesorë janë: “Kufijtë e Shqipërisë në mesjetë”, “Shqipëria mesjetare”, “Biologjia e fiseve të popullit shqiptar”, “Qytete e fortifikata të Arbërisë, kryesisht gjatë mesjetës”, “Serbët dhe Shqiptarët” etj. Në Shqipëri, Shufllaj është kujtuar dhe nderuar si një mik i madh i kombit shqiptar. Punimet e tij kanë qenë një burim i çmuar për historianët shqiptarë dhe kanë ndihmuar në ndriçimin e periudhave të errëta të historisë së vendit. Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe institucione të tjera shkencore e kanë përmendur shpesh në studime dhe

konferenca shkencore mbi historinë mesjetare shqiptare. Në vitet e fundit, vepra dhe kontributi i tij kanë marrë vëmendje më të madhe, duke u përfshirë në botime akademike dhe ekspozita të organizuara në Shqipëri dhe Kosovë. Historianët shqiptarë e vlerësojnë Shufllaj-n si një figurë të pazëvendësueshme në studimet albanologjike, duke e cilësuar si një nga të huajt që ka dhënë një ndihmesë të madhe për ruajtjen dhe dokumentimin e identitetit shqiptar.

Atentati

Milan Shufllaj ishte bërë pengesë e madhe në realizimin e projekteve të mëdha antishqiptare. Ndaj më 18 shkurt 1931, ai u godit nga atentatorë të paguar nga shërbimet sekrete jugosllave. Ndërroi jetë disa orë më pas nga plagët e marra. Ky akt shkaktoi zemërim të madh në qarqet intelektuale evropiane. Sipas të gjithë dokumentacionit thuhet se Albert Einstein dhe Hajnrik Men, të alarmuar nga dhuna shtetërore kundër Shufllaj-t, i shkruan një letër Lidhjes së Kombeve duke dënuar regjimin jugosllav për shtypjen e fjalës së lirë dhe persekutimin e intelektualëve. Por nuk ishin të vetmit këta që reagueshan ndaj atentatit makabër. Në qershor të vitit 1940, në Banovinën e Kroacisë, u organizua një gjyq për vrasjen e Shufllaj-t. Vrasësit ishin agjentët e policisë Branko Zverker, Lubomir Bellosheviç dhe Stevo Veçerinca. Të nxjerrë në gjyq ata deklaruan se vendimi për likuidimin e Shufllaj u mor me 15-16 shkurt 1938 në zyrën e shefit të policisë të Zagrebit. Të akuzuarit më pas arritën të largoheshin për në Beograd. Të gjitha përpjekjet e mëvonshme për t’i ekstraduar ishin të pafrytshme. Vrasja e Shufllaj-t nuk ishte vetëm një sulm ndaj tij personalisht, por edhe një përpjekje për të heshtur një brez intelektualësh që kërkonin të mbronin identitetin dhe të

drejtat e popujve të shtypur nga regjimi jugosllav. Megjithatë, puna e tij në fushën e historisë dhe albanologjisë mbetet një dëshmi e përkushtimit të tij ndaj së vërtetës dhe dijes.

Epilogu

Milan Shufllaj, një nga intelektualët më të shquar kroatë të fillimit të shekullit XX. Ndërsa akti tragjik ndaj tij konsiderohet si një goditje ndaj dijes, kulturës dhe rezistencës intelektuale ndaj diktaturës mbretërore serbo-kroato-slllovene. I lindur më 9 nëntor 1879 në Lepoglava, Shuffaj ishte historian, albanolog, dhe politikan i shquar. Ai dha një kontribut të madh në studimet mbi historinë mesjetare të Ballkanit, veçanërisht mbi Shqipërinë dhe marrëdhëniet e saj me Europën Perëndimore. Si një ndër themeluesit e albanologjisë moderne, ai bashkëpunoi me dijetarë të shquar evropianë dhe ishte pjesë e një rrjeti akademik që synonte të thellonte studimet për shqiptarët. Milan Shufllaj la pas shumë studime të papërfunduara në dorëshkrim, një pjesë e mirë e të cilave ruhet në Arkivin Shtetëror të Kroacisë në Zagreb. Sot, Milan Shufllaj kujtohet si një nga figurat më të rëndësishme të studimeve mbi historinë shqiptare dhe si një dëshmor i luftës për liri intelektuale dhe të drejtat e popujve të Ballkanit. Ish-Presidenti i Republikës Alfred Moisiu, në sesionin shkencor “Shufllai dhe Shqiptarët” të organizuar nga Akademia Shqiptare e Shkencave në Tiranë, e dekoroi Shufllajn pas vdekjes me Urdhrin “Naim Frashëri i Artë”, me motivacionin “Për kontribut të shquar në studimet albanologjike, për karakterin shkencor dhe objektiv të mbrojtjes së çështjes shqiptare në veprën e tij”. Posta Shqiptare në vitin 2013 emetoi një sesion pullash me portretin e tij.

Reflektime

MBI KONTRATËN SOCIALE DHE ÇIÇIKOVËT

Sistemi ynë është i zbrazët vërtet, por Rousseau thotë " Më i forti nuk është kurrë mjaftueshëm i fortë për të sunduar gjithmonë, nëse nuk e shndërron forcën e tij në të drejtë dhe bindjen në detyrë"

Mirela PAPUÇIU

Po lexoja Rousseau “Du contrat social” i cili na thotë (po e përkthej): “Ashtu si bariu ka një natyrë më të lartë se ajo e kopesë së tij, edhe barinjtë e njerëzve, që janë krerët e tyre, kanë një natyrë më të epërme se ajo e popujve të tyre. Kështu arsyetonte, sipas Filonit, perandori Kaligula, duke nxjerrë mjaft mirë nga kjo analogji përfundimin se mbretërit ishin perëndi ose se popujt ishin kafshë.

Arsyetimi i Kaligulës është i njëjtë me atë të Hobbes dhe Grotius. Aristoteli, para tyre, kishte thënë gjithashtu se njerëzit nuk janë të barabartë nga natyra, por se disa lindin për skllavëri dhe të tjerët për sundim.

Aristoteli kishte të drejtë, por ai e ngatërronte pasojën me shkakun. Çdo njeri i lindur në skllavëri, lind për skllavëri, dhe asgjë nuk është më e sigurt se kjo. Skllavërit humbasin gjithçka në prangat e tyre, madje edhe dëshirën për t’u çliruar: ata e duan robërinë e tyre, ashtu si shokët e Uliksit donin marrëzinë e tyre.


Nëse, pra, ka skllavër nga natyra, kjo ndodh sepse më parë ka pasur skllavër kundër natyrës. Forca krijoi skllavërit e parë, ndërsa frika dhe lëshimi i tyre i bëri ata të përjetshëm.”

Ky pasazh nga Kontrata Sociale e Rousseau-së, fjalia e fundit, sidomos, mund të lidhet drejtpërdrejt me situatën te ne, në aspektin e qeverisjes autoritare, mungesës së ushtrimit të së drejtës prej qytetarëve në mënyrë të njëmendtë dhe prirjes së një pjese dërrmuese për të pranuar pabarazinë si një gjendje të natyrshme.

Rousseau kritikon idenë se disa njerëz lindin për të sunduar dhe të tjerët për të qenë të nënshtruar, duke argumentuar se skllavëria është një produkt i forcës dhe më pas i nënshtrimit të vazhdueshëm. A nuk mund ta shohim këtë ashiqare në mënyrën se si një elitë e privilegjuar ruan sot pushtetin jo përmes një kontrate të drejtë shoqërore, por përmes kontrollit mbi institucionet dhe dobësimit të reagimit qytetar që e mban aktiv me kërcënimin e vendit të punës, pra të bukës së gojës apo të lënies në harresë totale të atyre për të cilët ka përgjegjësi?

Duket se e kemi pranuar në mënyrë pasive këtë pabarazi, duke u përshtatur me një sistem ku korrupsioni, klientelizmi dhe mungesa e meritokracisë janë bërë normë. Ashtu siç thotë Rousseau për skllavërit që «humbasin gjithçka në prangat e tyre, madje edhe dëshirën për t’u çliruar», skllavërit e kohëve moderne ndonjëherë qëndrojnë lidhur pa pranga, kaq shumë është përhapur mentaliteti i nënshtrimit ku kryetari dogëndis me lloj-lloj epitetesh dhe përballë tij sheh fytyra të ngazëllyera që duket se kanë humbur çdo dinjitet në rrotullimin reverent rreth “Diellit” të tyre, si lodrat kineze me kurdisje. Duket që fundi është cekur kur sheh këtë dorëheqje dhe mosbesim te mundësia për ndryshim. Megjithatë, Rousseau sugjeron se një popull ka të drejtën të rrëzojë zgjedhën e padrejtë sapo të ketë fuqinë ta bëjë këtë.

Në Shqipëri, ndryshimi i vërtetë mund të vijë vetëm nëse qytetarët rivendosin një kontratë të re shoqërore, duke kërkuar qeverisje të drejtë, llogaridhënie dhe pjesëmarrje të barabartë në jetën politike. I dimë këto dhe të tjera si këto. Edhe njerëzit jo se kanë hequr vërtetë dorë, në thelb. Por, “ATA” – oferta politike nuk kanë gjetur si



JEAN-JACQUES ROUSSEAU DU CONTRAT SOCIAL

të bëhen të besueshëm se të gjithëve na rrëqethet mishi kur mendojmë se një tjetër i ri, po aq i flaktë e i angazhuar sa Veliaj mund ta zëvendësojë dhe të shtojë racën e përbindëshave me fytyrë dhe zë të butë, por akoma dhe më të vjetëruar, mizorë e të kalbur se bijtë e etërve që na qeverisën këto 35 vjet.

Po si bëhesh i besueshëm? Kjo ha ca punë. Vështirë se bëhesh sot me nesër. Kjo do ca qëndrueshmëri, ca pavarësi nga nomenklaturat, ca mend që i kanë dhënë ata para nesh e që i ke lëçitur e rrahur me veten, ca shpirt që nuk blihet, ca vlera që nuk shiten dhe të mbash rreth vetes ca të tjerë që e mendojnë si ty. Ca pak si këto

dhe nuk po flas ende për idealizëm, por për përgjegjshmëri, fjalë që ne edhe pak e do e heqim nga fjalori aq e padobishme e pavlefshme është shndërruar ajo në psikenë tonë kolektive.

I besueshëm je edhe kur bashkë me veten ti lufton të ngresh moralisht dhe intelektualisht gjithë ata që ke rreth e rrotull dhe kur sheh më larg se hunda jote. Të gjitha këto njerëzit i kuptojnë në i ke apo jo, pavarësisht se çfarë thua dhe dallimi është fryma.

Po më kujtohet tani “Frymë të vdekura” të Gogol ku Çiçikovi, një mashtgues që udhëton nëpër provincat ruse blen “shpirta të vdekur”, fshatarë, skllavër që

figurojnë ende në regjistrat shtetërorë si të gjallë, edhe pse në realitet kanë vdekur, si garanci për të marrë kredi dhe për t’u pasuruar. Shembull si burokracia dhe korrupsioni të rrënjosura thellë lejojnë individë të paskrupullt të përfitojnë nga zbrazëtitrat e sistemit. Sistemi ynë është i zbrazët vërtet, por Rousseau thotë “ Më i forti nuk është kurrë mjaftueshëm i fortë për të sunduar gjithmonë, nëse nuk e shndërron forcën e tij në të drejtë dhe bindjen në detyrë”. E drejta dhe detyra janë të vetmet transaksione për pushtet, por kujdes nga Çiçikovët, këta falsifikatorë të kualifikuar diskursesh.

Ornela Radovicka, studiuese

ARBËRESHËT MBIJETUAN FALË PUNËS SË TYRE

Nënat arbëreshe mundohen të mbajnë gjallë botën arbëreshe nëpërmjet kostumit te grave arbëreshe. Kostumi është një kod më vete. Çdo fshat mban kostumin e tij karakteristik, i cili ka evoluar sipas kontestit historik

Zyrafete SHALA

Ornela Radovicka është një studiuese, pedagoge dhe aktiviste e shquar në fushën e gjuhës dhe kulturës arbëreshe. E lindur në Shqipëri dhe e emigruar në Itali në vitin 1991, ajo ka ndjekur një karrierë të spikatur akademike dhe profesionale, duke u diplomuar në Gjuhë dhe Letërsi, si dhe duke përfunduar studimet e doktoraturës në Pedagogji në Milano. Me një përkushtim të jashtëzakonshëm për ruajtjen dhe promovimin e gjuhës arbëreshe, ajo ka drejtuar Qendrën Albanologjike mbi Gjuhën dhe Kulturën Arbëreshe dhe ka qenë bashkëthemeluese e kurseve të mësimi të arbërishtes në Kalabri. Kontributi i saj përfshin një sërë botimesh, si libra studimorë, artistikë dhe artikuj në revista dhe gazeta prestigjioze shqiptare dhe ndërkombëtare.

HEJZA: *Si nisi angazhimi juaj në ruajtjen dhe promovimin e gjuhës dhe kulturës arbëreshe? Cili ishte momenti kyç që ju motivoi më shumë?*

O. RADOVICKA: Ishte korrik i viti 1990 kur e njoha për herë të parë At Bellushin. Nuk ishte një njohje fizike me të, por virtuale. Televizioni shqiptar në atë vite jepte një regjistrim nga një transmetim të televizionit të Kosovës ku fliste për Arbëreshët e Italisë, të cilëve iu jepej mundësia për të marrë pjesë në seminarin e gjuhës shqipe, që organizohet pothuajse çdo vit, që prej 1974, në Prishtinë. I ftuar atë ditë në emisionin e mëngjesit ishte At Bellushi. U mrekullova jo vetëm nga ajo bisedë e tij mbi kërkimet etnologjike në Helladë (pranë arbërorëve të Greqisë), por më bëri shumë përshtypje ajo gjuhë arbërore me të cilën ai shprehej. Më erdhi një mendim flesh në ato momente që t'i shkruaja, por nuk arrita të merrja adresën që ishte vendosur si nëntitull për të prezantuar mysafirin e radhës. Syri më kishte mbërthyer vetëm disa fjalë: "Studiues, prift arbëreshë, Kozencë". Më mjaftoi kjo adresë e çalë për të nisur një letër. Nisa t'i shkruaj. Ngjyreja penën në realitetin tim dhe rrëfeja për çdo gjë që perceptoja; mjerimin, varfërinë dhe depresionin kolektiv të këtij populli të vuajtur, e në veçanti profilin e "gjeneratës sime", ku në shpirtrat tanë aq pasiv, ishin ankoruar stalagmitet e hijes"rikë". Ajo frikë ku për gjysmë shekulli dallgët na kishin shtyrë në gadishullin e klauzurës fatale, dhe tani mbi boshtin "molin-kaus" kërkonim të montonim "bulonat - shpresë". Qëndronim si "pulëbardhat" mbi dallgë në det të hapur, ku askush nuk e di ku e kanë shtëpinë. Kur mbarova së shkruari, vura re që brenda në të ishin edhe njollat e lotëve të mi. E dërgova letrën ashtu siç ishte me ato njolla, sikur të ishte një tufë me tulipan me petale kripëza nga shpirti im. Kështu filloi korrespondenca ime me z. Bellushi. Ishte 12 shtator 1990. Të nesërmen në mëngjes e nisa me



postë. Nuk mund ta imagjinoni se sa u lumturova kur pas një muaji më erdhi një zarf nga At Bellushi, i cili më shkruante se revistën "Lidhja" si dhe dy kartolinat me kostumin arbëresh, ishin dhuratë prej tij. Ajo që më çuditi më shumë ishte se Ai më ftoi menjëherë që unë të shkruaja dhe të bashkëpunoja për revistën e tij, "Lidhja". Nga ajo ditë, për 35 vjet, e deri më sot iu përkushtova kërkimeve, hulumtimeve të botës arbërore, kurse këtë punë ia dedikova At Bellushit.

HEJZA: *Si ka evoluar gjuha arbëreshe ndër vite dhe cilat janë sfidat kryesore që e kërcënojnë sot?*

O. RADOVICKA: UNESCO e ka deklaruar arbërishten e arbëreshëve të Italisë si një gjuhë në rrezik zhdukje. Mjafton kjo deklaratë për të kuptuar se

si ka evoluar kjo gjuhë 600 vjeçare në tre – katër dekadat e fundit. Ligji 482\99 në Itali i jep popullsisë arbëreshe, e cila shtrihet vetëm në gjashtë krahina historike ku janë ngulimet arbëreshe si: Abruco, Molise, Puglia, Kapania, Basilikata, Kalabria, Sicilia, mundësinë fakultative të studimit të gjuhës arbëreshe, gjë që do të thotë që mësimi i arbërishtes nuk është pjesë e detyrueshme e kurikulave shkollore. Një faktor tjetër i asimilimit të tyre është edhe shpopullimi në ngulimet e tyre. Veriu i Italisë, që mbështetet në kapitalizmin industrial po i thithë nga dita në ditë si trurin ashtu edhe krahun e qytezave me ngulime arbëreshe.

HEJZA: *Keni bashkëpunuar ngushtë me figura të rëndësishme, ndër të cilët edhe me At Antonio Bellushin. Çfarë keni mësuar prej tyre dhe si kanë*

ndikuar këto marrëdhënie në punën tuaj?

O. RADOVICKA: Kam pasur fatin të punoj me njërin nga personalitetet më në zë të botës arbëreshe, Prof. At Antonio Bellushi, i quajtur nga Aristidh Kola Marotonomaku arbëror i kohëve moderne. Nuk la kontinent ku ka shqiptar pa vizituar. Punoi dhe hulumtoi për 40 vjet rresht botën arbërore - arvanitasit (që ai i thërriste arbëror) në Greqi. Ishte autor i 24 veprave. Themelues i dy revistave "Vatra jonë" dhe "Lidhja", si dhe hapi me dhjetëra e dhjetëra kurse si në gjuhën arbëreshe për arbëreshët, ashtu edhe për gjuhën shqipe pranë Qendrës së tij. Por, ai dallohet edhe për Bibliotekën e tij internacionale, themeluar në vitin 1964, e cila ka mbi 10 mijë ekzemplarë revista, shtypi, libra e dokumente që prej shekullit XVI. Ishte njeriu me të cilën punova për 35 vjet. Në kohën e lirë transformohej në tjetër njeri. Kishte natyrën që rrëfente. Mjaftonte pak dhe me kujtesën e tij formidabile të rrëmbente në botën e tij. Kishte një respekt të veçantë për ata njerëz të punës dhe për ata akademikë që punojnë në bazë, që mbledhin fakte në terren dhe pasurojnë atë epope te pashtershme, gurrën popullore të përvetshme arbërore. Kur rrëfente kujtimet e tij, shpesh i thahej goja. Pinte vazhdimisht një gllënjë ujë, aq sa të njomte kordat, dhe vazhonte. Ishte interesante entuziazmi që ai vendosi në çdo gjë që bënte, por nuk i harroj ato pauza kur si një tenor niste dhe këndonte ndërsa punonim. Zëri i tij, me një ton energjik, i ngjante një lahutari, apo një rapsodi të malësive tona, ku melodía rrjedh lehtë e zbret furishëm, si një ujëvarë. Ishte kënaqësi ta dëgjoje atë zë. Figura e tij e plotë, flokët e tij të thinjura, lëvizja e dorës, ndërsa dirigjonte këtë harmoni të ngadalshme të këngëve arvanitase. Tingujt, fjalët, ajo hare e atmosferë krijonte një energji që të përcillnin në një jehonë të stërlashtë, ku shumë piktorë të mëdhenj i kanë pikturuar në një atmosferë bukolike. Arbërishtja e tij me atë intonacionin jugor, të çonte në Olimp, ku ngjyhej me gegërishten dhe krijohej ai Zë, ajo iso, frymë e tingujve pellazge, që mblidhen në kërthizën e Dodonës Epirote. Nuk kam ndeshur kurrë një njeri kaq komunikues, i thjeshtë, të linte liri veprimi, kishte sensin e të dëgjuarit, dhe kurrë nuk ndjeva të më këshillonte, por sillej në mënyrë të tillë që të impononte respekt, por edhe të ishte si një shok i mirë që shkëmben ide. Biblioteka Antonio Bellushi ka pasur rastin të jetë e vizituar nga figurat më të mëdha të botës shqiptare dhe arbërore. E vizituan shumë njerëz të politikës Dardane dhe asaj shqiptare. Për rëndësinë e saj dhe punën që kemi bërë është vizituar nga shumë studiues, miq e vëllezër të At Bellushit, si prof Jup Kastrati, Dritëro Agolli, Ismail Kadare, Nasho Jorgaqi, Neritan Ceka, Ali Podrimja etje. U vizitua edhe nga bota arbërore e Greqisë, si Kosta Biris, Aristidh Kola. Na

erdhi, na gjeti edhe zonja Nermin Vlora Falaschi, u vizituan nga President i Republikës së Shqipërisë, po ashtu edhe nga Presidentja e Republikës së Kosovës, Zojna Vjosa Osmani, e cila i la shumë mbresa të mira At Bellushit. Dua të ndalem te një albanolog që e ruaj në kujtesë.

Të gjithë vizitorët lënë gjithmonë diçka pozitive me energjinë e tyre. Do të përmend një të huaj, albanolog, Robert Elsie. Të gjithë më kanë lënë diçka kur i kam takuar, por ajo që më ka ngelur në mendje, është takimi me albanologun Elsie. Ishte viti 2003. Në bibliotekën tonë erdhi Robret Elsie, albanologu me origjinë nga Kanada. Ishte albanologu më i drejtpërdrejt që unë kam njohur. Ai më pyet se me çfarë isha duke u marrë. I tregova se isha bashkëpunëtore e revistës “Lidhja”, se ndihmoja në hulumtimet mbi botën arbëreshe. Albanologu Elsie më vështroi ndër sy dhe më tha: Përse nuk shkruani për këta arbëresh të sotëm, sepse vitet ikin dhe do të humbasin edhe këta që kení. Shkruani arbërishte dhe shqip, sepse historia gojore ka të njëjtat vlera si historia e kronikave, personalisht mendoj se ka edhe më tepër vlera se ajo e regjistruara. Kronikën e shkruajnë gjithmonë ata që e fitojnë luftën dhe asnjëherë nuk i përmbahen me vërtetësi të vërtetës. Kur Robert Elsie u largua, At Bellushi i thashë: Profesor, përse mos të shkruajmë një libër mbi të gjitha ngulimet arbëreshe. Nuk ekziston një libër i tillë deri më sot? Në ato vite kishim filluar të vizitonim fshatrat arbëreshe një për një që të gjitha. Nuk ishte e lehtë, sepse janë në distancë dhe me një pozitë gjeografike të thyer, sidomos ngulimet arbëreshe në Kalabri. Për çdo vizitë që bëja, fillova të mbaja një ditar. Njerëzit që takoja, fjalët që përdornin, vjershat, ninullat që na rrëfenin. Të gjitha i mblodhëm dhe i hodhëm në një dokument, që më vonë ia dorëzuam Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve në Tiranë, me drejtuese Diana Kastrati, të cilët e realizuan si libër. Ishte i vetmi libër ku mblidheshin të gjitha fshatrat në NJË. Deri në atë kohë askush nuk kishte menduar që të kodifikoheshin të gjitha fshatrat në një libër të vetëm, dhe askush nga institucionet nuk kishte botuar qoftë edhe një vepër të At Bellushit.

HEJZA: *Në përvojën tuaj si drejtoreshë e Qendrës Albanologjike, çfarë do të veçonit nga arritjet që shënuat apo edhe vështirësitë me të cilët u përballët?*

O. RADOVICKA: Mendoj se nuk kemi arritur asgjë, vetëm kemi lëvizur, por duhet të keni parasysh edhe atë shprehjen që me një dallëndyshe nuk vjen pranvera, sepse nëse bota arbëreshe do të kishte arritje të mëdha, nuk do të kishim përfunduar në këtë gjendje, ku arbërishtja është deklaruar nga UNESCO si një gjuhë në rrezik zhdukje. Vështirësitë qëndrojnë se arbëreshët nuk kanë ende një gjuhë të përbashkët, dhe këtë e hasim kur krijojmë kurse për gjuhën arbëreshe. Bota arbëreshe nuk ka arritur ende të krijojë një bosht nacional, bazuar në të folmet lokale që është e rëndësishme mos të asimilohet, sepse ruhet gjuha e folur. Nuk është arritur në përfundime që arbërishtja që qarkullon sot duhet të pastrohet nga krahinorizmat dhe italianizmat, edhe pse arbërishtja rezulton e shkruar në shekujt e mëparshëm. Nuk kemi ende një abetare të përbashkët, përveç dy volumeve Alfabetizzazione e ndonjë tekst tjetër që qarkullon. Nuk kemi një fjalor të përgjithshëm, një fonetikë, një morfologji, një sintaksë, e kështu me radhë. Atë që mban gjallë botën

arbëreshe është arbëreshi vet. Të tjerët vetëm e shfrytëzuan dhe bënë karrierë. Bota arbëreshe në gjirin e saj ka atë pjesë që e do Arbërinë, ndeshet çdo ditë



me problemin e asimilimit dhe nëse këta arbëreshë ende mbijetojnë edhe pas gjashtëqind vjetësh, kjo është falë vetë punës së arbëreshëve, qofshin ata studiues, mësues, aktivistë, koreografë, artistë, aktorë, arkitektë, historianë, poetë, gazetarë, të cilët punojnë si në formë të pavarur, ashtu edhe nën ndikimin e shoqatave si ato në Kalabri Uniarb dhe FAA (me presidentët e tyre, prof. Italo Elmo e Damiano Gualiardí ku përqendrohen një numër i madh shoqatash). Por, ka edhe një numër të

Silvia Licursi, Emanuele Rosanova, Michele Greco, Castantino Belluscio, Flavia D-Agostino, Francesco Marchiano, Adelina Ajello, Zef Skiro di



Maggio, Gennaro de Cicco, Francesco Perri, Atanazio Pizzi, Fernanda Pugliese, Dimetro Emanuele, Vincenzo Bruni, i madhi prof Agostino Giordano e shumë të tjerë.

Nga përvoja ime mund të them se Qendra jonë albanologjike, ka gene gjithmonë e hapur në ndihmë të studentëve, për përgatitjen e diplomave universitare mbi tematikën për botën arbëreshe, po ashtu edhe për studiuesit dhe hulumtuesit. At Bellushi ishte shtylla e kësaj Qendre që themeloi



madh aktivistësh të botës arbëreshe, si Carmine Stamile, Cettina Mazzei, Anna Stratigo, Maria Antonieta Rimoli, Benedetto Guaragna, Lucia Martino, Giusi Skiro, Klaudja Cardaonna, Caterina Adducci, mësuese Sara në Sicili, Mario Masari, Mario Bellizzi, Tomasina Guerino, Calegero Raviota,

vet. Deri në momentin e fundit të jetës, punoi me nxënës dhe studentë. Dy studentët e fundit të tij qenë: Francesco Frega Ungra, student i jurisprudencës që i interesonte tema e Kanunit të Lekë Dukagjinit, si dhe Emanuele Rosanova, një student i cili mësoi arbërisht për 6 muaj dhe At Bellushi e caktoi si

sekretar të Bibliotekës. Kemi bërë edhe shumë takime për sensibilizimin dhe shpërndarjen e gjuhës dhe kulturës së botës arbëreshe.

HEJZA: *Cili është roli i diasporës shqiptare në mbështetjen dhe ruajtjen e identitetit arbëresh? A ka projekte konkrete që e lidhin më shumë komunitetin arbëresh me Shqipërinë dhe Kosovën?*

O. RADOVICKA: Qendra Albanologjike mbi Gjuhën dhe Kulturën Arbëreshe, themeluar nga prof Antonio Bellushi, në bashkëpunim me Lidhjen e krijuesve dhe poetëve në mërgim, me kryetar të saj, zotin Musa Jupolli dhe sekretar Mentor Thaqi, të udhëhequr nga një mik e vëlla i arbëreshëve (por do të thosha apostulli i arbëreshëve siç e ka pagëzuar i madhi At Bellushi) zotin Rexhep Rifatin, kemi krijuar një binjakëzim midis një klase me 21 nxënës arbëresh të drejtuar nga mësuese Maria Tolisano e Nicoletta Buono në qytezën arbëreshe të Ungrës, me një klase në Zvicër, me nxënës të mërgatës shqiptare nën drejtimin e profesor Vaxhid Sejdiu. Me këtë rast dua të falënderoj Lidhjen në mërgatë, por edhe drejtorin e përgjithshëm të shkollës, inxhinierin Gianfranco Maletta, presidentin e Bibliotekës internacionale, Tommaso Bellushi si edhe inxhinierin Tomaso Ferrari që na ka dhënë një ndihmë në realizimin e këtij projekti. Ky projekt është një projekt dy vjeçar për mësimin e gjuhës dhe të kulturës arbëreshe.

HEJZA: *Keni themeluar kurse për mësimin e gjuhës arbërisht-shqip. A po tregon rinia arbëreshe interes për ta mësuar këtë gjuhë? Si mund të forcohet më tej ky interes?*

O. RADOVICKA: Në vitin 1993, për shkak të fluksit të madh të refugjatëve shqiptarë, ku kishte edhe shumë fëmijë, At Bellushi hapi një pikë ku vinin fëmijët emigrantë shqiptarë. Kjo pikë shkollore zgjati deri në vitin 1998. Me daljen e ligjit italian në vitin 1999, ku përfshihet edhe mësimi i arbërishtes, ne menjëherë hapëm një klasë për fëmijë arbëreshë dhe shqiptarë në Frasnitë. Kjo zgjati nga viti 2000 deri në vitin 2005. Unë isha mësuese e gjuhës shqipe dhe At Bellushi për arbërisht. Këtë vit, siç iu thashë edhe më sipër, kemi hapur një klasë në shkollën shtetërore të Ungrës\ Kalabri, një projekt që aplikohet për herë të parë dhe është dyvjeçar. Ne jemi të kënaqur. Për sa i përket botës arbëreshe, sot shohim se ka një rizgjim, një rilindje mbi gjuhën dhe kulturën arbëreshe. Në gjithë Arbërinë janë hapur kurse për të rinj, por edhe për mosha të rritura.

HEJZA: *Sa e vështirë është për një fëmijë arbëresh të rritet me dy gjuhë primare në një botë gjithnjë e më të globalizuar? A ka modele suksesi që mund të ndjekin?*

O. RADOVICKA: Sot, fëmijët arbëresh janë të asimiluar. Ata nuk flasin arbërisht. Gjuha flitet nga mosha 40 vjeç e lart. Nga eksperienca ime, mund të them se arbëreshi është shumë i mprehte. Ata mësojnë dhe kapin menjëherë gjuhën arbërore. Kjo gjë më mahnit edhe te fëmijët e klasës që kemi hapur në Ungra. Nën at arbëreshe mundohen të mbajnë gjallë botën arbëreshe nëpërmjet kostumit te grave arbëreshe. Kostumi është një kod më vete. Çdo fshat mban kostumin e tij karakteristik, i cili ka evoluar sipas kontestit historik.

HEJZA: *Si mund të integrohet më mirë*

gjuha arbëreshe në sistemin arsimor në Itali? Cilat janë pengesat kryesore për këtë?

O. RADOVICKA: Sipas ligjit 482\99, që ua përmenda më sipër, ky ligj mbron gjuhën arbëreshe në gjashte krahinat historike të saj dhe nuk është pjesë e detyrueshme në kurikulat shkollore. Gjuha arbëreshe lejohet të mësohet në shkolla, por në formën e saj fakultative, që do të thotë, nëse do familja, prindi, i bëhet kërkesë drejtorit të shkollës, krijohet një klasë dhe mësohet një apo dy herë në jave, gjë e cila nuk e plotëson kërkesën e një populli 600 vjet në ato territore ku ende ruhet gjuha dhe kultura e një populli gjashtëqind vjeçar. Ndryshimi i këtij ligji është një faktor politik që iu takon qeverive në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut dhe Itali. Në vitin 2022 unë isha pjesë e një komiteti shkencor drejtuar nga ish drejtori i RAI Calabria të televizionit italian mbi gjuhën dhe kulturën arbëreshe dhe shkuam deri në Senatin italian për të sensibilizuar këtë ligj. Punët nuk bëhen lehtë, por pas shumë tentativash të bërë nga bota dhe politika arbëreshe, pas 8 muajsh Gazzeta Ufficiale, nr 121, iu dha mundësinë arbëreshëve të Kalabrisë përdorimin e gjuhës së tyre në gazetari, radiofoni e shumë programe të RAI në shtetin italian. Ky ligj është pengesë edhe për arbëreshët e emigruar në veri të Italisë, të cilët vijnë nga këto krahina, por nuk kanë të drejtë të aplikojnë këtë ligj në krahinat e tyre, sidomos në krahinën e Piemontes ku janë rreth 10 mijë arbëreshë.

HEJZA: *Keni shkruar disa libra dhe artikuj mbi kulturën arbëreshe. Cili prej tyre është më i rëndësishmi për ju dhe pse?*

O. RADOVICKA: Janë rreth 8 libra që kam shkruar mbi botën arbëreshe. Gjashtë janë publikuar, dy janë në dorëshkrim. Librat janë pak a shumë si fëmijët e tu, janë krijesat e tua dhe nuk zgjedh dot, janë të gjitha të rëndësishme. Librat hulumtues nuk i përkasin sferës motive, si një libër artistik, ku mund të shprehësh disi më tepër sentimentin, por në këtë grup libri që më tërheq sot për sot nga ana emotive është libri kushtuar At Bellushit. Jam ende e emocionuar shumë kur e lexoj, edhe pse është reduktuar shumë, por përfitoj nga rasti të falënderoj miqtë e At Bellushit të Shoqatës Pal Engjëlli që e publikuan këtë libër. Në ato faqe është jeta e gjallë e arbërorëve, janë sakrificat e shqiptarëve, janë përpjekjet e njerëzve për të mbajtur gjallë identitetin arbëror dhe sidomos përpjekjet dhe sakrificat e këtij njeriu gjigand që tërë jetën ia kushtoi Arbërisë. Por, nuk e mohoj se edhe libri “Rrugëtim në ngulimet arbëreshe”. Ky libër më pëlqen, sepse janë prekur 52 fshatrat arbëreshe. Kam parë pozitën e tyre gjeografike, përjetova vështirësitë ku rrinte e jetonte ky popull i rrallë, kam takuar shumë njerëz me At Bellushin gjatë atyre viteve, por kjo është një histori më vete. Në atë pak krijimtarinë time jam munduar të kodifikoj me singëritet intelektual punën time në terren. Kërkova të kodifikoja gjithçka që hasja mbi botën arbëreshe dhe të gjitha ato përpjekje e hulumtime i kam mbledhur në librat: “Rrugëtimi i një arbëreshi”, dedikuar At Antonio Bellushit, “Spezzano albanese\ Spixan dje dhe sot”, “Antroposofia arbëreshe në rrëfimet e Rinës”, “Rrugëtime në ngulimet arbëreshe”, bashkëpunëtoe me At Bellushi, redaktore dhe përkthyes e librit “Arbëreshët, fotosintezë e shpirtit tim” e autorit Rexhep Rifati dhe shumë artikuj në shtypin e huaj dhe shqiptar.



HEJZA: *Si e shihni të ardhmen e studimeve arbëreshe? A ka mjaftueshëm kërkime dhe interes akademik mbi këtë fushë?*

O. RADOVICKA: Akademikët kanë dhënë kontribut në fushë të letërsisë dhe historisë arbërore, por edhe në fushë të etnografisë. Këta akademikë kanë ecur edhe në karrierën e tyre, por nuk kanë bërë asgjë për gjuhën. Me siguri kanë pasur vështirësi edhe ata vetë, duke konsideruar faktin se, sidomos akademikët arbëreshë që mbulojnë katedrat në Kalabri dhe në Palermo, ku shtrihet bota arbëreshe, nuk vijnë nga universitetet ku të jenë diplomuar në gjuhën shqipe, kështu që me siguri kanë pasur vështirësi në menaxhimin e situatës për të bërë diçka mbi gjuhën. Duhet të studiosh gjuhën shqipe që të kuptosh mirë arbërishten. Edhe Akademia e këtyre tridhjetë vjetëve e Tiranës si edhe e Kosovës, janë në një indiferencë të madhe për të bërë diçka për gjuhën arbëreshe. Tendenca e tyre ka qenë që arbëreshët të mësojnë shqipen standarde, gjë e cila do të ishte edhe më e lehtë për akademikët arbëreshë, por kjo bie në kundërshtim me pjesën masive të arbëreshëve të cilët duan gjuhën e tyre.

HEJZA: *Cili ka qenë momenti më i vështirë në aktivizmin tuaj për kulturën arbëreshe? A keni ndjerë ndonjëherë mungesë mbështetjeje nga institucionet shqiptare?*

O. RADOVICKA: Dua të them që në fillim se Qendra e themeluar nga At Antonio Bellushi nuk ka pasur asnjëherë ndihmë shtetërore nga institucionet shqiptare. E vetmja ndihmë konkrete që na u dha ishte botimi i librit “Antroposofia arbëreshe në rrëfimet e Rina Bellushi”, me

mbështetjen e z. Vehbi Miftari, kreu i Komisionit të lartë pranë Vatikanit, ku jemi në pritje për numrin e kopjeve. Institucionet nga Shqipëria kurrë nuk kanë pyetur, e jo më të na ndihmojnë. Kemi ecur me forcat tona.

HEJZA: *Si e vlerësoni rolin e mediave shqiptare dhe italiane në pasqyrimin e kulturës arbëreshe? A bëhet mjaftueshëm për promovimin e saj?*

O. RADOVICKA: Gazzeta Ufficiale, nr 121, e cila iu dha mundësinë arbëreshëve të Kalabrisë përdorimin e gjuhës së tyre në gazetari, radiofoni e shumë programe të RAI në shtetin italian, ka bërë që të lëvizet. Ka një ringjallje, por ka edhe shumë vështirësi, sepse kemi ligjin, por nuk kemi një gjuhë të unifikuar. Në cilin standard arbërishte do të bëhet përkthimi, kur kemi vetëm 50 të folura lokale/idioma dhe nuk kemi një gjuhë standarde?

HEJZA: *A mendoni se gjuha arbëreshe mund të mbijetojë edhe për shekujt e ardhshëm? Çfarë duhet të bëjmë sot që ta ruajmë për nesër?*

O. RADOVICKA: Çështja arbëreshe është një fenomen i rrallë antropologjik, siç ka thënë i madhi Pasolini. Kam krijuar idenë se sa herë duket apo mendohet që arbëreshi po shuhet, ai fillon të lëvizë e të ringjallet. Ngjan me feniksin. Është një popull që përthyet, por nuk thyhet.

HEJZA: *Çfarë këshille do t’i jepnit të rinjve arbëreshë që duan të angazhohen në ruajtjen e identitetit të tyre kulturor?*

O. RADOVICKA: Mendoj se nuk jam unë ajo që duhet t’iu jap direktivat, por mund t’iu paraqes situatën e

sotme për mësimin e arbërishtes. Sot për sot për mësimin e gjuhës arbëreshe në Kalabri janë në qarkullim dy tekste “Alfabetizzazione” në dy volume, publikuar në vitin 2000, nga shefi i Katedrës mbi gjuhën dhe kulturën shqipe në Napoli, së bashku me një grup autorësh kompetent. Janë në qarkullim teksti “Arbërisht? Përse jo? Kurs i shkurtër në gjuhën shqipe (?) botuar në 2022-2023”, janë në qarkullim edhe dy tekste mbi alfabetizimin në Sicili për arbëreshët e Sicilisë Ligji 482\ 99, është një ligj sakat\ i gjymtuar, por në fund të fundit edhe pse gjysmak, mbron dhe duhet ta shfrytëzojmë në mënyrën më të mirë të mundshme derisa forcat politike dhe ato institucionale të arrijnë në një akord të vetëm midis tyre, për futjen e arbërishtes në kurikulat shkollore. Arbëreshët që kanë interes për ruajtjen e identitetit të tyre, nuk duhet të qëndrojnë duarkryq, se nuk ka kohë, por me patjetër të shfrytëzojmë këtë ligj, edhe pse në formë fakultative, kështu që të krijohen klasa dhe të frekuentojnë mësimin në arbërisht. Autonomia e shkollës ua jep këtë mundësi, ju vëllezër arbëresh nuk duhet të humbisni rastin, por duhet të regjistroni fëmijët tuaj në shkolla. Mendoj se vetëdija juaj arrin në atë pikë që të kuptoni rëndësinë antike që ka kjo gjuhë si gjuha më e lashtë ne Europë dhe të vazhdoni të mbani atë identitet si populli më i rrallë dhe më unik në rruzull.

HEJZA: *Në librin tuaj “I them botës jam arbëresh”, kushtuar Zef Cacozzas, keni dashur të përcillni një mesazh për identitetin arbëresh apo thjesht ta përjetësoni personalitetin e veçantë të Cacozzas?*

O. RADOVICKA: “I them botës jam arbëresh”, është një libër që e kam për zemër dhe nuk isha e përgatitur të shkruaja një libër për mikun Zef Cacozza, sepse ai iku papritur e pakujtuar. Ishim takuar në aktivitete të ndryshme. Zefi është personifikimi i arbëreshit të djeshëm dhe të sotëm. Ai është një simbol i kulturës dhe gjuhës arbëreshe. Ishte një figurë e thjeshtë, por kur fillova të shfletoj deri diku punën e tij, pash madhështinë e këtij njeriu sa të artit aq dhe të shpirtit. Zefi është ai arbëresh që mallin e një vendi të të parëve të tij që edhe pse nuk e pa, e skaliti në zemrën e tij dhe venat e tij. I dridhej buza për Arbërinë, dhe ishte i lumtur sa herë nisej për Shqipëri apo në Kosovë. Zefi të mallëngjen me zërin dhe vargjet e bukura, është zëri i gjithë atyre arbëreshëve që ruajnë në shpirt botën arbërore. Zefi kur recitonte, apo këndonte, tingujt që dilnin nga zëri i tij sa herë që mblidhej me shokët arbëreshë, ai zë i nënshtrohej një partiture shpirti të tij, ku lirikja dhe epikja ndërthuren, krijojnë shtëllunga të ngrohta në ajër, bartin flatra, të cilat të rrëmbejnë e të çojnë të toka e etërve të tyre në Koronë\ Peleponez, në gadishullin Ilirik, të cilët të dëbuar nga pushtimi otoman lanë tokat e tyre, mëmëdheun e tyre, por morën me vete gjuhën, ritin, besimin e çdo gjë të bukur që kishte shpirti i tyre dhe ja po e mbajnë më shumë mundime për 600 vjet.

“Jemi fara që lulzon edhe te guri! (Ne jemi fara që mbin edhe mbi gur!). Jemi ariu qe presim pranverën te zgjohet. Jemi nusja që mezi presim të martohemi. Jemi foshnja në bark që nuk e di pse ka lindur. Jemi njeriu i mundur që gjen forcën të dehet. Jemi bota e tretë që nuk vdes dot. Ne jemi era, vala e detit, lumi shqiptar”, jemi një kulturë që nëng mund të vdes - thoshte Pino! Kjo këngë është vërtetë një himn popullor e shpirtit arbëror.

Legjenda shqiptare

INTERPRETIMI MITOLOGJIK MBI YLBERIN



Kjo legjendë paraqet në vetvete jehonën e njërit nga mitet marginale kozmogonike të krijimit të botës nga martesë a tokës me qiellin

Agron TUFA

Brezi (në disa zona të Dibrës së Epërme dhe Lumës, quhet shoka), paraqet në vetvete një element të pandarë të kostumit nacional te një shumicë e popujve. Duke lënë mënjane anën estetike e etnografike, ne do t'i kushtojmë vëmendje vetëm traktimit mitologjik të përdorimit të tij të domosdoshëm në disa krahina të Shqipërisë së Veriut.

Në Dibrën Veriore dhe në Lumë, mund të dëgjosh një legjendë të tillë arkaike: “Njëherë ndrikulla shkoi mysafire te kumbara i vet. I ndodhur vetëpërvetëm me të në shtëpi, kumarës i ra në kokë ngasja tunduese e mishit, iu err arsyeja dhe u lëshua mbi ndrikullën që të shkrehte epshin. Ajo, nga ana e saj, duke e ndjerë tmerrin e këtij incesti, doli me vrap nga shtëpia, e ndjekur nga kumbara, kaptoi korije e përroska, gjersa më në fund kumbara e arriti maje një kodre, ku e çnjerëzoi. Gjatë kohës së mëkatimit, shokën e saj të zgjidhur ajo ia hodhi erës, duke thënë: “Në besën tande qiell!” Era e rrëmbeu duke e kthyer në ylber, si shenjë të përjetshme të këtij incesti”. Në këto krahina edhe sot e kësaj dite, kur shohin ylberin, thonë: brezi (shoka) i ndrikullës.

Duke mësuar t'i analizojmë raportet e ndërsjella ndërmjet dy mitologjemave – ylberit dhe shokës - ne do të veçojmë dy plane themelore në studimin e legjendës. I pari, “sipërfaqësor”, që cek motivin fundamental të incestit dhe i dyti, “vertikal”, i cili na shpie në arkaikën e hershme dhe që na lejon të merremi me kërkimet mito-filozofike dhe gjithashtu, me mitologji krahasuese. Sipas mendjes popullore shqiptare, mëkati ndrikull-kumar konsiderohet edhe më i rëndë se motër-vëlla. E mbërritur deri në ditët tona,

legjenda na përcjell një mesazh të natyrës didaktike. Subjekti i saj është i grishur t'i kurtojë receptuesit, para së gjithash, që “incesti është punë e keqe”.

Duke njohur tekstet e baladave të lashta shqiptare, arrijmë në përfundimin se incesti, për nga forca fatale, barabitet me gjëmat natyrore, p.sh., me përmbytjen e madhe. Në një shumicë të tillë tekstesh, mund të gjejmë elemente peripecish të tilla: forcat e natyrës pjesëmarrin në marrëdhëniet e heronjve dhe përpiqen në çdo mënyrë ta pengojnë incestin e pavetëdijshëm (kur motra dhe vëllai, pa ditur gjë për lidhjet e tyre të gjakut, vendosin të hyjnë në mëkat, atëherë lind një tufë zogjsh fatidikë, bie shi gjaku etj.). Në Eposin e Kreshnikëve të shqiptarëve të veriut, njërit prej heronjve qendrorë i ofrojnë të zgjedhë për nuse më të bukurën nga tridhjetë perritë e krahinës. Porse ai, i fyer, e hedh poshtë këtë propozim me një ligjëratë të tillë të pezmatuar: “Zoti ju vraftë, more agët e Jutbinës! Po ku â ndie n'mjet tokës e t'qiellës Se muer villau motrën e vet? Qi tanë bijat e Krahinës ku janë, Tanë si motra qi po m'duken!”

Lind pyetja: përse ndër shqiptarë, ndryshe nga një shumicë popujsh, përfshi dhe ata të gadishullit ballkanik, incesti mbetet një ndër tabutë kryesore? Këtu kemi të bëjmë, ndofta, së pari, me kultivimin e institucionit të kumarisë (probatinisë) në rang shenjtënie dhe së dyti, me kundrimin e martesës si akt simbolik i “pushtimit të nuses” përmes “fitores mbi babanë apo vëllanë e madh”. Në rastin e parë, ashiqare, ia vlen të kthehemi në kohërat e shthurjes së komunitetit primitiv, kur ndodh refuzimi i ngadaltë nga poligamia dhe, si alternativë e mundshme e martesës poligame lind “kumaria”, madje, dhe

ndërmjet mashkullit e femrës. Në rastin e dytë jemi të shtrënguar ta kundrojmë arketipin e dasmës si fakt jo vetëm jetësor, por edhe shpirtëror dhe mistik në jetën e njeriut.

Material të begatë e origjinal në këtë drejtim na jep folklori, jo vetëm në format e riteve dhe besëtytnive, por edhe në trajtën e eposeve e përrallave që kanë mbërritur gjer tek ne. Për ilustrim, vlen të përmendim studimin antologjik të Vladimir Propp-it, “Morfologjia e përrallës”, në të cilin rrëfëhet për variante të ndryshme të subjektit të përrallës. Për shembull, për të marrë princeshën për grua, heroi i përrallës është i detyruar të mundë Gjarpër Gorinicin, Koshcejen apo ndonjë tjetër përbindësh, domethënë, sipas Propit, të ashtuquajturin “dëmtar” që, si rregull, na del se është jo kush tjetër pos babait (apo një tjetër njeriu të afërt) të princeshës. Përralla, pa dyshim, shfaqet jo vetëm pasqyrim i arkaikes mentale të popullit, por edhe vetë sikur i imponon njeriut të lashtë ato apo të tjera etalone etike. Këtu vetvetiu të shkon mendja te konkluzioni frojdist e të gjeturit burrë për vete me funksionin e babait për gruan (apo nusen) si dhe për shkëmbimin e njërit me tjetrin. Këto shpjegime të tabusë incestuale na duken nga më bindëset, përderisa njeriu i vjetër zor të ketë marrë erë nga nga kodet gjenetike dhe ashiqare, pak e ka vrarë mendjen mbi faktin se nga flligështia e përhershme e gjakut, herët apo vonë, mund të lindin në familje monstra. Megjithatë, vetë mendimi se vëllai që martohet me motrën e vet ka për borxh (qoftë edhe në kuptimin simbolik, qoftë edhe në nivelin e pavetëdijes) të “triumfojë” mbi babain e tij, domethënë, ta zëvendësojë atë në gjithçka që ka të bëjë me vajzën, duke kryer në këtë mënyrë

atëvrasje simbolike, ky mendim duket e ka trembur njeriun dhe ka shkuar në të kundërt me normat e tij etiko-morale. Kësisoj, mbase pikërisht për këtë, martesë ndrikull-kumarë është konsideruar si mëkat edhe më i madh se sa martesë ndërmjet të afërmeve me lidhje gjaku.

I rikthehemi ylberit dhe shokës. Në zona të ndryshme të Shqipërisë së veriut, ylberi ka disa emërtime: “Brezi i Shën Mërisë së Virgjër”, “Brezi i Diellit”, “Brezi i Zoodiakut” (P. Bogdani), “Brezi i Perëndisë”, “Brezi i Havës”, “Brezi i Muhametit” etj. Pra, vlen të theksohet se ylberi shpesh merrej si njëfarë dërgese nga sipër, si një shenjë hyjnore. Në të tilla rrethana, legjendën për ylberin ia vlen ta kqyrim si subjekt të ngarkuar me didaktikë të vonë religjioze, ku femra iu kundërvu mëkatit seksual, ndonëse, e nënshtuar me përdhunë, konsiderohet tashmë si martire dhe në shenjë të pastërtisë dhe shenjtërisë së vuajtjeve të saj, në qiell shfaqet shenja hyjnore e dërguar nga lart. Nëse flasim për interpretim arkaik të kësaj legjende, duhet të kujtojmë atë çka më sipër përmendëm shkarazi. Dhe pikërisht atë që, incestin e pavetëdijshëm e pengonin vetë elementet e natyrës, duke i shpërqendruar pjesëmarrësit potencialë të incestit (por dhe duke i gjymtuar) me gjithëfarë stihish. Përveç gjëmave të ndryshme, numërohet edhe përmbytja e madhe, forca tragjike e së cilës barabitet me gjëmën e mëkatit, siç jo rastësisht, do ta shohim më poshtë. Siç dihet, në shumicën e popujve ekziston përfytyrimi i dasmës së përjetshme mes qiellit dhe tokës, madje, si rregull, toka paraqitet në rolin e femrës, kurse qielli në rolin e mashkullit (egjiptianët dhe disa popuj të tjerë kanë të kundërtën). Interesante është se dasma e qiellit me tokën ka zanafillë incestuale (toka së pari

HEJZA

lind qiellin - Gea pjell Uranin, kurse më pas e merr për burrë”, ndonëse në këtë stad zhvillimi të kozmogonisë, incesti nuk qortohet, por përkundrazi, merret si një gjë krejt e natyrshme dhe e domosdoshme (krahasojeni me subjektet e mëvonshme, kur lulëzon motivi i incestit, p.sh., me mitin e Edipit...). Mjeti më i drejtpërdrejtë i bashkimit të tokës me qiellin paraqitet shiu, vaditësi, mëkuesi dhe pllenuesi i barkut bujar të mëmë tokës. Rrjedhimisht, përmbytja vepron në llojin e vet si njëfarë katarsisi, që pastron dhe në të njëjtën kohë, ushqen tokën, simbolikisht mund ta quajmë veçse si një akt seksual të qiellit me tokën (se përmbytja s’është gjë tjetër veçse rrjedhojë rrebeshesh të bollshme). Sipas dëshmive të A. Afanasjevit (“Pikëpamjet poetike të sllavëve në natyrë”, V.1, fq. 362), “një legjendë bullgare pohon se para përmbytjes biblike, nuk ka patur ylber; po kur toka u tha dhe Noeja i solli Zotit fli, atëherë Perëndia i premtoi atij se përmbytje nuk do të ketë gjer në ardhjen e dytë të Krishtit dhe si dëshmi, na dhuroi ylberin e tha: “Pënderisa të shndrijë në qiej ylberi, nuk keni pse të frikësoheni, po kur ylberi të zhduket, kjo ka me qenë shenjë se dita e gjykimit të tmerrshëm po afron...”. Në përmbledhjet me dorëshkrime të vjetra apokrifike, thuhet: “Ylberin e krijoi Zoti pas përmbytjes”. (Përmbledhja Apokrifike e vitit 1531)... “Pas përmbytjes, Zoti vuri një hark në qiell si shenjë dalluese për përmbytjen e dytë që do të ndodhë”... Ky çast solemn lidhet me “dhjatën” që Zoti Jehova i dha Noesë. Ja se si interpretohet kjo “dhjatë” në enciklopedinë “Mitet e popujve të botës”: “Zoti fillon me ndëshkimin e tokës për shkak të mëkateve të njeriut me rrotullimin e rregullt të stinëve të vitit përpara: “Në të gjitha ditët e tokës, mbjellja dhe korrja, zhegu

e thëllimi, dimri dhe vera, dita dhe nata nuk do të ndalen” (8,22). Noeja qëndron para Jehovahit si stërgjysh i njerëzimit të ardhshëm dhe si Adam i ri që merr në fillim po të tilla bekime: “Shtohuni dhe shumohuni dhe mbushni tokën!” (9,11)” (22,24). Dhe kështu, para nesh na del njëfarë rrethi i premtuar dhe këtu vetvetiu mendja të shkon te analogjia e formës harkore të ylberit. Sidoqoftë, harku është veçse pjesa e dukshme e ylberit. A. Afanasjevi, në veprën e njohur “Pikëpamjet poetike të sllavëve në natyrë”, shkruan: “Forma gjysmërrethore e ylberit të çon ndërmend, dashje padashje një unazë gjigande që përqaf tokën. Në Bavari atë e quajnë himmelring, sonnenring..., madje disa besojnë që në asnjë më-nyrë ajo nuk duhet quajtur me emrin e vet, porse vetëm nëpërmjet eufemizmave “unaza qiellore”, që të mos biesh në pushtetin e djallit...” (1,358). Kështu pra, ç’do të thotë “unazë”? Unaza është shprehje e qarkullimit të natyrës dhe në të njëjtën kohë, unaza është paraqitja e stërlashtë simbolike e kohës. Kujtojmë se indianët dhe keltët e lashtë me “gjarprin që kafshon bishtin e tij” – se pikërisht me vizatime të tilla, si rregull, janë gdhendur sarkofagët dhe përmendoret e varreve të lashta. Meqë ra fjala, ekziston në një shumicë popujsh emërtimi “gjarpër i ylbhtë”. Në trajtën e një gjarpri të ylbhtë lidhen përfytyrimet për frymën e ujërave, gjarprin – monstër, kristalin magjik (në të cilin pasqyrohet spektri ylberor), i cili shfrytëzohet nga magjistricat; ylberi asocionon me shiun dhe magjinë e plleshmërisë”. (Mitologjia. Fjalori i madh enciklopedik nën redaktimin e E. M. Meletinskit, Moskë, 1998, f.462). Nëse ylberi është shprehje e qarkullimit në natyrë, atëherë, si dhe në rrjedhën

e kohës, në ylber ka një gjysmërreth të ndritshëm, mbitokësor, të qiellit, apo, nëse e doni, hyjnor, sikundër pjesa tjetër është e errët, nëntokësore, e vdekshme. Këtu është krejt me vend të kujtojmë për brezin (shokën) si për gjendjen e parë mitike të ylberit. Në shumicën e popujve, barku identifikohet me vetë jetën (te indianët e vjetër barku konsiderohet si rezervuar i energjive “Agni”: “Në letërsinë postindiane agni konsiderohet gjithashtu në aspektin fiziologjik si element i organizmit të gjallë-zjarri i “barkut” (“audaria)”. (Induizëm. Xhajnizëm. Sikhizëm: fjalor. Moskë, 1996): Ndër sllavët, vetë fjala “bark” ka pasur kuptimin zanafillor “jetë”, “ekzistencë”. Brezi (shoka) i lidhur përreth barkut mund të simbolizojë qarkullimin e kohës, të cilës, sipas dhjatës së Perëndisë, i është e nënshtrueshme gjithçka në natyrë. Madje, sipas gjitha gjasave, ajo pjesë e brezit që gjendet direkt përpara, domethënë që mbulon pjesën e përparme të barkut, përgjigjej për ditën, për natën, d.m.th., për ekzistencën mbitokësore të njeriut; kurse ajo pjesë e brezit që mbulonte shpinën dhe gjendej mbas shpine, mbartte në vetvete kuptimin e territ, natës, udhëtimeve nëntokësore të shpirtit (krahasojeni p.sh., me besimet e indigjenëve jugoamerikanë, për atë që vdekja e shoqëron njeriun gjithandej, duke shkelur pas thembrave të tij, d.m.th., duke u fshehur pas shpinës së tij), kësisoj, brezi shndërrohet nga një objekt veshjeje në një objekt tashmë magjik, në fetish, në talisman. Përkatësisht, këputja ose humbja e brezit (siç më sipër përmendëm, këputje e rrethqarkullimit të kohës dhe jetës në natyrë) ka domethënien e humbjes së mbrojtjes, koritjes apo dhe vdekjes. Një interpretim i tillë i legjendës shqiptare të cituar në fillim na duket mjaft

Nga këndi im

Ç’BEZDI RECENSIONET!

Nëse arti është ushtrim falas, është logjik pretendimi i atij që për shkak të zanatit është thirrur ta komentojë shumën e vogël bashkiake të trillit e të shkëlqimit

Zija VUKAJ

Një përkufizim të përshtatshëm për kritikun e ka bërë George Steiner: një lexues me laps në dorë. Lapsi është themelor, të ndihmon të zgjedhësh e të bën të guximshëm. Ai që beson se leximi është një ushtrim pasiv nuk ka lexuar vërtet asnjëherë. Shkrimtari bën gjysmën e punës dhe ta beson ty pjesën tjetër të veprës. Ai bën me shenjë, sugjeron, por po të imagjinion ty, po të jep shembull të mirë. Pa një kontribut tëndin një libër është inert. Kritiku është ai që bëhet i ngarkuar me një impenjim të tillë duke kapur një laps. Nëse arti është ushtrim falas, është logjik pretendimi i atij që për shkak të zanatit është thirrur ta komentojë shumën e vogël bashkiake të trillit e të shkëlqimit. Më vjen të them që ndërsa tregimtari apo poeti mund t’ia lejojnë vetes shmangiet e mërzitshme, hermetike, apo prej orakulli, një privilegj i tillë i është penguar kritikut. Atij i takon detyra e pakëndshme të mbajë me muhabet, natyrisht, jo të gjykojë e as të informojë. Mjerë kush e merr seriozisht, duke tjetërsuar rolin e vet. Kritiku i mirë nuk harron të jetë një parazit. Nëse arti shpreson objektivitetin, kritika është subjektive. Nëse arti ka shumë detyra, kritika përgjithësisht ka të drejta. Nuk dimë çfarë t’u bëjmë gjykimeve të kalibruara e objektive, as normave që nuk hyjnë në punë; pretendojmë gjak dhe intriga; duam entuziastët dhe urrejtësit, vaktësitë që bëjnë të na hapet goja. Normalisht recensionet janë kaq të mërzitshme sa mezi ç’pritet t’i mbarojnë edhe ata që e kanë lavdëruar librin tënd. Më të thjeshtat zbulojnë intrigën, lavdërojnë pjesë të romanit në dëm të të tjerave, zbulojnë ndikimet letrare (a thua se i interesojnë kujt). Recensionet e mira janë ato që kanë kurajën të flasin për diçka tjetër. Referuesi i shkëlqyer u jep rëndësi vogëlsirave dhe nuk pyet fare për ide



kryesore; kapardiset shijesh, nuk i fsheh tekat. Nganjëherë as nuk e merr mundimin ta përfundojë librin e analizuar (më të pacipët lexojnë vetëm skedën e botimit apo kthesën e mbështjellësës). Pastaj në akt i tillë pandershmërie hermenautike nuk është aq i urreyer. Një degustuesi nuk i kërkojmë të zbulojë gjithë shishen e verës. Oscar Wilde e quante “prova e lugës së kafes” (për të mos e ngatërruar me atë të gjellëbërësit). Është e vërtetë, janë pak ata që ia dalin të flasin me hir e shkathtësi për libra që nuk i kanë lexuar, por pikërisht për këtë bëjnë lavdërime dhe japin kurajë.

Fantazia e kritikut

“Të lexosh një roman- shkruan Virxhinia Woolf- është një zanat i vështirë dhe i ndërlikuar. Duhet jo vetëm një kapacitet i mprehtë intuitiv, por një fantazi e ndezur për të kapur plotësisht gjithë çfarë romancieri, nëse është një artist i madh,

i arsyeshëm. Duke kryer dhunë incestuale, kumbara e privoi motrën e tij (ndrikullën) edhe nga brezi magjik, duke kryer mëkat të dyfishtë ndaj saj. Megjithatë, nga pikëpamja e vetëdijes arkaike, incesti është po aq akt seksual legjitim, sa dhe çdo tjetër lloj i këtillë (material mbi këtë na japin përvojat e kulturave pagane, të ruajtura në një masë më të madhe ndër sllavë, në të ashtuquajturën “svalnie grjeha” (një lloj orgjie seksuale pa dallim marrëdhëniesh farefisnore A. T), e cila ndodhte në natën e Ivan Kupalës, në ekuinoksin e verës, 22 qershor, pas së cilës shfaqej ylberi si simbol i plleshmërisë dhe katarsisit mallëngjyes të natyrës.

Te po ai Afanasjev, lexojmë: “... një forcë magjike i jep Homeri brezit të Kipridës, endun fijesh ari: në të fshihej gjithë hijeshia, miklimi i dashurisë dhe dëshira e fshehtë që tundonte arsyen; duke përdorur këtë brez, Hera e joshi Zeusin...” (1,360). Disa thyerje të njëpasnjëshme na japin, megjithatë, shkas ta lidhim ylberin pikërisht me lidhjen martesore mitike dhe plleshmërinë. Përveç kësaj, në po atë libër të Afanasjevit, ka lidhje dhe legjenda e mrekullueshme lituaneze për Laumën (nimfën qiellore) dhe Zotin e naltë Perkunas (analog me Perunin sllav, rrufehedhës), çka me të vërtetë të çon ndërmend legjendën shqiptare për lindjen e ylberit. Siç duket, gjer te ne ka mbërritur një nga variantet më të vona të legjendës për ylberin, e ngarkuar me didaktikën e përditshme, ndërsa duke gjykuar nga përpjekja jonë e analizës mitologjike krahasuese, me tingëllimin e saj arkaik, kjo legjendë paraqet në vetvete jehonën e njerit nga mitet margjinale kozmogonike të krijimit të botës nga martesa e tokës me qiellin.

Bëv, Të zhyturit e të shpëtuarit e Levit sfidojnë kohën si një pikturë e altarit të Xhotos apo një sonatë e Bahut. Sa më universale të jetë një vepër arti, aq më pak i duron zinxhirët e gjinive. Por në këto rrethana, të mos i trazojmë ca gjeni të largët e t’u kthehemi trishtueshëm mjerimeve tona. Herë pas here më ndodh të marr prej botuesve bujarë e të specializuar ese mbi argumente që, për mendimin e tyre, mund të më interesojnë. Në rastet më të mira bëhet fjalë për monografi të pajisura me gjithçka të nevojshme: bibliografi të arsyetuaara, stil standard, tema të zhvilluara me saktësi. Ajo që mungon është një arsye për t’i lexuar. E në fakt askush nuk i lexon më. Dyshimi është se përkulja e marrë para disa dekadash nga disiplinat humane në mësimin e shencëzimit, karakterit të përgjithshëm, objektivizmit ka prodhuar këto produkte modeste dhe të pashërbyeshme. E vërteta është se kur lexoj një ese, përveç lëndë së trajtuar, më intereson eseisti. Kur lexoj Walter Pater që shkruan për Mikelanxhelon apo Xhakomo Benedetin që shkruan për Sabën (dhe më ndodh ta lexoj herë pas here), më intereson aq sa tema, edhe autori që e trajton. Personaliteti, stili, këndvështrimi: ja tipari dallues i kritikut të madh.

Kritika nuk është një akt i njëanshëm. Ajo kremton takime, në raste të rralla e fatlume deri edhe martesa fatlume. Motivi për të cilin vitet e fundit një eseist kompleks si W. G. Sebald ka gëzuar një konsideratë unanime, natyrisht ka të bëjë me personalitetin e tij: sedërmadh, i anktshëm, jashtëzakonisht origjinal. Kur një student i zoti më propozon një tezë mbi një autor të rëndësishëm, gjithmonë kam tentuar ta prapësoj. Por pastaj mendohem dhe them me vete: pse jo? Fundja, më mirë një fjalëmadh që bën orvatje të kota se sa një tjetër mediokër i patëmetë.

Ese

ETNOTEKSTI I SHKRIMTARES DISIDENTE



Disidenca e Musinesë natyrisht që kishte një premisë të fuqishme, të cilën ajo ndër qindra e mijëra të tjerë e vlerësoi dhe e shndërroi në pikë mbështetjeje. Vinte nga një përvojë, shkollim, dijesim dhe kulturim prej hapësirës europiane multikulturore

Aleksandër ÇIPA

Shkrimtarja Musine Kokalari mbetet disidentja e vetme shqiptare, e cila parandjeu dhe paratha se totalitarizmi i instaluar në Shqipëri ishte tirani. Në njëkohësi, diçka të tillë e kishte formuluar edhe Millovan Gjilasi, të cilin e citon Giovanni Sartori kur i nevojitet një formulim retorik dhe pohon se : “Totalitarizmi është tirani e lashtë në kushte të reja, apo fenomen i ri?”. Disidentja shqiptare i gjegjej në gjuhën e vet analitike. Sepse ajo disidencën politike e sendërttoi në përditshmërinë e përvujtshme të jetës së vet, qysh pa ardhur dita fizike e totalitarizmit shqiptar. Ajo e lexoi dhe paratha këtë mbërritje, duke u ngjizur me kohën edhe ferri i jetës vetjake. Ndodhte pikërisht në atë kohë, në të cilën, siç e thotë Viktor Hygoi: “Mund të kishte shumë gjuhë, por kishte pak mendje”. Në mendjen e paktë dhe guximin e madh u përfshi Musine Kokalari. Bëhet fjalë për aristokraten e mendjes, e cila e para lexoi plotësisht instruktivizmin politik që po instalohej në përballje me botëkuptimin dhe formimin e saj socialdemokrat. Qëndrestaria e Musine Kokalarit ishte dukuri e brendshme karakteriale dhe sjellje natyrale. Përkonte me shumëçka të vërtetshme që trashëgonte, por njëherazi edhe me atë investim formues e edukues që kishte ndjekur në jetën familjare dhe personale. Kjo qëndrueshmëri, në vjetët dhe sidomos kohën politike me të cilën u përball refuzueshëm dhe antagonisht, qysh në ditët e para, përkon me sentencën filozofike gjirokastrite, të cilën unë e huazoj nga profesor Muzafer Xhaxhiu: “As varri nuk ka frikë nga i vdekuri, as i vdekuri nga varri”. Dhe disidenca e Musine Kokalarit i kishte të dyja aspektet: atë të kontestimit të hapur dhe të paepshmërisë, e cila në gjithë jetën e vet mbetet reminishencë me atë të shkrimtarit sivëlla rus, Aleksandër Sollzhenicin.

Disidenca e Musinesë natyrisht që kishte një premisë të fuqishme, të cilën ajo ndër qindra e mijëra të tjerë e vlerësoi

dhe e shndërroi në pikë mbështetjeje. Vinte nga një përvojë, shkollim, dijesim dhe kulturim prej hapësirës europiane multikulturore. E kishte të natyrshëm formimin e vet filozofik të pluri-ideve dhe mbartte njëkohësisht ndërgjegjen e formuar nga shkolla e aq iluminuar e atëkohëshme. Ajo kishte për idhull të filozofisë dhe mbrohtësisë kombëtare Sami Frashërin. Jo më kot, ndodhte kjo, pasi përfshihej ndër ato intelektuale që lehtësisht depërtonte në thelbe dhe substancë të filozofisë. Në qëndrestarinë e vet disidente, Musineja ishte haveliane; nuk rreshtte së reflektuari dhe analizuari logjikisht rendin dhe sistemin e ri totalitar. Tekstet e zhdukura, të sekuestruara dhe djegura dhe sidomos memuarat e pakta të mbetura, formësojnë një substancë sui generis të dijes dhe reflektimit eseistik intelektual dhe prej shkrimtareje me klas. Kjo shkaktonte dridhje tek njohësit e saj sundonjës, apo siç preferonte t’i vetëquante, “Të ngjitur për t’u varur”, por që ishin tek pala tjetër, ajo e sundonjësve. Dija e saj “atje poshtë” i drithte ata “atje lart”. Ata e kishin kompleksin e dijes së saj, pasi e njihnin fort mirë se ç’brumi intelektual dhe çfarë kapaciteti shkrimor mbartte në vetvete shkrimtarja e privuar. Privimi, shkrimtares disidente, iu shndërrua në një masë radikale, absolute nga sistemi dhe sidomos shërbestarët fanatikë të monokulturizmit ideologjik. Kjo ndoshta ishte dhe arsyeja bazë që mes saj dhe të mbeturit “Aty lart” u instalua moskomunikimi dhe distancimi, harresa e shpërfillja vrastare, lënia në kthetrat e ferrit dhe mospërmendja e cila u shtri në tri dekada, përjashto atë moment fatlum të rikujtimit në një hapësirë tjetër, në rrethana dhe frymë tjetër, siç ishte Kosova.

E kam fjalën për vitin 1983, kur filologu, studiuesi ndër më të cilësishmit e thellësisë në kohë, të letërsisë shqipe, në numrin 2 të mars-prillit të atij viti, botonte në revistën “Jeta e re” katër tregimet e saj. “Mos qofshin vjehrrat e zeza”, “Kulloi odaja”, “Për mustaqet e Çelos”, “Ulurima e qenit” , të cilat i shoqëroi me një shënim

për këtë autore, e cila ishte e panjohur në Kosovë. Ishte pikërisht viti kur pasi e kishin sulmuar kurmin e saj gjithëfarë vuajtjesh e lëngatash, po e mësynte edhe e fundit më e papërballueshme, ajo e së keqes në Rrëshen. Mirëpo censurës së trashëguar të Musinesë iu shtua edhe ajo e këtij publikimi në Kosovë. Kurkush nuk e përmendi këtë fakt në Shqipërinë e asaj kohe. Por se çfarë e shtyu Doktor Rugovën, se kush e bëri me dije atë, se si u gjend në kontakt me letërsinë e Musinesë? Këto janë dilema të cilat ish Presidenti i Kosovës i mori me vete në amshim. Nëse do të kishim mundësi ta dinim dhe njihnim rrethanën, ndoshta do të kishim informacion për një perimetër më të gjerë kontaktesh dhe qarkullimi të letërsisë së Musinesë në atë kohë. Doktor Rugova sipas fondit arkivor që zotërojmë për shkrime jo vetëm memorialistike, por më së shumti studimore për shkrimtarinë e Musine Kokalarit, është i pari që i referohet pasurisë dhe vlerave etnotekstuale të Musinesë. Në shënimin shoqërues të botimit në Prishtinë, tek numri 2 i “Jetës së re”, Doktor Rugova shprehet: “ Është mirë të dihet se Kokalari i shkroi tregimet e saj në të folurit çam, pra, të krahinës së Çamërisë dhe njëherësh është njëra ndër shkrimtarët e rrallë shqiptarë që shkroi thjesht në këtë të folme, madje me qëllim artistik, sepse siç e dimë në historinë e letërsisë shqiptare shumë shkrimtarë tanë kanë shkruar në dialektin e tyre, meqë e ndienin si gjuhë të përgjithshme, e po të vepronte kështu, atëherë M. Kokalari do të shkruante në toskërishten letrare”. Më tej Doktor Rugova vazhdon: “ Për librin e saj, më 1940, në gazetën “Bota e re”, nr 1 të 30 korrikut, poeti ynë i njohur Lasgush Poradeci, bëri një kritikë mjaft interesante. Ja si e vlerëson Poradeci, esencialisht prozën e Kokalarit: “Krijim original. Zënia e jetës, kapja e menjëhershme e saj në fond dhe formë dhe faqja imediate pa asnjë ndërmjetësim, me anën e artit, kjo është origjinalitet-origjinalitet letrar. Kurse stilin e saj e quan stil substancial, që u përshtatet subjekteve”. Doktor Rugova zbulon në tekstin e vet dhe një njohës tjetër

të rëndësishëm të letërsisë së Musinesë, e ka fjalën për albanologun e famshëm Maximilian Lamberg i cili në vitin 1949, në librin “Albanaiches esebuxh”, Lajpcig, prej nga ka marrë edhe tregimet e botuara në Prishtinë.

Por, është me rëndësi të vijojmë citimin e Doktor Rugovës, i cili sugjeron se këto tregime, pra të Musinesë, “janë me interes edhe për gjuhëtarët tanë, madje edhe për elemente për gjuhësinë historike, sepse dialekti që përdor autorja përmban shumë trajta gjuhësore që i ndeshim në veprat e autorëve të njohur arbëresh, si te De Rada, Gavril Dara, Serembe, Santori e të tjerë, sepse shumë prej tyre ishin me origjinë nga këto vise dhe e kishin marrë gjuhën e atëhershme me vete...”.

Tekstet autoriale të Musine Kokalarit për t’u shqyrtuar drejt, sidomos në vlerat dhe pasurinë e tyre etnotekstuale, nevojitet të shqyrtohen duke i mbajtur në rrafshe krahasimtare dhe rivlerësuese edhe me shkrimtarë të tjerë bashkëkohës, matanë kohës dhe pas kohës së Musinesë. Pasuria leksikore e librave të Musine Kokalarit përkon dhe takohet me pasurinë që trashëgon letërsia jonë kombëtare qysh nga autorët e famshëm zanafillorë si Budi dhe Bardhi. Pjetër Budi në poezinë e vet thotë: “O i pafat njeri” dhe vijon “ndo plak jo a ndo i ri”, apo te “Ku janë ata djelm të ri”.... dhe natyrshëm rishfaqet proza e shkurtër e Musinesë me atë vlerë të papërsëdytshme të nëndialektit tosk të Gjirokastrës apo që përfshin edhe nga fondi leksikor i Çamërisë.

Studiues të ndryshëm të vënë në punën e tyre shqyrtuese mbi tekstet e Musine Kokalarit kanë evidentuar kujdesshëm këtë pasuri që la shkrimtarja e privuar deri në pengimin fatal. Prej letërsisë së saj rezulton një fjalor i leksemave, i cili përbën ndoshta pasurinë më atipike etnotekstuale të një autoreje e cila i përket origjinës së këtij qyteti, pra Gjirokastrës, por që dimensionet dhe valencën për cilësinë e vet shkrimore dhe gjuhësore i ka të krahasueshme me autorë të rëndësishëm të letërsisë europiane të shekullit XIX.

Ese

MONOGRAFI QË RINGJALL SHKRIMTARET SHQIPTARE

(Meliza Krasniqi “Shkrimtaret shqiptare 1954–1990”, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2024, 506 f.)

Gëzim ALIU

Kur e pyesin poetin e shquar amerikan, Mark Strand-in se a shqetësohet për harresën që mund ta mbulojë veprën e tij në të ardhmen, ai si me shaka përgjigjet se nuk do ta dijë, meqë do të jetë i vdekur. Pastaj shton se shumica e njerëzve që botojnë libra, do të lexohen për pak kohë e do të mënjanohen, pothuajse gjithsecili mënjanohet për të bërë hapësirë për të renë. Ai mendon se kjo është thjesht e drejtë, por sigurisht që do të donte të ishte i gjallë letrarisht edhe pasi të vdiste fizikisht. Strand shpreson që e reja, pasuesja, të përfshijë edhe poezinë, shkrimin dhe leximin e saj. Për popujt me traditë të gjatë letrare e shumësi poetësh e shkrimtarësh cilësorë, siç është për shembull letërsia angleze e amerikane, mënjanimi e harresa mund të jenë më pak të dhembshme, shumë më pak se për shoqëritë e kulturat, të cilave cilësia e artit të fjalës u kushtëzohet nga drama e kontekstit, siç i ka ndodhur përgjithësisht letërsisë shqipe.

Nëse drama e kontekstit ka qenë e rëndë për shkrimtarët shqiptarë, shumë më e rëndë ka qenë për gratë shqiptare që kanë synuar të shkollohen, të shkruajnë e të botojnë. Pesha e rëndë e dramës së kontekstit historik, social, kulturor, politik, ideologjik, ekonomik, ka shkaktuar varfëri të thellë te populli shqiptar, për pasojë e ka detyruar shqiptarin të mbyllet për shekuj me radhë në kullën e kodeve e sjelljeve etike fisnore, kanunore, edhe fetare, duke qëndruar në gjendje të vazhdueshme mbijetese e vetëmbrojtjeje, i izoluar, për pasojë i kurthuar në fanatizëm, konservatorizëm, patriarkalizëm. Këtë gjendje gruaja shqiptare e ka paguar tepër shtrenjtë, që jehon e ndikon si pasojë edhe sot e kësaj dite në shoqërinë tonë, sidomos nëse bëjmë krahasime me pozitën e gruas në Evropë.

Dua ta kujtoj këtu një shkrim të Shtjefën Gjeçovit, “Rnesa e kombit shqyptar ndër malcina”, i vitit 1908, dhe t’i citoj disa radhë për vajzat e gratë shqiptare, që të pikëllojnë: “... Cucës e grues shqyptare i gjendet puna: shpina e saj s’pushon e s’rri pa barrë në prendverë, në verë, në vjeshtë e në dimën. Ajo jeton në shpi jo si bijë, por ma zi se një rrogsh. Në mulli ajo do të shkojë, drutë që digjen në shpi rrokull vjetit, krahas me të tjerat gra ajo do t’i bjerë prej malit; ujët qi duhet për shpi, shpina e saj e bjen me bulierë ... prej kronit. Shkurt, prej kambësh të vogla e mje në pleqni ... s’i hiqet laku prej fytit e, në leftë cucë shqyptare, veç për lak len! Cucën e urdhnon gjithkush, ma i madhi e ma i vogli. Asaj i kërcnohet ma i miri e ma i keqi i shpisë, e kjo cing e ping me gojë s’mund të bajë. Gjithkush mundet me u la, me u kreh, me u veshë e me u ndrrue e me u spitullue, cuca jo; ajo do të rrinë si zhadravele e zhelane nëpër shpi e kudo...”.* Trajtimi i tillë i vajzave dhe grave shqiptare nuk bëhej vetëm në malësi, por fatkeqësisht, pak a shumë edhe në qytete. Kjo nuk do të thotë që djemtë e burrat shqiptarë e kishin punën mirë, por do të thotë që vajzat e gratë e kishin jetën shumëfish më të vështirë, në çdo aspekt. Duke e njohur mirë gjendjen e gruas shqiptare, në të kaluarën dhe në të tashmen, edhe në familje, edhe në jetë, edhe në kulturë, sidomos në letërsi, Meliza Krasniqi ia ka vënë vetes mision të hulumtojë, të gjejë dhe të analizojë e të vlerësojë të gjitha veprat letrare të shkruara e të botuara nga shkrimtaret shqiptare, jo vetëm në periudhën 1954-



1990, si dëshmi se gruaja shqiptare është gjysma e barabartë e natyrshme e shoqërisë, e familjes, e jetës, e kulturës, edhe e letërsisë shqipe, dhe nga ajo vajza e gruaja me lak në fyt, ka arritur përgjatë dekadave të shekullit të njëzetë ta shfaqë e ta krijojë identitetin e vet kulturor përkundër shumë pengesave. Ideja për t’u marrë me gratë shkrimtare të një periudhe kohore mjaft të gjatë, mund t’i nxjerrë fare mirë dy, ndoshta edhe tri monografi shkencore, por Meliza Krasniqi ka zgjedhur ta sfidojë numrin e konsiderueshëm të shkrimtareve dhe shumësinë e veprave të tyre: mbi gjashtëdhjetë shkrimtare dhe diku mbi dyqindetridhjetë vepra. Përgjatë javëve e muajve e viteve pasuese të idesë fillestare të paraqitur e të miratuar në Degën e Letërsisë, Meliza Krasniqi ka hulumtuar në biblioteka, kombëtare e lokale, librari, stenda librash, panaiire, kudo ku ka dëgjuar se mund të gjejë librat e shkrimtareve shqiptare, sepse një pjesë e madhe e veprave të shkruara e të botuara në atë kohë, nuk kanë bërë jetë të mëpastajme publike, nuk janë ribotuar, do të thotë janë harruar dhe ia ka filluar punës në analizimin, shqyrtimin, interpretimin, vlerësimin e tyre. Duhet vetëbesim i madh dhe kompetencë e lartë profesionale për t’u marrë me tërë ato libra, ashtu që rezultatet të përfshihen brenda kapakëve të një monografie, në

një afat kohor katër vjet e disa muaj, aq sa ishte kohëzgjatja e projektit të punës. Meliza e ka edhe vetëbesimin, edhe kompetencën profesionale dhe ia ka dalë që punën ta realizojë në nivel të shkëlqyer. Ia ka dalë që qëllimin e saj ta shndërrojë në një monografi të lexueshme edhe nga ekspertët, por edhe nga lexuesi i gjerë. Cila është mënyra e operimit të studiueses Krasniqi në këtë monografi për ta realizuar qëllimin e parashtruar? Monografia, pos Hyrjes dhe dy kapitujve teorikë e historikë-letrarë, ka katër pjesë të mëdha. Në pjesën e parë i analizon shkrimtaret shqiptare të Shqipërisë, në pjesën e dytë shkrimtaret shqiptare të Kosovës, në pjesën e tretë, shkrimtaret shqiptare të Maqedonisë së Veriut dhe në pjesën e fundit, shkrimtaret shqiptare të Italisë. Renditja e shkrimtareve bëhet sipas kriterit kronologjik. Vlerësimi shihet që bëhet përmes vëmendjes së kushtuar shkrimtareve të caktuara dhe veprave të tyre. Pra, shkrimtareve më të mira dhe veprave të tyre u jepet më shumë hapësirë. Monografia mbyllet me paraqitjen e rezultateve të hulumtimit, një bibliografi mjaft të vlefshme të shkrimtareve shqiptare, që nga libri i parë i botuar në vitin 1939 (nga Musine Kokalari “Siç më thotë nënua plakë”) e deri në vitin 1990, dhe me literaturën e gjerë të shfrytëzuar: libra teorikë, historikë-letrarë, shkrime, recensionë,

kritika, intervista të ndryshme.

Meliza përdor të kombinuara një varg teorish letrare për t’iu qasur teksteve, duke e pasur për bazë teorinë e studimeve gjinore nga rrjedhin edhe kritika gjinore (gjinokritika), edhe metoda e studimeve gjinore; e ka përdorur metodën sociologjike për t’i bërë biografitë e shkurtra të shkrimtareve dhe për ta ndërtuar kontekstin e jetës së tyre; metodën e analizës së tekstit për t’i shkokluar elementet përbërëse të veprave, deri në hollësitë më të imta stilistike e metrike e për t’i parë pastaj prapë si funksionojnë në tërësi; mund të thuhet se herë-herë e përdor edhe metodën psikologjike që nganjëherë merr edhe nuanca psikanalitike, për të arritur deri në thellësitë metaforike-figurative të poezive dhe mendjen e shpirtin e personazheve kryesore kryesisht vajza e gra të prozës, për t’i interpretuar pastaj si reflektim gjendjesh emocionale, shpirtërore e racionale të autoreve krijuese; e fut në punë metodën krahasimtare për të bërë krahasime mes veprave të një shkrimtareje të caktuar, si evoluim krijues-letrar ndër vite, mes veprave të shkrimtareve shqiptare në tërësi, por edhe për të bërë krahasime mes shkrimtareve shqiptare të Shqipërisë dhe atyre të Kosovës e të Maqedonisë së Veriut, sepse ndryshonin edhe kontekstet socio-politike e ideologjike, pra ndryshonin edhe mënyrat e krijimit letrar në secilin vend; përdor edhe mënyrat e analizimit të tekstit që rrjedhin nga teoria e narratologjisë, për të analizuar teknikat narrative të tregimeve, novelave dhe romaneve. Duhet thënë se në këtë monografi, studiuesja, Dr. Meliza Krasniqi, shqyrton edhe studimet letrare, kritikën e monografitë shkencore të shkruara e të botuara nga gratë në periudhën në fjalë, pra ajo, përveç analizës letrare të veprave artistike (poezi, prozë, dramë), shkruan edhe metakritikë. Duke u nisur nga biografia e duke depërtuar deri në thelbin e letraritetit të veprave të shkrimtareve shqiptare, kjo monografi merr vlera edhe të një teksti historik për shkrimin letrar femëror. Merr vlera të tilla sepse qëllimi i studiueses Krasniqi nuk ishte vetëm analizimi, shqyrtimi, interpretimi e vlerësimi i veprave të shkrimtareve shqiptare, por edhe krijimi i vendit të tyre të merituar në historinë e letërsisë shqipe, do të thotë ringjallja e tyre. Nxjerrja e tyre në pah dhe mbrojtja nga harresa. Kjo monografi është prijatë në këtë drejtim.

Meliza Krasniqi ka bërë punë të madhe, të jashtëzakonshme dhe mendoj se kjo monografi do të jetë referencë e domosdoshme për këdo që në të ardhmen merret me shkrimtaret shqiptare, për këdo që synon ta luftojë harresën në kulturën tonë, sidomos harresën ndaj nënave tona që na e kanë mësuar shkrimin-leximin, ndaj shkrimtareve tona, që na kanë treguar përmes krijimtarisë së tyre letrare e intelektuale se gruaja shqiptare nuk është thjesht objekt frymëzimi për poetët e shkrimtarët, por subjekt veprues në jetë, në punë, në shoqëri, në letërsi e në kulturë.

* Shtjefën K. Gjeçovi, “Rnesa e kombit shqyptar ndër malcina”, në: “Kanuni i Lekë Dukagjinit” (Mbledhur dhe kodifikuar nga Shtjefën K. Gjeçovi), Akademia e Shkencave e RPSSH. Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 1989, f. 491-492.


Botime të reja

VEPËR E RRALLË DHE E MUNGUAR

(Fitim A. NuhIU, CARPE DIEM, përkthime letrare, fq. 440, botoi Lena Graphics, Prishtinë, 2025)

Shkodran H. ISMAILI

Shkrimtari dhe përkthyesi Fitim NuhIU, një emër i ri në ngritje e sipër dhe me një talent letrar goxha zhbirues e universal emancipues, ka sjellë në shqip një vepër sa interesante aq dhe të rrallë. Bëhet fjalë për veprën me përkthime letrare, e titulluar CARPE DIEM. Është kjo një vepër me punime të përkthyer si përmbledhje e punës së tij të palodhur të viteve të fundit, nga shumë shkrimtarë, poetë, artistë, aktorë teatri dhe letrarë nga Lindja e Perëndimi, Veriu e Jugu, të atyre që shkruajnë në anglisht, si gjuhë amtare apo dhe si gjuhë të dytë të punës intelektuale. Meqë dhe vetë përkthyesi është profesor i gjuhës angleze, ai gjithnjë e më shumë po na sjell freski dhe rikthesë emancipuese në letrën/at shqipe, duke u munduar të sjellë e të flas in shqip e të komunikon imagjinata letrare e botës me publikun tonë ashtu siç është më së miri. Me një gjuhë të rrjedhshme, strukturë fjalëformimi dhe narrativë po ashtu të shkëlqyeshme, paragrafë që konceptojnë dhe përmbledhin brenda logjikën përmbajtësore të lëndës që trajtohet, libri ka një vlerë të shtuar dhe meriton që të jetë në mesin e letrarëve tanë, madje të përbrendësohet në kuadrin e sistemit tonë letrar e kulturor. Librit vlerën akoma ma shumë ia shtojnë temat apo tematologjia e larmishme e autorëve, poetëve, shkrimtarëve dhe artistëve nga anë e mbanë bota që sjellin me vete. Që të gjithë sjellin botën e imagjinatës së vetë letrare dhe botëkuptimit të tyre, se si ata e shohin aktualitetin e sotshëm dhe “socialitetin letrar” të njerëzimit. Filluar me shkrimin letrar, me këshilla për mjeshtërinë e shkrimit, për fiksionin letrar dhe narrativën e tij (Herman Diaz, Zemra e fiksionit – trillimit) si finalist i çmimit Pulitzer për letërsinë artistike dhe i përkthyer në më shumë se njëzetë gjuhë (yalereview), ai ka bindje se fiksioni është një shpikje, por jo e dëmshme, një lojë apo sekuencë e shkëputur nga jeta reale, që nuk duhet marrë doemos aq seriozisht. Për vlerën e poezisë (poetja greke Evangelia Liana Sakelliou), të bukurës, të së mirës, duke vazhduar me tema siç janë, emancipimi universal që di të sjell letërsia, freskia kozmopolite e disa autorëve, tema të tilla për gruan, femrën e vlerat e saj në shoqërinë e sotme, feminizmin (pa ose me ngjyime ideologjike), tematikën e rezistencës emancipuese të përditshmërisë kundër kolonizatorit (mjeku palestinezo-amerikan Fady Joudah), shkrimtarin e



madh palestinez në ekzil dhe të pa-atdhe Ibrahim Nasrallah, i cili me një theks të veçantë i shkruan dashurisë për atdheun e tij, e që artin dhe letërsinë e sheh si përgjegjës për riformësimin e identitetit të Palestinës pas Nakbes (katastrofës palestineze) etj. Këta shkrimtarë sjellin edhe tema të tilla si dashuria dhe fuqia e madhe ndikuese e pamasë dhe intensive e njeriut mbi njeriun, siç është Sally Rooney, autore irlandeze me romanin

e saj „Normal People” 2018. Ky roman ishte në listën e gjatë për çmimin Man Booker dhe fitoi kategorinë e romanit më të mirë në Costa Book Awards 2018. Po ashtu këta shkrimtarë sjellin temat si familja dhe madje - madje duke shkuar deri te kriza planetare e klimës (polikriza) dhe problemet e klimatogjisë botërore, siç është artikulli nga Daniel Simon, redaktor i World Literary Today (WLT). Ndërsa do të veçoja ata që na shkruajnë

për mjeshtërinë e shkrimit, artin e tij, metodologjinë, imagjinatën e shkrimtarit, poetit dhe në përgjithësi të njerëzve të letrave. Novelisti Hernan Diaz, një argjentinezo-suedeze, të shkruarit e quan si një akt monstruoz dhe leximin e quan gjithmonë si një akt besimi dhe ka bindje se libri gjithmonë na kërkon të vëmë në dyshim supozimet e tij. Duke vazhduar më tutje me disa fakte nga letërsia, që nga zanafilla e saj, atë që deri tani e njeh njerëzimi, me poemat epike të para, si mite dhe tregime për të bëmat e heronjve dhe „zotave”, siç janë Ramayana dhe Mahabharata (v. 500 para erës së re), me dy poemat e famshme të lashtësisë Odisenë dhe Iliadën e Homerit (shek. 8 para erës së re), me njërin ndër romanet më të hershme që njeh historia e shkrimtarisë, Don Kishotin (1605) etj. Po ashtu vepra në fjalë na sjell edhe analitikën letrare, tema të cilat na duhen në letrat tona, dallimin mes shkrimtarit dhe autorit, tema të tilla se si të analizohet një roman, interpretimi letrar i poezisë, tema për teatrin dhe frymën emancipuese që sjell ai, edukimin shpirtëror të publikut dhe popullit përmes tij, temën e rezistencës që sjell teatri dhe filozofia e tij, për kritikën letrare, të artit dhe analitikën zhbiruese e të thellë që sjell si frymë dhe formë e të menduarit etj etj. Si përmbledhje të fundit mund ta themi se vepra në fjalë s’është për lexues të rëndomtë. Ajo është më shumë për studentë të letërsisë, studiues, artistë të niveleve të ndryshme dhe pse jo edhe publicistë e punëtorë të penës. Vepër me vlera të larmishme, me përkthime nga mendje të thella të letërsisë nga Lindja e Perëndimi, gjë që atë e bëjnë akoma më me vlerë! Libri në fjalë sjell emra deri tani të panjohur të letërsisë botërore, e që ndoshta asnjëherë nuk janë përkthyer në shqipen tonë! Emancipimi letrar është një dimension dhe vlerë e shkëlqyer e njeriut dhe qenies së tij, andaj një letërsi e mirë është goxha një botëkuptim i thellë për reflektimet e rrethanave dhe situatave tona në të cilat gjendemi. Një letërsi e mirë dhe mirëfilli e strukturuar, do të thojë është “ana tjetër religjioze e jetës sociale të njeriut” dhe njëri ndër zërat më të fuqishëm për rezistencë intensive, aktive dhe të përditshme ndaj çdo forme të letargjisë së pari dhe më pastaj edhe ndaj çdo forme, apo më mirë ta themi „të çfarëdo parimi amorf” të të menduarit kolonialist dhe pushtetmbajtës që sjell bota sot. Thjesht, letërsia e mirë është zëri më i thellë i arsyes dhe i Zotit mbi ndërgjegjen e njeriut thellë.

Rilexim

RINGJALLJA E KUJTIMEVE PËRMES FJALËS SË SHKRUAR

(Arben Imeri, Unë banoja në Tiranë, tregime, Toena, Tiranë, 2014)

Sabit B. BAJRAKTRI

Teksa i lexoja tregimet e librit Unë banoja në Tiranë, m’u kujtua një urtësi indiane: “Lumenjtë nuk e pinë ujin e tyre; pemët nuk i hanë frutat e tyre; retë nuk e përpijnë shiun e tyre. Çdo gjë që është me vlerë të madhe, gjithmonë është për të mirën e të tjerëve”. E tillë është edhe kjo përmbledhje tregimesh, me detajet dhe sfidat e dëshmuara. Tregimet e Arben Imerit (1965), flasin për një kohë kur ngjyrat e jetës ishin

paksa të zbehta, pamja e së ardhmes mbështillej me mjegulla katërstinëshe. Jetë tjetër ishte atëbotë. Sot kur të mirat materiale janë më se të mjaftueshme teksa e kujtojmë të kaluarën, ndjejmë mungesën dhe shijen e lumturisë që atëbotë dhe në ato rrethana nuk ishim në dijeni se e posedonim. Secili që rikthehet në Tiranën e tij, sëpaku përmes tregimeve të këtij libri, e ndjen dhe kupton se i mungon fëmijëria, ajo tablo bardh e zi. I mungon loja, shpresa, sakrificat, ëndrrat, rrugët, stadiumet, xhirot dhe secila nga ato grimca të jetës

që e përbënin jetën e një ambienti që nuk është më. Një qytet i cili jeton në kujtesën e shkrimtarit dhe sëfundmi edhe brenda kapakëve të një libri. Përmes librit Unë banoja në Tiranë, rikthehemi te ato dromca jete, rilindim dhe e ringjallim atë fëmijëri që fshihet thellë në kujtesën tonë. Teksa e vështrojmë dhe e ndjekim koherencën e secilit rrëfim të këtij libri, i cili ka gjithsej tridhjetë e gjashtë tregime, brenda tregimeve si tërësi vërejmë elementet e një romani, lidhshmëria e njërës dhe tjetrit tregim

janë aq të padukshme sa që ky libër mund të lexohet si një roman. Brenda tregimeve shfaqen tablotë e një periudhe ku bota e një fëmije dhe bota e një adoleshenti ngjajnë si surreale, nëse e krahasojmë kohën e shkuar me kohën e sotme. Te tregimi “Sandalet e reja”, na përshkruhet ndjenja e lumturisë që pothuajse të gjithë ne një skenë të tillë e kemi përjetuar, në një kohë të largët prej këtui. Pastaj vjen çasti kur fëmija i lumturuar me një palë mbathje të reja kërkon diçka më shumë nga vetja, mbase edhe nga jeta, diçka që jo të gjithë

njerëzit e mendojnë dhe e ëndërrojnë një fat të tillë, për të eksploruar rrugë të reja, jetë të re. Ndërkohë, papritmas dhe krejt fshehurazi lind motivi i ikjes, kujtojmë tregimin “Arjani”. Ndërsa te tregimi i radhës “Gabriela dhe vizat”, na rrëfehet për dukurinë fatkeqësisht të zakonshme sot e asaj dite.

Tirana rrëfimtarit i bie ngushtë, mendimet kanë tjera përmasa, tjetër ëndërr sheh e ardhmja e tij sa që një ditë të zakonshme nisë udhëtimi drejt një jete të dinjitetshme, edhepse përherë tregimtarit i mungon gjysma e tij, rrugët ku njohu dhe u rrit me shokët, shkollën ku mësoi, zhvillimin e teknologjisë me hapat e vegjël që e përcolli në jetë, sidomos sporti që ishte një kënaqësi dhe argëtim. Tirana e viteve tetëdhjetë ishte më e bukur, më e pastër dhe smogu sikur nuk ekzistonte. Kujtojmë edhe shëtitjet nëpër shesh, ku sipas atyre që kanë jetuar në ato vite rrëfejnë se: “Xhiroja zgjaste më shumë se tre-katër orë dhe thuajse 20 për qind e Tiranës ishte pjesë e saj e përnatshme”. Më vonë lexuesi, disa prej pyetjeve dhe përgjigjeve, i gjen te tregimi “Kërkonomi jetën dikur” (f. 94-95) që është një shkrim, i cili qëndron mes poezisë dhe prozës poetike. Aty vërejmë se me sa mjeshtëri dhe me sa dhembshuri na e përshkruan përmes fjalëve të gjithë atë periudhë jete që bëhej në qytetin e Tiranës, ku dhembja dhe vuajtja na shfaqen si në pasqyrë, përballë lumturisë dhe kohës prezent e që herë-herë në mes të dy botëve, asaj që na ngufaste dhe kësaj që na



përkëdhelë tani rikthehet nostalgjia. Teksa ne qëndrojmë përballë të shkuarës, së tashmes dhe së ardhmes, lexuesi jo rrallë e zgjedhë jetën e një bote që tashmë nuk ekziston, për ta freskuar kujtesën. Ajo jetë me dromcat e saj na bëri këta që jemi, me të mirat dhe jo të mirat që i bartim brenda nesh. Me historitë që s’mund t’i gjejmë askund si atje, rrugëve të Tiranës. Autori thotë se librit i kam dhënë këtë titull me që kam jetuar në Tiranë. E them shpesh një gjë të tillë se një lexues tjetër mund ta imagjinoje jetën që zhvillohej në Vlorë,

Shkodër, Gjirokaastër, Korçë...

“Ishim të vegjël dikur, ishim të lumtur. Ëndërronim vitet 2000. Ishim të rinj dikur, ishim të trishtuar. Kërkonomi më shumë dikur.”(f. 94).

Këtu portretizohet tabloja e një ëndrre, e cila dëshirohej dhe kërkohej të jetohej patjetër. Pastaj vjen paradoksalja e jetës brenda kujtimeve tani në një formë tjetër.

“Gjetëm fabulën e saj...

Gjetëm lotët... harruam buzëqeshjen. Mësuam gjuhët e botës... harruam atë të nënës. Lamë sofrën... u ulëm në restorante. Flakëm zinxhirët... blemë litarët. Qethëm flokët... vumë parukat. Hapëm sytë... vumë gjyzlykët. Kërkuam cicërimën e zogjve... dëgjuam ulërimën e ujkut.”

Këto shtresa faktesh e dhembjesh na zgjojnë nga gjumi për t’u rikthyer te rrugët nëpër të cilat ecëm, te ajo jetë që na brumosi, na dha forcë herë-herë pse jo edhe duke na rrezuar përtokë ballë për ballë me realitetin, të cilin njeriu provoi dhe u mundua ta ndryshonte, duke i dhënë ngjyra, duke i dhënë kuptim dhe jetë vet jetës. Në një rast apo situatë të tillë shkrimtari i mirënjohur Ragip Sylaj, në një poezi qe përgjigjur kështu: “Ta jap shpirtin tim/ Pa operacion, / Që t’i bëhesh frymë/ Atij që të thërret:/ Ta jap gjakun tim pa transfuzion, / T’i bëhesh gjak njeriut/ Kur derdhet n’jetë. Arben Imeri është një autor i cili ka prekur kujtesën, në radhë të parë të atyre që e kanë provuar mërgimin si dhe atyre të cilët e kanë parë mërgimin përmes syve të familjarëve. Ky autor shquhet për një rrëfim të rrjedhshëm në tregime, sidomos mënyra se si e përmbyllë një dromcë jete. Fjalia e fundit është edhe ajo që i vë çelësin tërë rrëfimit, dhe jo rrallë edhe titullit të atij tregimi. Tirana e Arben Imerit ka qenë e bukur atëherë dhe është e tillë edhe sot.

Dorëshkrimet që u përjetësuan në libër

POETI NUK ËSHTË POET NËSE NUK IA HAP KRAHARORIN DHEMBJES

(Parathënie e librave të Sabri Zirap Dautit: VARGJE TË VJESHTËS SË VONË dhe FRYMA E FUNDIT E VETMISË, botuar nga QMMK “Toleranca”, Shkup, 2018)

Shkëlzen HALIMI

Kur miku im Daut Dauti më tha se ka ardhur koha që ta shohin dritën dorëshkrimet e mikut tonë të përbashkët, Sabri Zirap Dautit, ndjeva edhe pikëllim, por edhe gëzim. I pikëlluar për shkak se ai nga kjo jetë iku para kohe, këtu e njëzet vjet më parë, por i gëzuar sepse më në fund do të përjetësohet shpirti i tij artistik. Dhe ja tek i kemi disa nga poezitë e tij, të cilat janë të ngjyrosura me dashuri, ngrohtësi e urtësi... Por edhe me dhembje. Dhe poeti nuk është poet nëse nuk ia hap kraharorin dhembjes, të cilin e bën bashkudhëtar në rrugëtimin poetik.

Vargu i tij lirik herë - herë shpërthen me gjithë fuqinë e brendshme, duke i nxjerrë në pah shqetësimet e tij poetike, të cilat i ndihmojnë Sabriut për ta sfiduar atë botë të tij të brendshme, e cila, shikuar nga këndi i sotëm, nuk është vështirë të konstatojmë se ishte thjeshtë botë poetike, ku Sabriu kishte ngritur strehën e tij. Dhe, ai, sikur kishte mësuar se koha do të jetë e shkurtër, ndaj do të shpejtojë ta thotë, përmes fjalës së bukur, të pathënëen që ishte shtresuar në shpirtin e tij plot dashuri. Sabri do të mbetet një zë i artikuluar i kohës në të cilën ai jetoi, zë i shqetësimeve rinore, mbase edhe dramatike. Ai, mbi të gjitha, në botën e tij do të jetë një bohem i vërtetë, sepse rrezaton dhembje, dashuri, por edhe urtësi, sidomos kur i kthehet motivit të vendlindjes.

Në veçanti, impresionon cikli përkushtues për shoqet dhe shokët e klasës. Është një cikël ku derdhet tërë shpirti i Sabriut. Mbase, mund të jetë edhe një cikël paralajmërues për t’i lënë



vend kujtimit të përhershëm:

Nëse ndonjëherë më varrosin
Mbi varrin tim
Të veni flakën e dashurisë

Sabriu që në rini tërë qenien e vet
dhe tërë forcën e brendshme do t’ia

kushtojë fjalës së bukur, me të cilën do të shoqërohet deri në grahmën e fundit. Dhe kjo, atë do ta bëjë sa subtil aq edhe të ndjeshëm, ndoshta për faktin se ai botën e kundronte më ndryshe. Megjithatë, ai dhembjen do ta barrikadojë në kështjellën e tij, të cilën e kishte ngritur, portat e së cilës hapeshin

vetëm në çastet e vetmisë, kur ngjyra e lapsit mbushte faqet e fletores, e cila gjithsesi ndonjëherë do të jetë mbyllur edhe në orët e para të mëngjesit. Nga kjo kështjellë e Sabriut do të shpërthejnë edhe vargjet antologjike të tij të poezisë me titull: DASHNORËT E NDARË

Unë kisha lotin
Ti kishe syrin
Por kush kishte zemrën
Unë kisha dhimbjen
Ti kishe shpirtin
Por kush kishte plagën?
Unë kisha pikëllimin
Ti kishe mallëngjimin
Por kush kishte vetminë?
Unë kisha dashurinë
Ti kishe dashurinë
Por ne s’u dashuruam

Kjo poezi që është një nga më të bukurat nga opusi i Sabriut, që është një klithje e brendshme, një monolog, krijon mozaikun e një drame sa të përfunduar aq edhe të papërfunduar. Një emocion i vërtetë që është i prekshëm, i ndjeshëm dhe i përjetësuar. S’është gjendje personale, por universale... Sabriu i takon një brezi të krijuesve që do të shpërthejnë në vitet 80-ta dhe që kishin një profil të caktuar. Përfaqësuesit e këtij brezi sot janë emra të shquar të letërsisë shqiptare. Hapi i ndërprerë para kohe nuk ia ul fare vlerën krijimeve të Sabriut, të cilat i bënë ballë kohës dhe të vërtetës se fjala e bukur vetëm sa e zbukuron atë që është e përjetshme. Pikëllimin tonë për Sabriun që na iku në vitin 1998 e mbulon gëzimi dhe fakti se ai na e la të përjetshmen – librin...

(Shkup, shkurt, 2018)

Variacione

IDETË E KULLUARA DHE IDETË E MISHËRUARA

Dallimet ndërmjet shpirtit dhe frymës së kulluar janë të njëjta me ato ndërmjet jetës dhe flijimit të jetës, ndërmjet mëkatit dhe virtytit, ndërmjet diabolikes dhe hyjnores

Ernesto SABATO

Sartrin total nuk e gjejmë tek esetë e tij të shndritshme, por te personazhet e fiksioneve të tij. Tolstoi më autentik nuk është ai që moralizon në libërthin e tij mbi artin, po ai njeri i përçudnuar e i përçindshëm që gjejmë te Kujtimet e një të çmenduri. Mendimi i kulluar i një shkrimtari është ana e tij rreptësishtë e ditës, teksa fiksionet e tij i përkasin edhe botës së territ. Shpirti, ndërmjet mishit dhe frymës, ambig dhe i ankthshëm, i rrëmbyer shpesh nga emocionet e trupit dhe duke aspiruar përjetësinë e frymës së kulluar, duke u luhatur përherë midis relatives dhe absolutes, është fusha e fiksionit për antonomazi. Dallimet ndërmjet shpirtit dhe frymës së kulluar janë të njëjta me ato ndërmjet jetës dhe flijimit të jetës, ndërmjet mëkatit dhe virtytit, ndërmjet diabolikes dhe hyjnores. Dhe kjo është humnera që ndan shkrimtarin nga filozofi.

Çka nuk do të thotë se idetë nuk mund dhe as duhet të shfaqen në fiksione, sepse qeniet njerëzore që u japin jetë, si qenie prej mishi e gjaku, nuk mund të mos mendojnë, tek qajnë, qeshin apo emocionohen, përsiaten dhe grinden. Veçse këto ide që shfaqen kësodore nuk janë idetë e kulluara të të menduarit apriori, po janë shfaqjet jo të kulluara mendore të qenies ekzistuese. Këta personazhe nuk flasin për filozofinë, porse e jetojnë atë. Dhe, ndërmjet një personazhi të mirëfilltë romani e një marionete që thjesht përsërit mendime të kulluara ekziston i njëjti dallim po aq i madh sa ai ndërmjet njeriut Imanuel Kant (me sëmundjet dhe veset e tij, me brishtësinë e tij fizike dhe me ndjenjat e tij) dhe ideve të veprës Kritika e arsyes së kulluar.

Nga ana tjetër, nuk duhet të supozojmë se,

ngaqë janë personazhe fiksioni, thjesht nga fakti se ekzistojnë në letër dhe janë krijuar nga një artist, personazheve u mungon liria dhe, rrjedhimisht, idetë e tyre s’mund të jenë veçse idetë (e menduara qysh më parë) të vetë autorit. Gjithsesi, jo doemos. Duke ardhur, siç vijnë, nga tërësia shpirtërore e krijuesit të tyre, është e natyrshme që në disa prej tyre të shfaqen ide që, në një mënyrë apo në tjetrën, të përkryera ose të papërkryera, kanë lindur ndonjëherë në mendjen e vetë artistit, po edhe në të tilla raste, këto ide, duke qenë të mishëruara në personazhe që nuk janë saktësisht autori, tek shfaqen të përzier me të tjera rrethana, me tjetër armaturë trupore, me të tjera pasione, me të tjera mani, tashmë nuk janë të atilla që autori do të mund t’i kishte shprehur ndonjëherë nga pozicioni i vet, dhe, të përçudnuara nga trysnitë e reja (trysni që, në fiksion, janë të tmerrshme dhe demoniake) marrin një shkëlqim që nuk e kishin pasur më parë, u përftohen thepa dhe nuanca të reja, fitojnë një fuqi depërtuese të pazakontë. Janë, tekefundit, ide të tjetërillojta. Nga anët e tjera, qeniet reale janë të lira dhe, nëse personazhet e fiksionit nuk janë të lirë, nuk janë të vërtetë dhe romani shndërrohet në një simulakër pa vlerë. Artisti ulet kundruall personazhit të vet ashtu si shikuesi i pafuqishëm kundruall një qenieje prej mishi e gjaku: mund ta shohë veprimin, madje mund ta parashohë, por nuk mund ta shmangë (çka, me që ra fjala, tregon se gjer në çfarë pike mund të jetë i lirë njeriu dhe se kjo liri nuk bie kontradiktë me gjithëditurinë e Zotit). Nga thellësitë e një qenieje të huaj, nga liria e saj, buron diçka e papërballueshme që as shikuesi, as autori nuk e ndal dot. Çka është e çuditshme, çka është ontologjikisht për t’u habitur, është se kjo krijesë përbën një zgjatim të artistit, dhe çdo gjë ndodh sikur një pjesë e qenies

së tij të ishte skizofrenikisht dëshmitare e pjesës tjetër, e asaj çka pjesa tjetër bën ose vendos të bëjë: po dëshmitar i pafuqishëm Pra, nëse jeta është liri brenda një situatë, jeta e një personazh romanesk është dyfish e lirë, sepse i jep mundësi autori që të provojë (në mënyrë të mistershme) fate të tjera. Është njëherësh përpjekje për të ikur nga kufizimi i pashmangshëm i mundësive tona dhe arratisje nga e përditshmja. Dallimi ekziston, për shembull, ndërmjet paranojakut që krijon një artist dhe një paranojaku prej mishi e gjaku, është se shkrimtari që e krijon mund të kthehet mbrapsht nga marrëzia, ndërsa i çmenduri mbetet në çmendinë. Është naivitet të pandehësh, pandehin disa nga lexuesit, se Dostojevski është një personazh i Dostojevskit. Sigurisht, një pjesë e mirë e tij gjallon tek Ivani Dimitri, tek Aljoshë, te Smerdiakovi; po vështirë që Aljoshë mund ta shkruante romanin Vellezërit Karamazov. Po kështu, duhet supozuar se idetë e Dimitri Karamazovit janë rreptës idetë tërësore të Dostojevskit: ato janë gjithsesi disa nga i që, në delir apo në ëndërr, në gjysmëzhgjendërr apo në eks apo në gjendje epileptike, janë organizuar në mendjen e krijuar të tyre, të përzier me ide të tjera të kundërta, të ngjyrosur- ndjenja fajësie ose mllëfi, të bashkuara me dëshira vetëvra ose vrasjeje.

Falë kësaj dialektike ekzistenciale që shpaloset nga shpirti i shkrimtarit duke u mishëruar te personazhet që luftojnë dhunshëm mes veti dhe ndonjëherë madje edhe brenda vetes, përftohet një tjetër dallim i theksuar ndërmjet romanit dhe filozofisë, sepse, ndërsa një sistem mendimi duhet të ndërtohet në mënyrë koherente dhe pa asnjë kontradiktë, mendimi i romancierit paraqitet në mënyrë të përdredhur, kontradiktore dhe ambigue. Cili është saktësisht botëkuptimi

i Servantesit? Ai që jepet nëpërmjet Don Kishotit, apo në ato që lllomotit Sançoja? Cilat janë idetë që shpreh Servantesi për qeverisjen, për dashurinë, për miqësinë, për pushtetin dhe për grykësinë? Mund të jemi të sigurt se edhe të parat, edhe të dytat, dhe se herë mendonte si shqytari materialist dhe mosbesues, herë e linte veten të rrëmbehej nga idealizmi i marrëzishëm i të çmendurit të tij, në mos po i gjendeshin njëkohësisht që të dy sistemet e mendimit në vetë zemrën e e tij, në një luftë sflitëse dhe melankolike, në atë zemër prej krijuesi të madh që duket se përmbledh të këqijat dhe virtytet e tërë njerëzimit, madhështinë dhe mjerimin e njeriut në përgjithësi.

Sidoqoftë, pavarësisht nga kjo polivalencë e personazheve, kur mbarojmë se lexuari një roman të madh, kemi ndjesinë se ndodhemi përballë një vizioni të veçantë për botën dhe ekzistencën, i cili nuk buron dhe aq nga idetë e shkëputura që kanë shprehur këmbyerazi personazhet e tij sesa nga njëfarë atmosfere e përgjithshme, nga njëfarë tonaliteti që duket se i ngjyros objektet dhe figurat e universit romanesk. Kjo dukuri, ndonëse del më qartë në rastin e një romancieri si Kafka (për arsyen e vetëkuptueshme se tek ai pothuaj nuk ka personazhe, po vetëm atmosferë), shfaqet edhe në romane aq të populluara e të larmishme sikurse Vëllezërit Karamazov apo Dritë gushti. Ndoshta duhet të pranojmë, së bashku me Moravinë [Moravia], se kjo «ideologji» e romancierit shfaqet përherë në trajtë aluzioni ose parandjenje, me një proces që duket se konsiston në krijimin e një metafizike të saktë dhe pastaj në heqjen e pjesës ideologjike të saj, duke lënë vetëm pjesën faktike. Së paku kjo është përshtypja që të lë dikush si Kafka. (Pika pa sipërfaqe)



Poezi: Remzi SALIHU

NJË KOMETË NË QIELL

Hap tunele të gjata në qiell të mugët
Me metafora të fshehta matën shtatin
Gjuhën e rruan në zenitin e zemrës
Nga përgjakjet barbare të fqinjëve

Kërkon egzil nëpër yje
Shtegun e rruan nga kafshimi
I dhëmbëve të prishur të kohës

Kopje të pakufishme mjegullash
Në këtë indigo të zezë të pritjes
Një kometë gjuan me dritë në qiell
Rruan sintaksën e komunikimit
Nëpër horizontin e zgjatur malor

MIDISVERA

nën gjuhë
e fsheh verën e shkrumbuar
etja i shuhet
nën hijen e kujtesës
fotografia ime
kthehet prapa në profil
në gjurmët e monedhës së humbur
lanë djersët e ndryshkur
nëpër zbrazëtinë e rërës
rudhoset koha

pluhuri i përndjekur
nga era e papërgjegjshme
bënë çerdhe në flokët e mia
frymëmarrje e vjedhur
nga midisvera thyen gishtat e tharë
midis dhëmbëve hap tunel të mpirë
nga një faktomë e pa paralajmëruar

KUR TI SHKRUAN GJITHÇKA NË MURE

hape derën e burimit bir
se ka një kërcim ngjyrash prapa tejt
në kureshtjen tënde anonime
të troket hija e përndjekur ditës
dhe unë nuk e di tani se ku e kemi hedhur veten
atë vështrimin tim të harruar në hije
në lirinë e burgosur në vete
copat kujtimesh më duken të ndara nga ne
në çdo përfolje tiranie fotografi e hapur
dhe ti mos më fsheh kuptimin në mur
brenda mesazhit të mbyllur
nën lëkurën tënde të grafikeve
Fuck you system të betonit
që del nga tuneli i fshehtë i pamjes së parë
i duarve të mjegullta në hapësirë të vrazhdë
që ta ndrydh dridhjen e ndihmës
nëpër rrudhat e shkrimit striptiz
të varur në regipsin e shkruar të parashikimit
në ballin tënd të njomë
hape derën me kujdes bir
të mos na mplaket vetmia

ME NJË SHKËNDIJË MALLI

Jetoj
midis tokës dhe qiellit
Jetoj midis peshës së rënies dhe ngritjes
një yll më mban për flokësh
m'i shkul mendimet një nga një
një pemë e lartë varet për mua
frytet i hanë të vdekurit
kometë e zgjatur midis dy atmosferëve
Tokë e Qiell më buçasin në kokë
Jetoj i tërhequr në vete zvarrë
herë lartë e herë poshtë i gjallë
me një shkëndijë malli në zemër
që më ndriçon në ballë
e më djeg si zjarr
Jetoj

KËRKIMI

nuk më gjete
aty ku më ke lënë
hapësira ka zënë peng
hijen time

në heshtje apo në jehonë
kapu pas flokëve të ajrit
që ta shpalos trupin
e shigjetuar nga vetmia

nuk do ta caktoj kërkimin
ajo është kohë e zgjatur
në mitin që ka peshën
e rëndë të shekujve të humbur

RRËNJËT

pesha ime shtrihet
në rrënjët e pemës
me fryte të kafshuara nga dielli

në duart e mia
pema shpërndanë degët
yjet bëjnë dritë
nëpër rrudha balli
nëpër diskursin e fjalëve
mjegullat lëndojnë
metaforat e thyera në asht

fryti më bie nga dora
shkëlqimi i tërheq hijet
thellë në mua
varen rrënjët e jakut

KUFIRI


etne të mbyllura në lëkurë kufiri
akullnaja të varura pingul
në strehë kaçkëtash të kontominuara
pengje bisedash amorfe
midis daljes dhe hyrjes kufitare

nëpër gjemba të ndryshkur
pamflete ligjesh të përkohshme
këmbët shpojnë kalimin ilegal
të mbylljes së fatkeqësisë individuale

veten e mbyllën në grila
hapat e shkurta ikën matanë kufirit
të salduara me duar në fugën e heshtjes

nën hijen e ftohtë të pritjes
arkivol i hapur për kalimtarë të vetmuar
në kufirin eksperimental të mbylljes
klandestinë heqin vallen e zezë
midis rrugës së shpejtë
kalimi mbyll ikjen me barriera mendimesh

matanë pret vasha trimin
në këtë anë pret trimi vashën
në mes kurorë grilash të thyera në mes
me ëndrra të përgjumura në shteg dënimi



Tregim/ Xhabir TABAKU

DJALI PA EMËR



ai ishte një djalë në pamje i zakonshëm. familja e tij kishte banuar në po atë zonë të qytetit qyshkur.

qyshkur s’mbahej mend. diçka rreth atij djalë... thoshin mëhallalijtë. të gjithë e shikonin disi me ndrojtje a me dyshim tek ai shkonte rrugëve e rrugicave të mëhallës disi shpërfillës. mbante me vete një fletore të paluar për së gjati dhe një laps në xhepin e xhaketës gri prej doku. ecte me hap të ngadaltë. flokët e pakrehur e të shpupurishur e bënin të dukej ende më i çuditshëm për kojshitë, të rinjt e të vjetrit. çka e bënte të dukej halá më pak i zakonshëm ishin gjyslykët me skelet ngjyrë kafe e errët dhe të trashë. “fund i kavanozit”, e quanin fëmijët e rrugicës - duke iu referuar trashësisë së xhamave të syzeve që mbante.

anjë nuk e thërriste në emër, thua se s’kishte emër, djali. largohej nga shpia sapo kthente nga shkolla dhe herë pas here ndalonte dhe se ç’shkruante në atë fletoren e paluar dyshë. e palonte prap dhe ecte për dikah. as vetë s’e di nga shkon thoshin të njohurit dhe herë e shihnin me përcmim, herë me të tallur e herë të tjera, me dhimbsuri. ai s’i fliste askujt e, pothuaj askush s’i fliste. rrallëherë ndonjë plakë a plak i lëshonte ndonjë pyetje por as ata s’ia thoshin emrin; si je o djali i Haxhires? - i flisnin plakat, kurse pletqë: - fole ndo’j fjalë o djali Xhemalit! një buzëqeshje e lehtë dhe fisnike ishte e shumta që lëshonte ai

si reagim. ***

vjeshtave ditët shkurtoheshin me ngut. thuajse dikush kujdesej të sillte dimrin me vrik, thua ti se s’kishte kohë mjaft, thua se dimri në këtë qytet nuk zgjatë sa një vit.

atë ditë të vonë vjeshte ishte vranët. nga ato ditët e vranta që të bëjnë të mendosh se qiella do të shprazet njëherësh e papritur. të gjithë nxitonin për diku. një për në shtëpi, një për në dyqan e një tjetër në kopsht për të marrë fëmijën sa pa plasë rrebeshi. gjethet e plepave, do të verdhë si dylli e do të tjerë të rrudhosur e të thatë vërtiteshin si lakuriqë nate pa orientim por gjithandej. ai, djali i çuditshëm i mëhallës pra, doli nga shpia me hapa të ngadaltë. mbasi hodhi disa hapa tej pragut të derës së oborrit, preku vedin xhep mbas xhepi dhe shau diçka nepër dhëmbë si rrallëherë dhe u kthye në shtëpi. kishte harruar fletoren që e mbante të paluar në xhepin e pasëm të pantallonave dhe lapsin. -kthehu mbrapsht! - i foli Hajdari, një shok klase dhe mëhallalí, do të plasë furtunë. - jo, reagoi ai dhe shpejtoi hapat, siç bënte rëndom kur dikush i fliste në urdhërore.

pa pá e pa ndí, ra nata. retë u ulën e ranë poshtë kodrave. shenjë e qartë se do binte shiu i tërbuar dhe i shumëpritur. por nuk ra shi fare. një erë e ngrohtë dhe e rrëmbyer që

vendasit e thërrisnin shirók filloi të frynte thua ti do të shkulte botën me rrënjë. për pak, krejt dynjaja u struk. disa nxituan të mbyllnin dritaret me shula e t’i vinin dyerve të oborrit rézet e mëdha e llozat e rëndë prej hekuri që ngjanin si kërraba fiku. rrugët i hëngri nata. sterra e asaj nate do mbahej mend gjatë nga njerëzia. mbas një tri a katër orësh era mëu dhe vranësira u hapërdá si të mos kishte qenë. të gjithë mbledhur në minderët pranë shporetëve me dru e zjerm bubulak i shëndoheshin ndalimit të erës së marrë. degë të thyera pemësh mbushnin rrugicat e mëhallës; punë e madhe për të nesërmen.

Haxhirjasilleje vërtitej nepër mëhallë si fillim, mandej në mëhallën ngjitë, në tjetrën e tjetrën. asnjë s’e kish parë djalin e çuditshëm. asnjë. i ati tij shkoi tek policia e zonës dhe lajmoi që biri i tij nuk ishte kthyer në shtëpi qëkur që larguar dy a tri orë para furtunës mbasditen e një dite më parë. polici e pau fillimisht me çpërfillje, por kur vëreu që Xhemalit zú t’i dridhej gusha ndërroi qëndrim. mori shënim të dhënat e të birit dhe e garantoj atë se do kontaktonte stacionet e tjera të policisë së qytetit, poliklinikën dhe spitalin. u mundua ta qetësonte burrin që dridhej tashmá si thupra n’erë.

kishin kaluar disa ditë por asnjë e re rreth djalit të çuditshëm. mëhallalijtë

të gjithë u alarmuan. secili përjetoi një ndjenjë faji. dikush pse s’i kishte folur, dikush tjetër pse e kish’ tallur. njëri pse s’e kishte afruar e një tjetër pse e kishte thirrur “fund kavanozi” a emra të tjerë. të gjithë pyesnin paprâ herë prindërit e tij herë motrën e vogël. ajo, e motra pra, s fliste fare. sa herë e pyesnin ajo vetëm u hidhte atyre një shikim të vranët dhe kthente shpinën. netëve të gjata e të errëta të dimrit që vijuan vajza e vogël vetëm qante e qante.

vajza që solli në shtëpi fletoren dhe lapsin e djalit s’i dha asnjë shpjegim së motrës kur hapi derën. as ajo nuk bëri pyetje. mori shkallët e gurta që të shpinin në katin e tretë ku ishte dhoma e të vëllait. u ul mbi shkallë dhe zú e lexoi. ngjiti pastaj një kat tjetër shkallët dhe trokiti tri herë me nye të gishtit mbi derën e odës së tij. ai hapi derën me përtesë. -hë! - shih -shih! shih si të ka përshkruar Aida. edhe të mëhallës, edhe babën, nanën e mua. ty të ka qarë fare, të njeh më mirë nga ne të gjithë. — ik tani e foli! kuptohet që të do nga ç’ka shkruar. u bë gjatë që s’ ke dalë nga shtëpia. — prit! foli ai, eja në dhomë! shihi pak këto shënime në fletore. janë vjersha që kam shkruar këto ditë për Aiden. lexoji e më thuaj!

Pol Verlen - Artur Rembo

“ZANA E GJELBER” E SKËTERRËS

Është një pansion shumë i vjetër në Kamden Taun të Londrës, që ndoshta ekziston gjer më sot, ngaqë ka në hyrje të tij këtë nënshkrim: “Këtu kanë jetuar poetët Pol Verlen dhe Artur Rembo”. Kaq, pak fjalë, por mjaftojnë për të mbetur në histori

Grigor JOVANI

Ekziston një skicë-portret i poetit Artur Rembo. E ka vizatuar një poet tjetër, bashkëkombës, po kaq heretik - në mos më shumë - se djaloshi skandaloz, që shkruante vargje si profit dhe jetonte si personazhet e Hygoit, fotografuar në lumpenin më të errët të Parisit. Pol Verleni. Ç’i lidhte të dy, përveç talentit të madh dhe perversitetit të skajshëm? Dashuroheshin, prandaj dhe Verleni e ka vizatuar Rembonë si “ëngjëllin e butë” të Lorkës, diçka e ndaluar dhe e paaritshme. Si poezinë më heretike. Më tepër se ajo e Bodlerit.

Është një pansion shumë i vjetër në Kamden Taun të Londrës, që ndoshta ekziston gjer më sot, ngaqë ka në hyrje të tij këtë nënshkrim: “Këtu kanë jetuar poetët Pol Verlen dhe Artur Rembo”. Kaq, pak fjalë, por mjaftojnë për të mbetur në histori.

Nuk qëndruan shumë në Londër. Marrëdhënia e tyre e stuhishme kishte shumë stacione: Bruksel, Sharsvil, Paris. “Zana e gjelbër”, e cila u qëndronte mbi kokë në mënyrë shumë katastrofike dy poetëve, i shtynte vazhdimisht drejt një dashurie të çmendur, që u stigmatizoi jetën. Kudo ku gjendeshin linin shënjat e çmendurisë së tyre, bota që i njohu në këto çaste pasioni i karakterizon “të dhunshëm dhe të frikshëm”. Nuk ishin të pakta rastet, kur dy dashnorët e marrë, të mbërthyer në epshtet e alkoolit, luftonin njeri-tjetrin me thika të mbështjellura me shami. Gjersa plagosej njeri prej tyre dhe ata



ndalonin përleshjen, duke u hedhur në të tjera, në kënaqësitë e ferrit të tyre erotik. Pastaj, të shkrehur krejt, i dorëzoheshin asgjesë. Verleni, paksa i moshuar, me vështrim gati të shuar dhe Remboja, me fytyrë feminare, si një ëngjëll i pistë dhe i turpshëm, me dëshirën e vazhdueshme

për të provokuar të tjerët rreth tij. Siç nisi, ashtu dhe do të mbaronte dashuria e tyre. Në mënyrë skandaloze. Ndodhi në Bruksel, pas një zënkeje të tmerrshme. Vetëm kështu mund të merrte fund një dashuri kaq absurde, kundër epokës dhe ligjeve të saj.

Goditjen e parë e dha Verleni, por shkaktar ishte Remboja, me ironinë e tij të përherëshme. Verleni godet në fytyrë djaloshin me një peshk që mbante në dorë. Pas sherrit, dhunuesi largohet drejt një hoteli tjetër. Remboja, pasi kishte mbledhur rrobat e Verlenit në një thes, e ndjek nga pas. Gjenden përsëri të dy në dhomën e hotelit ku kishte përfunduar Verleni. Prapë nga e para. Zjarri kishte triumfuar përsëri, kësaj here më tmerrshëm. Pesëdhjetëvjeçari Pol nxjerr armën e tij dhe plagos të riun në kyçin e dorës. Ndërhyn ligji. Nuk mund të bënte gjithmonë një sy qorr. Verleni burgoset. Por ç’rëndësi ka kjo? Remboja, pa Verlenin, humb busullën. Rron kudo dhe askund, bëhet më skandaloz se më parë, gjersa vdes i lodhur dhe i pështirosur nga jeta, pa mbushur dhjetëvjeçarin e tretë. Në Sharsvil ekziston shtëpia e tij e përherëshme, nën dhe. Ironia e tij e pashembullt e shoqëron edhe në botën përtej. Duket edhe tek mbishkrimi mbi pllakën e varrit të tij: “Lutuni për të!” Ai që nuk iu lut askujt, që nuk pati nevojë kurrë për pekule. Mbase këtu, tek kjo dashuri e pashembullt, e kishte fjalën një heretik tjetër, Serzh Gensbur, kur shkruante për t’u kënduar: “Erdha t’iu them se po iki dhe lotët e tu nuk do të ndryshojnë asgjë, siç thotë aq mirë Verleni, me atë erën e keqe...”

Vallë, për kë e ka fjalën Verleni, për kë?

(Athinë, janar 2025)

Profile

SCOTT FITZGERALD - KRONIKANI MË I SHQUAR I BREZIT TË EPOKËS SË XHAZIT

Brezi i Epokës së Xhazit ishin amerikanët e rinj, që kishin qenë adoleshentë gjatë Luftës së Parë Botërore dhe ishin kryesisht të paprekur nga tmerret psikologjike dhe materiale të konfliktit shkatërrues

Khahid BUSHATI

Scott ishte romancier, eseist dhe krijues plot vlera i tregimeve të shkurtra amerikane. Ndërsa, kur flasim, në veçanti, për romanet e tij, ata përshkruajnë shkëlqimin e Epokës së Xhazit, një term që shkrimtari e popullarizoi në opusin e tij të tregimeve të shkurtra me titull: “Tales of the Age”. Gjatë jetës së tij botoi disa romane, disa novela, katër përmbledhje me tregime dhe 164 tregime të shkurtra. Konsiderohet si një nga shkrimtarët më të mëdhenj amerikanë të shekullit të 20-të. U lindi më 24 shtator 1896. U rrit, kryesisht në shtetin e Nju Jorkut. Ndoqi Universitetin “Princeton”, ku u miqësua me kritikun e ardhshëm Edmund Wilson. Romani “E bukura dhe e mallkuar” (1922), e shtyu atë më tej të hynte në elitën kulturore. Për të ruajtur stilin e tij të pasur, shkroi histori të shumta për revista të njohura, si: “The Saturday”, “Evening Post”, “Collier’s Weekly” dhe “Esquire”. Gjatë kësaj periudhe, Scott shëtitë dhe hulumtoi Evropën, ku u miqësua edhe me Shkrimtarin e “Brezit të humbur” Ernest Heminguej. Studiuesi Dos Passos argumentoi se, në vitin 1945, Scott, më në fund, kishte arritur të krijonte një stil tërheqës dhe të veçantë si romancier. Në këtë gjini veprat e Scott-it lartësuan “... nivelin e fiksionit amerikan”. Gjithashtu, kritikët që kanë studiuar krijimtarinë e Scott-it, mendojnë se, tregimet e këtij



autori nuk janë në nivelin e romaneve të tij; qëndrojnë disi më poshtë. Vërejnë se, në këtë ndryshim spikasin cilësia letrare, pjekuria artistike dhe stilistika plot ngjyra e fjalës, e shprehjes... etj. . Ndaj, autori, ka përparim të dukshëm, në shumë raste të habit opusi romanesk i tij. Ndërsa 164 tregimet e shkurtra shfaqin një tendencë të kundërt (me romanet). Mendoj se në këtë gjykim vlerash, po të kishte studime më të thelluara, do të dilnin në pah shumë pasaktësi gjatë interpretimit të teksteve e koncepteve që mishërojnë veprat, të cilat e kanë dëmtuar disi personalitetin

e Scott-it (që nuk e meritonte), kur duhet të ishte e kundërta. Vijnë te romanet. Scott i kompozoi strukturalisht me një mentalitet-avangardë të ndërgjegjshëm artistik. Tregimet e shkurtra u kritikuan për mungesë koherence dhe të një cilësie artistike, jo aq. Kritikku Paul Rosenfeld shkroi: “... shumë nga tregimet e Fitzgerald-it shtrihen në një plan më të ulët se ai mbi të cilin shtrihet materiali i tij më i mirë.” Por, për pjesën më të madhe të karrierës së tij letrare, kritikët u shprehën se, Fitzgerald-i është kronikani më i shquar i brezit të Epokës së Xhazit, jetët

e të cilëve u përcaktuan nga tranzicioni shoqëror drejt modernitetit. Në kontrast me brezin e vjetër e të humbur, të cilit i përkisnin Fitzgerald dhe Heminguej, brezi i Epokës së Xhazit ishin, në të vërtetë, amerikanë më të rinj, që kishin qenë adoleshentë gjatë Luftës së Parë Botërore, dhe ishin kryesisht të paprekur nga tmerret psikologjike dhe materiale të konfliktit shkatërrues (të jetuarit dhe ëndrrës që lumturonte shpirtin, por që nuk realizohej dhe u falte zhgënjime). Me romanet e tij, Scott u bë shkrimtari i parë që ktheu vëmendjen kombëtare mbi këtë brez. Tërhoqi vëmendjen e kombit mbi aktivitetet e djemve dhe vajzave të tyre që hidheshin si të çmendur në sediljet e zhurmshme të rrugës “Bearcat”, në një rrugë të vetmuar, ku u ndez debati shoqëror mbi imoralitetin e tyre të perceptuar. Për shkak të këtij fokusi tematik, veprat e tij patën sensacion të madh në mesin e studentëve; ndaj, dhe shtypi e përshkruan, e admiron Scott-in si flamurtarin e “... rinisë në revoltë...”. “Asnjë brez i amerikanëve nuk ka pasur një kronist kaq bindës [... ...] sa Fitzgerald-i, - shkroi studiuesi Van Allen në vitin 1934, - dhe asnjë autor nuk u identifikua me brezin e kohës që jetoi shkrimtari, i cili me talentin e madh këtë brez (që frymoi dhe ëndërroi...) e përjetësoi realisht, dinjitetshëm e në vizion tek veprat e tij.” Scott Fitzgerald ndërroi jetë më 21 dhjetor 1940.

Profile

ROMAIN GARY DHE DASHURIA E NJË NËNË

Romain Gary (Romen Gari) apo emri i vërtetë Roman Kacew, i lindur në Vilnius te Lituanisë, ishte autori i vetëm francez që mori dy herë çmimin e madh letrar francez “Goncourt”

Luan RAMA

Po lija Tiranën duke u kthyer në Paris, me imazhet e nënës time shtrirë në shtrat, në grinë e atij fund dimri. Po e lija me akrepat e një kohë që nga dhimbjet nuk lëviznin më, duke kujtuar librin e Albert Cohen me kujtimet e nënës së tij në Libri i nënës time (Le livre de ma mère), kur nga Korfuzi ajo i tregonte tutje majat hijerënda të maleve shqiptare. Pastaj, në avion, në qiellin e dashur të pilotit të dikurshëm Romain Gary, kjo lidhje e gjenezës më rishfaqi një dashuri tjetër akoma më të madhe, një dashuri nëne shkruar nga ai në Premtimin e agut (Promesse de l’aube) një roman që shpesh miqve të mi u thoja ta lexonin. Pikërisht aty kisha ndërë përkushtimin tronditës të një nëne. Dhe meqë ishte pragu i përvjetorit të shkrimtarit tim të parapëlqyer Romain Gary (Romen Gari, 8 maj 1914), unë shkova atë ditë para shtëpisë së tij në 108, Rue du Bac, një rrugë ku kaloj shpesh për në mediatekën “André Malraux”. E dua këtë shkrimtar jo pse ai kishte qenë dhe diplomat e kineast, ku jeta ime rastisi t’i përjetoj gjithashtu, por sepse gjithë vepra e tij romaneske ishte diçka tronditëse dhe e përjetuar në mënyrë dramatike, aq sa herë-herë ai luante me pseudonimet e tij. Në pllakën përkujtimore të vendosur para shtëpisë së tij është shkruar:“Këtu ka jetuar Roman Gary, luftëtar i Çlirimit, shkrimtar dhe diplomat nga viti 1963 e deri sa vdiq më 2 dhjetor 1980». Pikërisht këtu, Romain Gary kishte kaluar një pjesë të madhe të jetës së tij, dramat e shumta dhe jetën boheme, netët e pagjumta pranë skrivanisë së tij, cflitjet shpirtërore dhe zhgënjimet që më së fundi e çuan deri atje sa t’i jepte fund jetës së tij. Ishte prag Krishtlindjesh atë ditë të 2 dhjetorit 1980. Rrugët ishin mbushur me drita, lule dhe kurora argjendi. Shoferit të një miku që e kishte sjellë deri në shtëpi, ai vetëm i ngriti dorën duke e përshëndetur thjeshtë: «Mirupafshim!»... Por tjetri s’do ta shikonte më. Ai ishte ngjitur ngadalë, duke rrokur brenda një minute në imazhe të copëzuara tërë jetën e tij dhe ato ditë të fundme, të zbraztë, të trishta, ku tashmë nuk e ndjente më veten burrë. Një mikeshtë pak kohë më parë e kishte pyetur sesi po e përballonte plakjen. Ndërsa ai i ishte përgjigjur : « Një katastrofë ! Por kjo s’do të më ndodhë kurrë ! E imagjinoj se ndryshe do të ishte nje jetë e tmerreshme. Por unë kam bërë një pakt me atë që është lart në qiell. Një pakt ku unë më së fundi nuk do të plakem !... »

I biri, Aleksandri, nuk ishte në shtëpi. Ai u xhvesh, veshi këmishën e tij blu, la një letër të shkurtër lamtumirë, mbylli perdet e dhomës, hoqi xhaketën, pantallonat, çorapet, këmishën ngjyrë blu, shkoi dhe tërhoqi nga një kuti ngjyrë blu revolverin e tij «Smith&Weston» dhe u shtri ngadalë në shtrat, duke u mbuluar me kuvertë deri në grykë. Pastaj kishte ngritur dorën, kishte futur grykën e revolverit në gojë dhe e kishte shkrehur!... Kështu ikte nga kjo botë shkrimtari Gary, siç kishin shkuar të vetëvrrarë plot shkrimtarë të tjerë parizianë si poeti Gerard de Nerval, Chamfort, Montherlant, La Rochelle, Debord apo siç kishte ikur një mëngjes të ftohtë përtej oqeanit, i madhi Hemingway, pasi kishte shkruar Parisi, një festë e pambarimtë. Gary shkonte kështu të takonte nënën e tij, të cilën akoma e kërkonte në gjumë. Shkonte duke lënë pas një vepër të pasur dhe në veçanti një emër që do të shkruhej në historinë e letërsisë franceze.

Në letrën që kishte lënë sipër këmbëve, në



cepin e krevatit kishte shkruar: «Jour J... Dita e fundit. Asnjë lidhje me vetëvrasjen e Jean Serberg. Atyre që ju vjen keq janë të lutur të shohin gjekë. Sigurisht, mund të thuhet se është si shkak i një depresioni. Por atëherë duhet pranuar se kjo ndodh që kur jam rritur, çka më lejoi të shkruaj veprën time letrare...»

Mungesa më e madhe në jetën e Gary-së ishte nëna e tij, pasi ajo i kishte dhënë atij dashurinë më sublime që mund të jepte një nënë, dashuri të cilën ai s’mund ta gjente diku tjetër. Dhe kështu, hija e saj, drama dhe vdekja e saj, do ta ndiqte pas gjithë jetën, edhe pse ai do të bëhej njeri i famshëm, siç kishte thënë profecinë ajo. Në Rue du Bac, siç shkruan dhe në biografinë për të Myriam Anissimov, e cila kishte rrëmuar gjer në detaje në jetën e tij afektive, në dashuritë e rastësishme dhe dëshirat e tij, ajo tregon se vitet e fundit ai shëtiste gjithnjë në kërkim të ndonjë vështrimi ndjellës, të ndonjë vajze të re që përgjërohej për romanet e tij. «Sa herë që përkëdhelja ndonjë femër, - shkruante Gary, - sytë e saj kërkonin të gjenin në sytë e mi vështrimin e dashurisë. Dhe ajo i ndjente përbetimet e zemrës time në gjoksin e saj, në krahët e mia që e qarkonin dhe e shtrëngonin fort. Atëherë,

ajo më merrte për një të dashuruar: ndërsa unë isha veçse në një lloj ëndrre. Shumë gra kanë pandehur kështu se ishin të dashuruara nga unë, ndërkohë që te unë, ato ishin veçse mungesa e dikujt. Kur unë rifilloja të bëja seks, e shikonin qartë provën e pasionit tim për to, frymëzimin tim, ndërkohë që unë luftoja me ato kohëra të shkuara, ku ndjesitë e mia të ngopura më privonin nga imagjinata dhe më kthenin në atë realitet ku ato gra të huaja më dukeshin tepër të bezdisshme. Ato mendonin të afroheshin më shumë dhe të plekseshin në mënyrë intime përmes shtrëngimeve tona, por pikërisht ato çaste, unë i braktisja ato për tu bashkuar me një tjetër...»

Pas ndarjes me aktoren amerikane Jean Seberg, me rolin e njohur veçanërisht në “A bout du souffle” me Belmondo-n jeta e tij shkonte nëpër mjegull. Rue du Bac, Rue de Rennes, restoranti «Recamier», «Lipp», «La Coupole»... Boulevard de Montparnasse... «Kohë me kohë ndonjë grua lidhte marrëdhënie me mua dhe pastaj ajo më linte, pasi femrat nuk i duan adoleshentët. Ka disa nga ato që qëndrojnë diçka më gjatë, pasi ato janë të martuara dhe kanë familje. Dhe meqë unë u harxhoj jo shumë kohë, ato mendojnë se jam

burri i jetës së tyre... Kam përshtypjen se ato e kuptojnë pastaj se jam një trap, por megjithatë unë vuaj, se më pëlqejnë vajzat e reja. Ndonjëherë, burrat e tyre vijnë të kërkojnë ndonjë shpjegim për veprimet e grave të tyre, por unë jam i pazoti tu them ndonjë gjë. Në fakt gjërat shkojnë jo keq, pasi ata e dinë se jam 60 vjeçar dhe në këtë moshë është më shumë miqësi. Por unë ëndërroj të bëj dashuri si gjithë djemtë adoleshentë...»

Në këto çaste kritike të jetës së tij, kur në një intervistë, një gazetar i Radio-Canada e kishte pyetur për kohën që kalon, për femrën, plakjen dhe jetën, Gary i ishte përgjigjur: «Gjëja e vetme që më intereson në këtë botë është gruaja. Sigurisht, nuk duhet ngatërruar me fjalën gratë. Unë them gruaja, feminiteti... »..

Vallë cili ishte pakti i tij me vetveten? Ai i vetvrasjes, vet-asgjësimit?... Nxitonte të shkruante akoma dhe një roman, edhe një... Meqë s’kishte shumë kohë, ai i thërriste në shtëpi prostitutat “chic”, siç ishin Madame Claude, Madame Billy, të cilat i njihte prej kohësh, kur ishte diplomat dhe thërrisnin prostituta për liderët e vendeve afrikane që zbarkonin në Paris. Një nga tekstet e fundit që kishte shkruar Gary ishte dhe një tekst i shkurtër për katalogun e një ekspozite që do të hapej në Paris mbi rezistencën franceze ku nën titullin Sikur ferri të kishte mure... ndër të tjera ai do të shkruante: «... Ata që u shfarosën shkruanin. Dy muaj pas pushtimit të Polonisë, Emmanuel Ringelblum, kishte detyrën e arkivistit në Geton e Varshavës. Para se të pushkatohej, pas kryengritjes së getos më 1943, Ringelblum i kishte groposur kronikat e tij në një bidon qumështi të ngjitur. Autori - kurrë kjo fjalë nuk ka tingëlluar kaq shumë, - shënon në kronikën e tij: «Të gjithë shkruanin, madje dhe fëmijët...» Askush nuk do t’i njihte emrat e atyre që ngjiznin në vetvete një vepër të ardhme dhe që u vranë para se këto vepra të krijoheshin. Duke shkruar këto rreshta unë mendoj në veçanti për ata. Sa poetë, autorë dramatikë, romancierë? Atë çka ne quajmë në këtë apo atë vend të Europës një «rënie kulturore a nuk i detyrohet një breshërie mitrolozi, një plumbi pas zverkut, një dhome gazi? Një Shekspir i vrrarë në moshën njëzet vjeçare, një Rimbaud i internuar në moshën gjashtë vjeçare pas arrestimeve në Vel’d’Hiv me yllin e verdhë; një Balzak i ardhshëm që nuk pati kohë të ndjejë kuptimin e komedisë njerëzore veç përballë skuadrës së pushkatimit... Po i ndaloj tani këto rreshta... Një turp i tillë, një tërbim i tillë, më kapin zemrën aq sa humbet dhe nocioni zemër; po, ju kap një ndjenjë kundër atyre, kundër jush, kundër nesh, kundër vetes time. Bombat që hodha mbi Gjermani nga viti 1940 deri në vitin 1944 ndoshta kanë vrrarë në djep një Rilke, një Gëte, një Holderlin! Dhe sigurisht, nëse do duhej ribërë kjo gjë, do ta bëja sërrish. Hitleri na kishte dënuar të vrisnim. Kauzat më të drejta nuk janë asnjëherë të pafajshme. Duhet që njerëzorja dhe ç’njerëzorja ta ndërpresin luftën e tyre infernale!...”

Ajo që kishte menduar kaq herë Gary, ndodhi.... Ndodhi atë ditë të vitit 1980, në shtratin e tij, me revolverin e tij kalibër 38mm. Në këmbët e tij ai kishte lënë të shkruar dhe letrën e tij të fundit. Një kopje të letrës ia kishte dërguar me postë dhe botuesit të tij Gallimard, ndërsa një tjetër, Leila-s, me të cilën bashkëjetonte vitet e fundit, të cilës ia kishte lënë në dollapin e saj të rrobave. Tani mund të shkonte i

getë...

“Me vetvrasjen e tij, letërsia franceze ra në zi”... do të shkruante kritiku i njohur Jean Daniel.Në kishën Saint Louis të “Hôtel des Invalides” në Paris nuk u dha meshë për të, pasi ai ishte hebre. Ishte thjesht një çast përkujtimi, heshtjeje, në kujtim të luftëtarit dhe romancierit. Fjala e kancelarit të Madh të «Compagnon de la Libérartion» i bënte lavde rrugës heroike të këtij njeriu. Dhe ja, në fund, një zë buçiti nga salla. Ishte zëri i një këngëtareje polake që kishte ardhur t’i këndonte këngën e vjetër «Le negre violet» që dikur, kur ishte fëmijë, ia këndonte nëna e tij: «Ku je tani? Kush do tu puthë gishtërinjtë...?»

Roman Gary u varros dhe më vonë, më 15 mars 1981, trupi i tij u dogj në krematoriumin e «Père Lachaise» në Paris, sipas dëshirës së tij. Vallë a e kishte gjetur më së fundi sekretin e feminitetit, të cilës ai aq shumë i shkroi ?...

Shkrimtari

Romain Gary (Romen Gari) apo emri i vërtetë Roman Kacew, i lindur në Vilnius te Lituanisë, ishte autori i vetëm francez që mori dy herë çmimin e madh letrar francez “Goncourt”, në fillim, në vitin 1956, me romanin e tij Rrënjët e qiellit (Les Racines du ciel), një nga romanet e parë që tronditi ndërgjegjen botërore për mbrojtjen e natyrës, (romani i parë ekologjik) dhe më 1975 me romanin Jeta para teje (La vie devant soi) kësaj rradhe nën pseudonimin Emile Ajar, histori që krijoi shumë zhurmë në kritikën letrare franceze. E megjithatë, Gary do të citohet më shumë për tregimin e tij autobiografik “Premtimi i agut”, pasi aty është dhe thelbi i ekzistencës së tij si njeri dhe si shkrimtar njëkohësisht. Nëna e tij, që e adhuronte si një Zot, i thoshte gjithnjë se një ditë ai do të bëhej një shkrimtar, një ambasador, një gjeni... dhe ai u bë. Romani i tij të parë Edukimi europian (Education européenne), të cilin e filloi kur ishte mitralier avioni në luftë dhe që u botua në vitin 1945 në anglisht dhe frëngjisht, u prit me një çmim të kritikës franceze. Pas kësaj, Gary do te shkruajë vazhdimisht, si në kohën kur ishte diplomat në Sofje, New York, Londër, Paris apo dhe kur u dërgua si konsull i Përgjithshëm i Francës në San Francisko e më pas. Shpesh, romanet e këtij golisti të vjetër dhe të përbetuar, marrin shkas nga histori të jetës së tij, personazhe të njohur, fati i hebrenjve që bridhnin nëpër botën pa atdhe, eksperiencia të habitshme në jetë apo diplomaci, dhe veçanërisht në eksperiencën e tij me femrat, me dëshirën për të qënë i dashuruar, gjë të cilën kurrë nuk e arriti ta përjetonte ashtu siç donte ai, pasi dashuria e nënës i kishte eklipsuar dhe i kishte bërë të pamundura dashuritë e tjera. Veprat e tij më të mira u shkruan në vitet ‘60 –’70 dhe mes tyre mund të përmendim Nata e qetë, Shkëlqim gruaje, Qeni i bardhë, Balonat, etj, apo vepra e tij e botuar pas vdekjes Jeta dhe vdekja e Emile Ajar, e lidhur ngushtë me problemin e tij identitar, sepse ky hebre, herë me pasaportë sovjetike e herë polake, i cili në adoleshencën e tij më së fundi u bë francez dhe jetoi në Nice, në shkrimet e tij përdori shumë herë pseudonime, duke kërkuar gjithnjë një imazh të tij edhe pse kurrë nuk ishte i kënaqur me atë çka përfaqësonte. Ja pse dhe në romaninPremtimi i agut, ai do të shkruante: “Jeta kur lind, në agun e vet ju bën një premtim që nuk e mban kurrë”... Romain Gary ishte gjithashtu shkrimtari i pasionuar pas kinematografisë dhe ndoshta nga që ai ra në dashuri dhe u martua me një nga aktoret më në zë amerikane të viteve 60-të dhe veçanërisht të “Valës së Re” franceze, Jean Seberg, me filmin A bout de soufflé. Ishte një dashuri e madhe dhe një tragjedi e madhe, pasi pas ndarjes së tyre. Në një depresion të madh Jean bëri vetvrasje e vetmuar në makinën e saj në një rrugë parisianë, duke lënë pas fëmijën e tyre Diego! Trupin e saj e gjetën një javë pas vetëvrasjes dhe kjo ishte një dramë që ai do ta vuante gjer në ditët e tij të fundit. Romanet e tij u ekranizuan nga autorë të shquar amerikanë e francezë si John Huston (Rrënjët e qiellit), Kosta Gavras (Shkëlqim gruaje) apo filmi Jeta para teje, etj., ku madje dhe vet ai realizoi dy filma si kineast. Në Amerikë, Gary ishte një star dhe jetonte mes starëve amerikanë të Hollivudit. Madje kur Jean pati një flirt




me Clint Eastwood, ai kërkoi të ndeshej me të në duel si në kohërat kalorësiake, por aktori amerikan preferoi të largohej. I tillë ishte Romain Gary, ndryshe nga të tjerët...

"Jeta përpara teje"

C’kishte menduar Gary kur e kishte shkruar këtë roman ? Vallë vitet kur jetonte me nënën e tij në kohën e fëmijërisë dhe të adoleshencës në Nice, botën e një gruaje hebre të lodhur nga vuajtjet në kampin e Auchwitz-it, vetminë e një ish prostitute dhe dëshira që para vdekjes të kthehej tek familja e saj në Izrael.... Padyshim ky libër është një nga romanet e mrekullueshme që ka shkruar Gary dhe ku spikat një humanizëm tronditës, lidhja e ngushtë me një jetim të rrugëve, Momo, të cilin ajo duhet ta rrisë në një lagje popullore të Belleville të Parisit ku jetojnë plot emigrantë. Zonja Roza banon në katin e

gjashtë të një ndërtese dhe është Momo, ky djalosh 10 vjeçar që e ndihmon për të bërë pazaret e saj dhe që shpesh qëndron në apartamentin e saj të fshehur nga bota, ku ndërtohen lidhje mjaft humane mes të dyve. Roza dikur administronte fshehurazi një lokal klandestin ku kujdesej për fëmijët e prostitutave por me kalimin e moshës, më së fundi tërhiqet në botën e mbyllur të apartamentit të saj duke jetuar me historinë e saj dhe të botës. Ngjarja e romanit tregohet në vetën e parë nga djaloshi Momo, me një gjuhë të thjeshtë dhe direkte, me një frazeologji popullore dhe zhargon të rrugës, ndonjëherë në mënyrë naive por të vërtetë, ku na zbulohet jeta kozmopolite e viteve ‘60-’70 të shekullit XX në Paris, emigracioni dhe ajo atmosferë solidare që spikaste në atë kohë. Në vitin 1975 ky roman u vlerësua me çmimin e madh letrar « Goncourt » por çmimin nuk e tërhoqi askush pasi Gary



e kishte botuar me pseudonimin Emile Ajar, duke huazuar emrin e një kushëriri të tij. Kjo histori ishte një nga ngjarjet më të zhurmshme të botës letrare franceze të viteve ‘70 pasi më së fundi, në letrën e fundit të lamtumirës së tij Gary do të shkruante se ishte pikërisht ai që e kishte shkruar atë roman. Sidoqoftë ky roman ishte një nga romanet më të bukur që u mirëprit nga lexuesi i gjerë dhe më pas u ekranizua në një film mjaft prekës të titulluar me emrin e personazhit : « Mama Roza », interpretuar nga aktorja e famshme Simon Signoret.

Nëna

Eshtë mjaft interesant një pasazh i shkurtër i librit Premtimi i agut, kur Romain Gary kujtonte lidhjen e fortë me nënën e tij. Kujtonte një ditë kur djalosh i ri po përcillte nënën e tij të lodhur që do të shkonte për tre ditë në një vend malor për t’u çlodhur. Por ndarja mes tyre ishte gjithë përqafime, ankth dhe lot. Dhe meqë shoferi i autobusit u mërzit duke pritur, ai filloi t’i binte burisë, por ata përsëri nuk ndaheshin dot. Dhe kjo sepse nëna e tij, Mina e dashur, parandjente kështu ndarjet e mëvonshme me birin e saj... «Ti do të bëhesh ambasador... ti je një gjeni!... kujtonte shpesh Gary zërin e saj, ndërkohë që ajo e shtrëngonte fort në gjoksin e saj, duke hedhur vështrimin tutje shpatullave të tij... ndoshta kishte mallin e burrit të saj që e kishte braktisur dhe që ishte diku larg. Gary filloi të shkruajë që në moshë 15 vjeçare, madje ai filloi të botonte dhe tregimet e tij të paraluftës. Pas fillimit të studimeve për drejtësi në universitetin e Nice-s, meqë shpërtheu lufta, ai u angazhua ushtar dhe u instruktua si mitralier avionësh, por shpejt, ai do të arratisej nga formacioni i tij ushtarak i qeverisë së Vishisë, për të shkua në Londër që të bashkohej me gjeneralin De Gaulle (De Gol). I vetmi kontakt me nënën e tij ishin letrat që shkëmbenin mes tyre. Kështu do të kalonin vitet e luftës gjer ditën e madhe të fitores dhe të lirisë. Kur Franca po çlirohej, përmes dhjetëra mesazhesh, ai e kishte lajmëruar nënën e tij në Nice se ishte duke ardhur. Ia dërgonte ato nga vende të ndryshme, gjithnjë duke iu afruar Nice-s. Madje, një miku i tij, kapiteni Vanurien, që dhe ai bashkë me të ishte hedhur me parashutistët francezë në gusht të vitit 1944 për të çliruar jugun e Francës, ishte përpjekur ta gjente në hotelin e saj, por Gary s’kishte asnjë lajm as nga miku i tij. Vallë e kishte gjetur? Ç’bëhej me nënën e tij? Pas disa ditësh, ai arriti më së fundi në qytetin e tij të dashur dhe çdo minutë imagjinonte takimin kur nënoken e tij do ta mbante në krahë me dashurinë më të madhe të botës. Me një xhip ai u nis me shpejtësi drejt Hotel-Pension Mermonts që dikur menaxhonte nëna e tij, drejt asaj ndërtese të vjetër, të cilën e

njihte symbyllur në të gjitha konturet e saj. Nxitoi me vrap drejt shkallëve duke shkuar me furinë e një adoleshenti drejt portës së tij, por dyert ishin mbyllur : «Askush nuk më priste, - do të shkruante ai. - Në mënyrë të vagët, njerëzit aty kishin dëgjuar diçka për nënën time por askush nuk e njihte. Miqtë e mi të vjetër ishin shpërndarë. Mu deshën shumë orë për të njohur të vërtetën. Nëna ime kishte tre vjet e gjysmë që kishte vdekur, pra disa muaj pasi unë kisha shkuar në Londër. Por nëna e dinte mirë se unë nuk mund të jetoja dhe të qëndroja në këmbë pa u ndjerë dhe i mbështetur te ajo. Dhe nëna i kishte marrë të gjitha masat. Disa ditë para se të vdiste, ajo kishte shkruar afërsisht 250 letra, të cilat ia kishte dërguar një mikeje të saj në Zvicër. Unë nuk duhej ta dija vdekjen e saj dhe letrat duhej të më dërgoheshin rregullisht ... Kështu, unë vazhdoja të merrja nga nëna ime forcë e kurajo që të mund të duroja luftën, ndërkohë që ajo kishte më shumë se tre vjet që kishte vdekur. Kordoni ombilikal kishte vazhduar të funksiononte...»

Si kishte qenë e mundur? Përse vallë? Njëmijë pyetje i vinin në kokë pilotit Romain Gary, luftëtarit të «Compagnon de Lorraine»... Kështu, i ulur diku, ai filloi të kujtojë vitet e fëmijërisë dhe jetën në krahët e saj, adoleshencën që përkundej në atë dashuri të jashtëzakonshme: «Shpesh, para se të filja, shikoja nënën të hynte në dhomën time, të përkulej mbi mua dhe të buzëqeshte trishtueshëm. Pastaj ajo më thoshte: «Ngriji sytë... Dhe unë i drejtoja sytë nga ajo. Nëna qëndronte një çast të gjatë e përkulur mbi mua? Pastaj hapte krahët, më shtrëngonte dhe unë ndjeja lotët e saj të binin në faqe. Fillova të dyshoj se kishte diçka misterioze dhe se nuk isha unë burimi i atyre lotëve tronditëse... »

Gjithë jeta e tij, fëmijëria, adoleshenca, rinia, kishin qenë në këtë ngjizje të pazakontë, të rrallë, në ethe dhe lot dhe në shpresa të njëjta e të përbashkëta. « ... Ajo mu afroa, më mori fytyrën midis duarve të saj duke më vështruar me vëmendje çdo tipar dhe lotët shkëlqenin në sytë e saj. Një siklet i madh më kapte. Papritur kisha përshtypjen se duhej të isha dikush tjetër... Nuk mund të mos shikoja fytyrën e lumtur të nënës time pa ndjerë të rritej brenda gjoksit tim një besim i jashtëzakonshëm për fatin tim... Padyshim, kjo reflektonte besimin që kishte nëna që nga lindja ime, besim të cilin ajo e kishte kthyer në thelbin e jetës dhe të shpresës së saj...”

Atë ditë, kur ai mësoi vdekjen e nënës së tij, e kuptoi se ç’mund të bënte zemra e një nëne për birin e saj, duke imagjinuar dhe të pamundurën, të mbijetonte dhe pas vdekjes së saj për mos të lënduar zemrën djaloshare të birit të saj në luftë. Dhe ai rishikonte të njëjtin imazh kur i vinin letrat në front, gjithë ato letra që i vinin në vende të ndryshme, nga shumë larg, aty mes bombave dhe ku ai dëgjonte zërin e saj... «Biri im i shtrenjtë. U bënë shumë vite që jemi ndarë dhe shpresoj që tashmë je mësuar, pasi në fund të fundit, unë nuk do të jem gjithnjë në këtë botë. Kujtohu që asnjëherë nuk kam dyshuar për ty. Shpresoj që kur të vish në shtëpi, ti do ta kuptosh dhe do më falësh. Nuk mund të bëja ndryshe...” Ç’kishte bërë? Çfarë do t’i falja?...”Gjithçka që kam bërë, e kam bërë sepse ti kishe nevojë për mua. Mos ma vër re. Jam mirë, të pres.... Më kot pyesja veten.”

Po, më kot pyeste veten Romain Gary në ato ditë lufte... Madje rreziqet ishin të panumurta dhe ai çuditej sesi kishte mundësi që gjithnjë shpëtonte mrekullisht nga vdekja e sigurtë. “Çdo ditë kisha takim me qiellin dhe avioni ynë shpesh kthehej gjithë shenja plumbash...” Një herë gjatë një operacioni, në luftë e sipër në qiell, piloti i tij goditet rëndë në njërin sy e megjithatë e mbante fort timonin, gjersa më në fund, për habinë e të gjithëve ata arritën në bazën e tyre angleze... Shpëtimi e ndiqte pas gjithnjë, si me magji, si një urdhër qiellor që vinte nga hyjnitë. Pikërisht në Londër, pasi ishte plagosur në një dyluftim ajror, ai ishte dekoruar nga gjenerali De Gaulle. Luftime në udhët e Afrikës, nga Kajro në Kongo, Bangui, në Sudan e Nigeri... Një herë avioni u rrëzua, por atë ditë nuk ishte ai që ngiste avionin. Ishte një neozelandez dhe dikush tjetër. Ata mbetën të vrarë, që të dy... Pastaj më vonë, atje e kishte zënë tifo ku vetëm transfuzionet mundën ta shpëtojnë. Dhe

gjithnjë i shfaqej portreti i nënës... “Shikoja nënën time. Ajo përkulte kokën anash, sytë gjysmë të mbyllura. Vinte një dorë mbi zemrën e saj. Kishte shumë vite që e kisha parë në një pozicion të tillë, në çastin e krizës së saj të parë në një koma insulinike. Fytyra e saj ishte në ngjyrë gri. Kërkonte të bënte një përpjekje të jashtëzakonshme, por s’mundej, s’kishte forcën që do të duhej për të shpëtuar gjithë bijtë e botës. Ajo nuk mund të shpëtonte veçse birin e saj. - Nënë, - i thashë, duke ngritur sytë. – Nënë! - Ajo më vështronte. - Ti më kishe premtuar që të bëja kujdes, - tha ajo. - Po nuk isha unë që ngisja avionin... Pas 38 orësh më gjetën brenda karkasës së avionit me kapak të mbyllur dhe mes një vape të tmerrshme, i pandërgjegjshëm dhe me trup të rreshkët nga mungesa e ujit...”

Po kështu, Gary kujtonte dhe një ditë kur i ulur buzë Nilit me një mikeshë, tek po lexonte një letër të saj disi i tërhequr. Por ndërkohë, vajza që kujtonte se ai kishte ndonjë të dashur, i kishte thënë:

« - Vallë ajo të do?

Pohova thjesht menjëherë.

- Po ti?

- Ah, femrat për mua... Humb një e gjen dhjetë të tjera...



- Nuk ke frikë se të tradhton gjatë kohës që nuk je atje ?

- Ah, jo... - u përgjigja.

- Edhe pse i ndarë me vite ?

- Po, edhe pse kjo vazhdon me vite.

- Po në fund të fundit, a nuk e kupton që një femër nuk mund të qëndrojë vetëm për vite me radhë, pa burrë, thjeshtë për sytë e bukur ?

- Po, e besoj, - i thashë... E kam parë këtë nga afër. Kam njohur një grua që ka qëndruar me vite pa burrë, vetëm për sytë e bukur të dikujt...”

Po, kështu kishte ndodhur me nënën e tij. Dhe nëna e tij e kishte mësuar të mos jepej kollaj pas femrave, siç kujton ai në La Promesse de l’aube: “Nuk duhet të të duan shumë kur je kaq i ri. Kjo gjë të mëson zakone jo të mira... me dashurinë e nënës jeta u bën një premtim që ajo nuk e mban kurrë. Atëherë je i detyruar të hash diçka të ftohtë gjer në fund të jetës. Pas kësaj, sa herë një grua ju merr në krahë dhe ju shtrëngon në zemrën e saj, këto

janë thjesht ngushëllime. Dhe atëherë si një qen, shkojmë të ankohemi në varrin e nënës: kurrë s’do ta bëj më. Krahë të mrekullueshme ju pushtojnë rreth qafës dhe buzë të ëmbla ju flasin për dashurinë, por ju e dini tashmë, ju keni kaluar që herët nga burimi ku keni pirë gjithçka. Kur etja ju kap sërrish, ju mund të hidheni nga të katër anët por s’ka më puse, ka veç mirazhe. Që me shkëlqimet e para të agut ju jeni i informuar tashmë. Ngado qe të shkoni, ju do të keni me vete helmin e krahasimit dhe do të kaloni gjithë kohën tuaj duke pritur atë që tashmë ju e keni marrë...”

Kështu, dashnoret e tij të shumta bëheshin shpejt mikesha që i dëshmonin përkushtimin. Çdo herë që do të takonte një femër, ai shpresonte të binte në dashuri. Por para se të fillonte ta konkretizonte këtë lidhje, ai tashmë ishte i lodhur, pasi nëna e tij i kishte dhënë gjithçka që në fëmijëri, siç e shkruan në Premtimi i agut.

“Letrat e saj të para më erdhën pak kohë pas mbërritjes time në Londër. Kishin ardhur fshehurazi nga Zvicra, ku një mike e nënës time i ridërgonte rregullisht. Asnjëra nuk kishte datë. Deri në kthimin tim në Nice, tre vjet e gjashtë muaj më

më pas, siç do të shkruante Gary në librin e tij, “Letrat e nënës time bëheshin më të shkurtra... fraza të hedhura nxitimthi, me lapës... Mbahej mirë dhe insulina nuk i mungonte. “Biri im i lavdishëm, jam krenar për ty... Vive la France!...”

Mungesa e një nëne

Mungesa më e madhe në jetën e Gary-së ishte nëna e tij, pasi ajo i kishte dhënë atij dashurinë më sublime që mund të jepte një nënë, dashuri të cilën ai s’mund ta gjente diku tjetër. Dhe kështu, hija e saj, drama dhe vdekja e saj, do ta ndiqte pas gjithë jetën, edhe pse ai do të bëhej njeri i famshëm, siç kishte thënë profecinë ajo. Në Rue du Bac, siç shkruan dhe në biografinë për të Myriam Anissimov, e cila kishte rrëmuar gjer në detaje në jetën e tij intime, në dashuritë e rastësishme dhe dëshirat e tij, ajo tregon se ai shëtiste gjithnjë në kërkim të ndonjë vështrimi ndjellës, të ndonjë vajze të re që përgjërohej për romanet e tij. «Sa herë që përkëdhelja ndonjë femër, - shkruante Gary, - sytë e saj kërkonin të gjenin në sytë e mi vështtrimin e dashurisë. Dhe ajo i ndjente përbetimet e zemrës time në gjoksin e saj, në krahët e mia që e qarkonin dhe e shtërngonin fort. Atëherë, ajo më merrte për një të dashuruar: ndërsa unë isha veçse në një lloj ëndrre. Shumë gra kanë pandehur kështu se ishin të dashuruara nga unë, ndërkohë që te unë, ato ishin veçse mungesa e dikujt. Kur unë rifilloja të bëja seks, e shikonin qartë provën e pasionit tim për to, frymëzimin tim, ndërkohë që unë luftoja me ato kohëra të shkuara, ku ndjesitë e mia të ngopura më privonin nga imagjinata dhe më kthenin në atë realitet ku ato gra të huaja më dukeshin tepër të bezdisshme. Ato mendonin të afroheshin më shumë dhe të plekseshin në mënyrë intime përmes shtrëngimeve tona, por pikërisht këto çaste, unë i braktisja ato për tu bashkuar me një tjetër...»

Jeta me aktoren e njohur amerikane Jean Seberg, ishte një romancë e fortë dashurie dhe dhe problematike njëkohësisht pasi CIA e ndiqte në kohën kur intelektualët amerikanë luftonin kundër racizmit si dhe luftës në Vietnam. Jeta me të shkonte nëpër mjegull. Rue du Bac, Rue de Rennes, restoranti Recamier, Lipp, La Coupole, Boulevard de Montparnasse... «Kohë me kohë ndonjë grua lidhte marrëdhënie me mua dhe pastaj ajo më linte, pasi femrat nuk i duan adoleshentët. Ka disa nga ato që qendrojnë diçka më gjatë, pasi ato janë të martuara dhe kanë familje. Dhe meqë unë u harxhoj jo shumë kohë, ato mendojnë se jam burri i jetës së tyre... Kam përshtypjen se ato e kuptojnë pastaj se jam një trap, por megjithatë unë vuaj, se më pëlqejnë vajzat e reja. Ndonjëherë, burrat e tyre vijnë të kërkojnë ndonjë shpjegim për veprimet e grave të tyre, por unë jam i pazoti tu them ndonjë gjë. Në fakt gjërat shkojnë jo keq, pasi ata e dinë se jam 60 vjeçar dhe në këtë moshë është më shumë miqësi. Por unë ëndërroj të bëj dashuri si gjithë djemtë adoleshentë...»

Në vitin 1949, kur Romain Gary kishte blerë një shtëpi në brigjet e Mesdheut, në fshatin Roquebrune, i kishte thënë gruas së tij të parë, anglezes Lesly Blanch, gazetare dhe shkrimtare, se nëse vdiste, hiri i tij të hidhej pikërisht në ujrat e atij deti para syve të tyre. Dhe Lesly do ta mbante fjalën. E dashura e fundit e Gary-së, Leila Chellabi, që kujdesej gjithashtu dhe për djalin e tij, Diego, erdhi nga Parisi me një urnë hiri në Roquebrune, ku i priste Lesly. Ajo i kishte përgatitur të gjitha, madje kishte marrë me qera dhe një barkë, por meqë ishte sëmurë, ajo qëndroi në breg bashkë me Diegon, ndërkohë që Leila, me hirin e Gary-së, hipur në barkë, shkiste mbi ato ujëra të qeta drejt banesës së fundit të Romain Gary, për të shpërndarë atje, atë ç’kishte mbetur prej tij. Shkrimtari e donte shumë Mesdheun, për të cilin vite më parë kishte shkruar: «I shtrenjti Mesdhe! Paqja tënde latine aq e ëmbël për jetën, më qoftë falë, mëshirëmadh e miqësor. Me çfarë kujdesi vështrimi yt i lashtë e gazdhënës puthi dikur ballin tim adoleshent. Vij gjithnjë në bregun tënd me barkat që sjellin perëndimin në rrjetat e tyre. Gjithnjë kam qenë i lumtur në gurët e bregut tënd...”

NUMRI I ARDHSHEM ME 31 MARS

HEJZA

15 Mars, 2025

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Faqosjen dhe dizajnin:
Drian Shala - Shalë

Rruga e Kaçanikut nr.208, Shkup, 1000